

ETIKA



LARTËSIMI I JETES
GRADË - GRADË
IDRIS ARPAT

EDUKIMI I BREZIT
TË RI NË ISLAM
ALTIN TORBA



ZEMRA E PASTËR
M. SAMI RAMAZANOGLLU



EDISON ÇERAJ
PËRSIATJE PËR
NATYRËN E ROMANIT

DISEQUILIBRIUM
NUREDIN NAZARKO



OSMAN NURI TOPBASH
TË ZGJEDHËSH
AHIRETIN NË VEND TË DYNJASË



Çfarë humbi ai
QË TË FITOIT

Janar 2013

VITI: VII
NUMRI: 58

BOTUESI
Shtëpia botuese Progresi

DREJTOR
Alban Kali

KRYERADAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

KORREKTORE
Dr. Irida Hoti

PËRKTHYES
Albert Halili
Arjan Ymeraj
Artur Tagani
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
L: Vasil Shanto; Rr: Çajupi
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 208 6767

E-MAIL
revistaetika@progresibotime.com

WEBSITE
www.revistaetika.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar

U bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese Progresi ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Të gjitha fetë hyjnore janë organizuar rreth **"njohjes së Allahut"**.

Edhe njeriu edhe fetë kanë ardhur prej Tij.

Edhe njeriu edhe fetë ekzistojnë falë Tij.

Në jetë vijmë pa vullnetin tonë dhe udhëtimin e fillojmë në mënyrë të detyruar. Askush nuk na pyet: "A dëshiron të vish në jetë, ta vazhdosh jetën apo të zvarritesh në jetë." Vetën e kemi gjetur të mbështjellë nëpër djepa. Ja, që nga kjo pikë, fillon udhëtimi ynë drejt pafundësisë. Këtij udhëtimi i themi jetë. Sikur të vinim në këtë botë me vullnetin tonë, duhej ta pyesnim njëri-tjetrin për qëllimin e kësaj ardhjeje. Duke qenë se nuk bëhet fjalë për diçka të tillë, atëherë jemi të detyruar të pyesim Fuqinë e Lartë krijuese: "Cili është qëllimi për të cilin jemi dërguar në këtë botë?"

...

Për besimtarët, mbështetja tek Allahu është shumë e rëndësishme. Rruzulli tokësor, sot po ekspozon fotografitë e lotëve të nevojës. Në ditët e sotme, kjo nevojë është e pandotur dhe e delirë, sepse nuk ka mbetur asgjë tjetër veç saj. Ndaj, të bësh atë që kërkon Krijuesi për krijesat. Kërkesa e Allahut që robërit e Tij të përmbushin këtë dëshirë të shenjtë, është që ata të drejtohen për mbështetje tek Ai. Edhe sikur të jetonim në pasuri dhe bollëk, sikur të mos ishim emigrantë, edhe sikur të mos kishim humbur shtëpitë, familjet, plaçkat tona, do i drejtoheshim Samedit Një (Allahut). Le të mendojmë sikur të ishim vërtet ashtu, jetimë, të papërkrahur, emigrantë! Le të kuptojmë nevojën që kemi për Të dhe t'i japim formë jetës sipas saj! Nëse do të bëjmë kështu, gjithçka do të zgjidhet dhe do të arrijmë prehjen shpirtërore që të jep

ajeti: **"Ata janë të kënaqur me Të dhe Ai është i kënaqur me ta."** Le t'i lutemi Zotit të na shtojë nevojën për Të dhe të jetojmë të lidhur me Të!

...

Fitimi te i Pasuri është gjithnjë i sigurt dhe larg Tij, humbja po ashtu është e sigurt. Larg Tij jemi në duart e Egos që luan me ne si me një kukull, na çon drejt dëshirave egoiste duke na konsumuar e lodhur, ndërsa kush afrohet te Zoti, ndjen sërish jetën që i vlon, zemra e tij është e gjallë, gjithçka merr kuptim dhe ai fillon t'ua njohë haqet gjërave dhe kupton se duhet të jetë mirënjohës ndaj Atij që e ka krijuar dhe i vjen turp, sepse një ditë do të dalë para Tij, prandaj me lot në sy kërkon falje ditën e natën.


Allahu na kujton: **«Thuaj: "Kush ju ushqen nga qielli dhe Toka? Kush mundëson të dëgjuarit dhe të parit? Kush mund të nxjerrë të gjallën nga e vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla? Kush i drejton gjërat?" Ata do të thonë "Allahu". E ti (o Muhamed) thuaj: "Atëherë, përse nuk e keni frikë Atë?" Ky është Allahu, Zoti juaj i vërtetë. E çfarë ka pas së vërtetës, përveç humbjes? Atëherë, përse largoheni?» (Junus, 31.)**

"Shkatërrimi i çdo populli vjen prej një të keqeje. Ndërsa shkaku i shkatërrimit të popullit tim do të jetë pasuria e dynjasë!" (Muslim)

"Ari dhe argjendi shkatërroi popullin që ishte para jush. Nëse nuk ruheni nga koprancia, ambicia dhe murrja, do të jetë edhe shkaku i shkatërrimit tuaj." (Muslim)


"Të parët e këtij umeti gjetën devotshmërinë, dijen, besimin dhe shpëtimin. Kurse të pasmit e umetit tim do të shkatërrohen prej koprancisë dhe dëshirave të pafundme." (Ramuz)

Përmbajtja



14

Edison Çeraj
Përsiatje për natyrën e romanit



Osman Nuri Topbash
Të zgjedhësh ahiretin në vend të dynjasë

32




8



24

Ahmet Tashgetiren
Pa njohur Allahun

- 5 Albri Brahusha**
Çfarë humbi ai që të fitoi Ty,
çfarë fitoi ai që të humbi Ty
- 8 Idris Arpat**
Lartësimi i jetës gradë-gradë
- 13 A. Jasin Demirxhi**
Të blesh lumturinë
- 19 M. Sami Ramazanogllu**
Zemra e pastër
- 20 Xhafer Durmush**
Koha e edukimit të njeriut
- 22 Nexhat Ibrahim**
Rëndësia dhe roli i Kuranit dhe
Hadithit në teologjinë Islame
- 27 Ali Riza Temel**
Vetëdija ndaj mirësive
- 30 Një ajet - Një Hadith**



38

- Prof. dr. M. Jashar Kandemir 36**
Besimi në Allahun
- Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz 38**
Ndjeshmëria ndaj shpërdorimit ose etika e konsumit
- Nuredin Nazarko 41**
Disequilibrium
- Ma. Ermira Ymeraj 44**
Zidanje Skadra dhe kënga e Rozafatit, vështrim krahasues
- Zani i s'kaluemes 52**
Randsi e martesës
- Naim Drijaj 54**
Dëshmitarët okularë
- Shëndet 56**
Si të qetësojmë dhimbjet e kokës
- Teknologji 57**
Roboti që i ngjan shumë njeriut
- Aktualitet 58**
Procesi i anëtarësimit të ballkanit perëndimor në BE,
mos vallë në rrezik?



10

Altin Troba
Edukimi i brezit të ri në Islam



Rabia Christine Brodbeck
Epoka e zekatit, epoka e dashurisë

46

Çfarë humbi ai QË TË FITOI Çfarë fitoi ai QË TË HUMBI

Albri Brahusa

(Pasi e vrau populli i vet, atij)
iu tha: "Hyr në Xhenet!"

Ai tha: "Ah, sikur ta dinte populli im
se si më fali Zoti im dhe më bëri të nderuar!"

Jâ Sîn (20-27)

Allahu Teala e ka lejuar tregtinë e të mirave që Ai ka krijuar në këtë botë, me qëllim që njerëzit të nxjerrin përfitim prej tyre, e kështu ata sigurojnë përmes tregtisë, domosdoshmëritë e së përditshmes. Por edhe në aspektin shpirtëror, Allahu nëpërmjet profetëve dhe Librave të Tij, i fton njerëzit në një "tregti" të një lloji tjetër: në tregtinë që njerëzit mund të bëjnë me Allahun, të Pasurin, pasuria e të Cilit nuk mbaron kurrë. Besimi në një Zot të vetëm i fton njerëzit: ta njohin Krijuesin e tyre, ta adhurojnë në namaz, pra lidhje të afërt me Të, të jenë të rregullt në dhënien zekatit për pastrimin e pasurisë, të jenë të durueshëm, dhe të përkujtojnë emrat e Tij (dhikër). Kështu, në këmbim, Ai jep shpërblimin në këtë botë, dhuron qetësi, begati dhe kuptueshmëri, pastaj shpëtimin e shpirtit dhe ringjalljen në jetën e përgjeshme në Xhenetin e pastër, ku nuk do të ketë më asnjë lloj shqetësimi a vuajtjeje.

Allahu e njeh njeriun më mirë se ky i fundit veten e tij, duke qenë se Ai është Krijuesi dhe Dhuruesi i sekreteve të shpirtit njerëzor, i Gjithëdituri, Ai është Rrahman dhe Rrahim, i Gjithëmëshirshëm dhe Mëshirëplotë. Dhe sa herë njeriun e mbulon harresa, Ai ia kujton të Vërtetën dhe rrugën e shpëtimit. Duke ditur se njeriu e do fitimin, shpesh gjuha e paralajmërimit është një gjuhë "tregtie", në mënyrë që krijesa e Tij, ta kuptojë se është gjithnjë nevojtare për ndihmën e Zotit. **"Ja, juve ju bëhet thirrje të shpenzoni në rrugën e Allahut, por disa prej jush janë koprracë. Kush tregohet koprrac, ta dijë se i bën dëm vetes, sepse Allahu është i Pasur (s'ka nevojë për asgjë), ndërsa ju jeni të varfër. E,**

nëse ju ia ktheni shpinën dhe i largoheni Atij, Ai do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, i cili nuk do ta ndjekë shembullin tuaj.” (Muhamed, 38.)

Nga ana tjetër, të gjithë profetët dhe miqtë e Zotit nuk kërkuan kurrë shpërblim nga njerëzit, për lajmet e mira dhe paralajmërimet. **“O populli im! Unë nuk kërkoj nga ju shpërblim për këtë. Mua më shpërblen vetëm Ai që më ka krijuar! A nuk kuptoni?” (Hud, 51)** Ata janë njerëzit e besëlidhjes mes njeriut dhe Zotit, ata nuk kërkojnë asgjë, sepse janë emisarët e të Pasurit. Sepse ata e shihnin dhe dinin më së miri shpërblimin te Zoti i tyre dhe u ishte hequr lakmia për këtë botë, e pikërisht duke parë thesaret e mëdha të Allahut, ata dhanë gjithçka kishin në rrugën e Tij. Duke u frymëzur prej Tij me dije të vërteta, ata nuk flisnin prej vetes së tyre e kështu, ata janë ndëmjetësues që njerëzit të përfitojnë nga këto lajme dhe të bëhen falënderues dhe “tregtarë” të mirë duke iu bindur thirrjes dhe dëgjuar këshillat e të Gjithëmëshirshmit.

Për të treguar se Allahu ia jep dijen kujt të dojë dhe se shpërblimi te ai është i menjëhershëm, në Kuran ka një dëshmi:

“Dhe nga skajet e qytetit erdhi një njeri, duke nxituar dhe tha: “O populli im, ndiqni të dërguarit! Ndiqni ata, që nuk kërkojnë prej jush kurrfarë shpërblimi e që janë në rrugë të drejtë! Përse të mos e adhuroj Atë, i Cili më ka krijuar e tek i Cili do të ktheheni të gjithë? Vallë, përse duhet të adhuroj zota të tjerë përveç Tij? Nëse i Gjithëmëshirshmi do të dëshironte të më godiste me ndonjë të keqe, ndërmjetësimi i atyre (zotave) nuk do të më sillte kurrfarë dobie e as që do të mund të më shpëtonin. Atëherë, unë do të isha me siguri në humbje të dukshme. Unë i kam besuar Zotit tuaj, andaj, më dëgjoni!” (Pasi e vrau populli i vet, atij) iu tha: “Hyri në Xhenet!” Ai tha: “Ah, sikur ta dinte populli im se si më fali Zoti im dhe më bëri të nderuar!” (Jâ Sîn, 20-27.)

Ky njeri nuk ishte profet, por megjithatë e kuptoi rëndësinë e paralajmërimit të profetëve. Allahu i dha atij dije si shpërblim, se ia njohu zemrën. Njerëzit e qytetit, e vranë me gurë, Allahu e futi në Xhenet. Pasi ai pa shpërblimin, i erdhi keq për njerëzit që nuk besuan profetët, që të përfitonin edhe ata nderimin që iu dha atij. Më pas vjen shkatërrimi i popullit. Allahu e bëri shembull. Ai i shpëton ata që do, prej ndëshkimit të Vet.

Besimi në Allahun dhe njohja e autoritetit të Tij, nënshtrimi ndaj Tij, është respekt, frikë, dashuri, mirënjohje dhe detyrë, jo pse Zoti ka nevojë për këto, por se pikërisht njeriu ka nevojë, t'i lutet Krijuesit ta ruajë nga vetja njerëzore. Ky është një përfitim në këtë botë, por njëkohësisht përgatitje për botën tjetër, ku egoja është e patolerueshme. Siç Allahu thotë: **“Ata që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, falin namazin dhe**

japin zeqatin, do të kenë shpërblim te Zoti i tyre dhe nuk do të kenë pse të frikësohen apo pikëllohen.” (Bekare, 277).

Kjo është më e pakta që mund të bëjë njeriu, pasi njeriu, sado të bëjë nuk mund t'ia japë hakun Krijuesit, pra nuk mund ta adhurojë kurrë asnjëherë, ashtu siç Ai e meriton. Gjithsesi Allahu e njeh kapacitetin e krijesës së Tij, prandaj e do atë. Fitimi te i Pasuri është gjithnjë i sigurt dhe larg Tij, humbja po ashtu është e sigurt. Larg Tij jemi në duart e Egos që luan me ne si me një kukull, na çon drejt dëshirave egoiste duke na konsumuar e lodhur, ndërsa kush afrohet te Zoti, ndjen sërish jetën që i vlon, zemra e tij është e gjallë, gjithçka merr kuptim dhe ai fillon t'ua njohë haqet gjërave dhe kupton se duhet të jetë mirënjohës ndaj Atij që e ka krijuar dhe i vjen turp, sepse një ditë do të dalë para Tij, prandaj me lot në sy kërkon falje ditën e natën.

Allahu na kujton: **“Thuaj: “Kush ju ushqen nga qielli dhe Toka? Kush mundëson të dëgjuarit dhe të parit? Kush mund të nxjerrë të gjallën nga e vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla? Kush i drejton gjërat?” Ata do të thonë “Allahu”. E ti (o Muhamed) thuaj: “Atëherë, përse nuk e keni frikë Atë?” Ky është Allahu, Zoti juaj i vërtetë. E çfarë ka pas së vërtetës, përveç humbjes? Atëherë, përse largoheni?” (Junus, 31.)**

Fitimi i parë në afrinë me Allahun, është vetëdija dhe respekti për krijesat e Tij, për gjithçka ka krijuar, ndjen



afërsi në çdo gjë, edhe pse larg shtëpisë së premtuar, Xhenetit, kjo botë bëhet e ngjashme me të, sepse është mjeti me të cilin mbërrihet shpërblimi, por jo qëllimi. Duke u bërë falënderues, njeriu në çdo gjë sheh shenjën e krijimit të Allahut. Shumica e njerëzve në këtë botë e shohin përfitimin vetëm në mbledhje të mirash materiale, pushteti dhe siguri në pasuri duke e kthyer jetën e kësaj bote, në qëllimin e tyre të vetëm. Në fakt, kjo është një humbje e madhe, kur nuk ka vetëdijen se kjo pasuri nuk u dha kot, por për ta provuar njeriun. Lum kush ka pasuri të kësaj bote dhe është i vetëdijshëm për Zotin e Tij, sepse pasuria është një sprovë e madhe dhe mund të çojë shumë kollaj në humbje të kësaj bote dhe tjetrës. Po ashtu, ata që kanë grumbulluar dije dhe mbahen me të madh si të dijsëm nga vetja e tyre, duke harruar se këtë dije ua ka dhuruar Allahu që ta përdorin për tu shërbyer krijesave të tij: **“Vepra e atyre, që nuk besojnë Zotin e tyre, i shëmbëllen hirit, të cilin e shpërndan era në një ditë të stuhishme. Ata nuk do të kenë asnjë dobi nga veprat që kanë punuar. Kjo është humbja e madhe.” (Ibrahim, 18.)**

Kriza e sotme ekonomike, rrënjët i ka në krizën morale dhe harresën ndaj detyrimeve që kemi ndaj Krijuesit, duke humbur vetëdijen dhe respektin për krijesat e Zotit dhe krijimin e Tij. Sistemi po i çon njerëzit në një konkurrencë kafshërore dhe egoistike për mbijetesë, frikë, xheloz, zili, luftëra dhe intriga, dhe humbja shihet

kudo. Edukata dhe butësia tashmë janë të rralla, egoja i çon njerëzit në kacafytje për jetë a vdekje. Njerëzit shohin se autoritetet që i udhëheqin janë të zhytur në humbje, dhe ata imitojnë duke thënë: “Kur e bëjnë ata, pse të mos e bëjmë edhe ne”. Por, siç thotë Allahu në Kuran: **“Të gjithë do të dalin para Allahut. (Atëherë), ata që kanë qenë të përulur, do t’u thonë atyre që kanë qenë kryelartë: “Ne kemi qenë ithtarët tuaj. A do të mund të lehtësoni ju prej nesh diçka nga dënimi i Allahut?” Ata do të thonë: “Sikur të na kishte udhëzuar Allahu në rrugën e drejtë, edhe ne do t’ju kishim udhëzuar ju. Rënkojmë apo durojmë, për ne njësoj është, nuk do të ketë shpëtim.” (Ibrahim, 21.)** Dhe kjo, sepse ata ndoqën tregtinë e gabuar, duke ndjekur të humburit dhe jo të fituarit. Ndërsa besimtarët, ata që duruan në rrugën e drejtë të Zotit, që dhanë nga pasuria e tyre dhe bënë vepra të mira me emrin e Allahut (*Bismillah*), duruan dhe qëndruan në besëlidhje, Allahu i përgëzon: **“Sigurisht që Ne do t’ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoi të duruarit, të cilët, kur i godet ndonjë fatkeqësi, thonë: “Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!” Ata do të shpërblehen me bekim dhe mëshirë nga Zoti i tyre; ata janë në rrugën e drejtë!” (Bekare, 155-157)**

Lidhja me Allahun është një lidhje e fortë, sepse kalon nëpër sprovë të mëdha. Në vështirësi njihen miqtë e mirë, ata që nuk e tradhetojnë lidhjen me Allahun, u binden me durim urdhrave të Tij dhe lënë gjithçka kur dëgjojnë thirrjen. Shembulli më i përkryer njerëzor në këtë thirrje është profeti Muhamed (Paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të!). Ai u mbështet vetëm te Allahu Teala, pati barrën e shpalljes hyjnore dhe përgjegjësinë e të qenit i saktë në transmetimin e kësaj shpalljeje (Kuranit), Libër i cili i sqaron të gjitha çështjet dhe është dhuntia me të cilën Allahu e përsosi fenë për njerëzit në këtë botë. Në zemrën e këtij Zotërie, kaluan historitë e të gjithë profetëve të mëparshëm, u sqaruan të gjitha keqkuptimet, u shtrua rruga e drejtë për njerëzit dhe erdhi Drita. **“Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë shpërblim të madh.” (Isra, 9)**

Ky është libri i “tregtisë së mirë”, ku njeriu mëson t’i lagohet humbjes dhe i hapet mundësia drejt fitimit në këtë botë dhe përjetësi. Ky është libri që Allahu ia dhuron njerëzimit dhe profeti Muhamed (a.s.), është mëshira për të gjitha botët, ndërmjetësuesi, lidhësi, besniku dhe i dashuri i Allahut, të cilit iu besua misioni fisnik i “tregtisë së mirë” mes kësaj bote dhe tjetrës. Siç paralajmëron Allahu Teala: **“Jeta e kësaj bote, nuk është gjë tjetër, veçse argëtim dhe lojë. Ndërsa jeta e botës tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë. Veç sikur ta dinin!” (Ankebut, 64)**

Lartësimi i Jetës gradë - gradë

Idris Arpat

Jeta është një udhëtim pa kthim dhe një ujë që rrjedh. Ajo është një hark i hapur ndërmjet kondakut dhe qefinit, ndërmjet djepit dhe varrit.

Në jetë vijmë pa vullnetin tonë dhe udhëtimin e fillojmë në mënyrë të detyruar. Askush nuk na pyet: "A dëshiron të vish në jetë, ta vazhdosësh jetën apo të zvarritesh në jetë?" Vetën e kemi gjetur të mbështjellë në djepa. Ja, që nga kjo pikë, fillon udhëtimi ynë drejt pafundësisë. Këtij udhëtimi i themi jetë.

Sikur të vinim në këtë botë me vullnetin tonë, do duhej ta pyesnim njëri-tjetrin për qëllimin e kësaj ardhjeje. Duke qenë se nuk bëhet fjalë për diçka të tillë, atëherë jemi të detyruar të pyesim Fuqinë e Lartë krijuese: "Cili është qëllimi për të cilin jemi dërguar në këtë botë?"

Përgjigjja është kjo: "Li ja'budun, që të më adhuroni Mua."

Në këtë çështje përfshihen edhe aspektet e njohjes, gjetjes dhe admirimit.

Nga kam ardhur? Ku po shkoj? Cila është detyra ime kryesore në këtë botë? Cilat janë rregullat me të cilat jetohet në këtë mysafirhane? Çfarë është kjo botë? Çfarë është ajo që vjen pas saj? Çfarë lidhjeje kanë me njëri-tjetrën? Çfarë pozite kam kundrejt Allahut të Madhëruar, njerëzve, vetes sime dhe natyrës?

Këto janë pyetje me rëndësi jetike. Ne e kemi të pamundur të jemi të qetë dhe të lumtur pa u gjetur përgjigje të saktë këtyre pyetjeve dhe pa u përpjekur për të jetuar sipas këtyre përgjigjeve. Ata që thonë se është e mundur,

do të shohin se llogaria e gabuar nuk përputhet me natyrshmërinë e tyre.

E vetmja përgjigje e drejtë që mund të thotë mendja e pavarur nga shpallja hyjnore, kundrejt këtyre pyetjeve bazë dhe shumë serioze, është "nuk e di". Dihet se mendja shpjegon "si-të" dhe jo "përse-të".

Kurani Fisnik dhe Suneti i lartë profetik janë burimi i vetëm me të cilin mund ta konceptojmë drejt kuptimin e jetës. Mendja mund të japë shpjegime të rëndësishme vetëm nën dritën e shpalljes hyjnore, sepse "mendja është sy, ndërsa shpallja është dritë". Çfarë të bëjë syri pa diellin? Destinacioni ku arrin njeriu që i kthen shpinën shpalljes, është hutimi, depresioni dhe agresiviteti. Njeriu i një bote që e ka shkëputur lidhjen me botën tjetër, vetëvritet ose revoltohet. Nuk ka sukses të rastësishëm. Nuk ka lumturi të befashme. "Lumturia e jetës" mund të arrihet duke mësuar, kërkuar, duke ndjekur natyrshmërinë njerëzore dhe duke ua vënë veshin gjërave të përhershme.

Mirëpo, çfarë është natyrshmëria? Kush e njeh këtë enigmë që quhet njeri? Mjeshtrit e kësaj pune thonë: "Ne nuk mund ta shpjegojmë njeriun. Pyetni Allahun për të."

Ja, jemi ballë për ballë me një çështje të madhe. Nuk mund të kuptojmë as natyrshmërinë njerëzore dhe as Kuranin Fisnik. Duke heshtur kundrejt pyetjeve të jetës dhe duke e bërë hatme Kuranin Fisnik, i cili ka zbritur "li kaumin jakilun / për një popull që mendon", dy miliardë myslimanë në këtë botë, po bëhen rutinë. Puna jonë nuk është punë dhe përparimi ynë nuk është përparim.

A thoni: "Na mjafton aq sa kuptojmë?" Edhe të tjerët

para nesh kanë thënë kështu, miku im i dashur. Nëse nuk u gjejmë përgjigje pyetjeve të jetës dhe zgjidhje problemeve, jeta nuk na pranon si "ekzistues" dhe na shtyp.

Edhe perëndimi, që është një "shoqëri e mendjes", nuk ka ndonjë fjalë për të thënë në çështjen e kuptimit të jetës. Ai është i preokupuar për t'i vënë në gjumë individët me ninullat "e shpejtësisë e të kënaqësisë". Nëse nuk i vë dot në gjumë, i bën të mos ndjejnë gjë. "Në perëndim nuk ka ndonjë gjë të re." Ai e konsideron njeriun budalla dhe i vë përpara shumë lodra. Kjo është e gjitha.

Të jetosh, nuk do të thotë të marrësh e të japësh frymë. Të jetosh, është bukuria e ndjenjave dhe mendimeve. Është përpjekje për ta kaluar këtë bukurie në jetë. Është lumturia që buron nga kjo përpjekje.

Thonë se puna që bëhet me dashuri, është më e lehtë. Thonë, gruaja është bashkëshortja e burrit, është dielli i shtëpisë". Njeriu që paska gjetur bashkëshorten dhe punën që do, paska hyrë në xhenet, ndërsa ai që punon duke mos dashur, u përpëlitka.

Bota pa probleme është thjesht një imagjinatë. "Njeriu është i vdekshëm dhe dita ka mbrëmje". Nëse kërkojmë një botë për të jetuar larg brengave dhe problemeve, atëherë paskemi për të kërkuar deri në kiamet.

Të mos shqetësohesh kur kërkon një rrugëzgjdhje nga brengat dhe vështirësitë për të jetuar, do të thotë se dora nuk është në harmoni me këmbën.

"Det pa dallgë dhe njeri pa brenga, nuk ka." Nëse nuk inatosemi, nëse nuk na kap paniku dhe nëse nuk zemërohemi me njerëzit, kur përpiqemi për t'i zgjidhur dhe kapërcyer ngjarjet brengosëse, gjërat negative dhe problemet, ky është një sukses i madh.

Kam lexuar një shënim që ia kishte lënë birit të vet një major, që kishte vrarë veten para disa vitesh:

"Bir! Unë nuk munda t'ia dal me këta njerëz. Ti gjej një mënyrë për t'ia dalë mbanë!"

Ajo që unë kuptova nga kjo këshillë, është: "Edhe pse nuk kam gjetur një mënyrë për të jetuar në paqe me këtë botë, ti gjej një mënyrë për të mos hyrë në tension kundrejt atyre që ndodhin. Meqë je i detyruar të jetosh me këta njerëz, atëherë tensioni nuk ka dobi. Ti mundohu të jesh i qetë, nganjëherë duke bërë sikur nuk shikon, nganjëherë duke bërë sikur nuk dëgjon dhe nganjëherë duke bërë si budalla.

Sipas meje, kjo është një këshillë e drejtë. Ne nuk mund të presim që çdo njeri të mendojë si ne apo të jetë si ne.

Rrugëzgjdhja e kësaj, është t'i pranojmë njerëzit ashtu si janë.

Ajo që po përpiqem të shpjegoj, nuk është në kuptimin: "Ai që vjen është agai, ai që shkon është pashai". Unë dua të them që ta arrijmë vazhdimisht lumturinë në jetë, kur jetojmë ndershmerisht dhe kur përpiqemi për të drejtën.

Të jetosh, është një namaz që falet me frikërespekt ndaj Zotit, një fatiha që lexohet nga thellësia e zemrës dhe një lutje e ngrohtë. Produktiviteti është i lodhshëm, por në fund sjell lumturinë e xhenetit. Edhe pse dembelizmi sjell një rehati fizike, shpirtërisht sjell lodhje dhe vështirësi në varr.

Produktiviteti është gjendja e të qenit i kënaqur, por, nëse kjo nuk e kalon vijën e interesit dhe nuk e arrin kufirin e kënaqësisë hyjnore, kënaqësia shpirtërore nuk mund të jetë e vazhdueshme dhe tërhiqet nga qëllimi i lartë që ka. Të arrish në gradën: "In exhrije illa alallah / Shpërblimi im

është vetëm te Allahu", është një kusht i madh. Domethënë, njeriu duhet të vijë në një gjendje që, çfarëdo të presë, ta presë nga Allahu i Madhëruar.

Të jetosh, është kënaqësi e botës shpirtërore.

Të jetosh, është lumturi familjare. Lumturia është dielli i dashurisë që lind nga gjuha. Ajo e ndriçon dhe e ngroh jetën tonë.

Të jetosh, është një emocion i lartë, që sjell lidhja e formuar me Allahun (xh. xh). Ajo është zgjerim i botës dhe zgjatje e imagjinatës sonë në botën e përtejme, si rezultat i kësaj lidhjeje. Në këtë kontekst, Allah, do të thotë, Ai që na jep jetë.

Të jetosh, do të thotë të përdorim vullnetin tonë dhe të kufizojmë veten tonë. Të mjaftohemi dhe të gëzohemi me atë që kemi. Të pakësojmë pasionet, nëse nuk shtojmë dot mundësitë tona.

Të jetosh është diçka si "vrapimi i pikës për në det".

Të jetosh, është dashuri për të ecur pa ndalur e pa pashuar dhe arritje nga një gradë në gradën tjetër.

Të jetosh, është një luftë dhe përpjekje e gjatë që mund të bëhet me vetëdije dhe durim për të mos lindur në haram dhe vdekur në vend ku gjenden idhuj.

Të jetosh, do të thotë të lahesh në ujërat e të mjaftuarit me pasurinë që ke dhe të arrish pasurinë shpirtërore. Do të thotë, t'i lartësosh dhe t'i zbukurosh gradë-gradë ditët e kësaj bote, për t'u zgjuar duke buzëqeshur në mahsher.





EDUKIMI i brezit të ri NË ISLAM

Altin Torba

Dituria e edukimit të brezit të ri është një dituri ku edhe vetë hoxhallarët kanë çfarë të marrin dhe të japin. Mësimi i psikologjisë së fëmijës është një detyrë primare për çdo prind dhe edukator mysliman.

Përkufizimi i edukimit

Edukimi është gjetja e sjelljes së dëshiruar, mbjellja, kultivimi dhe konfirmimi i produktivitetit të saj. Sjellje e dëshiruar në Islam konsiderohet ajo sjellje të cilën Islami e ka vlerësuar si të dëshiruar dhe që për pasojë, gjen vlerësim dhe konsiderohet e dëshiruar tek edukatori, i edukuari dhe mbarë shoqëria.

Psikologët myslimanë na thonë, se tre parimet kryesore, që duhet të ketë në memorje prindi mysliman në procesin fisnik të edukimit të fëmijës së tij, janë: **një**: dashuria; **dy**: vlerësimi i drejtë i sjelljes dhe **tre**: procesi bindës.

Parimi i parë: dashuria.

Procesi ynë i edukimit në themelin e tij duhet të ketë dashurinë e pakushtëzuar për fëmijën tonë.

Në kuptimin e mësipërm hedh dritë fakti se në një sondazh, pasi u morën në pyetje njëmijë prindër dhe njëmijë fëmijë, ndodhi sa vijon:

Kur prindërve iu drejtua pyetja: "A i doni fëmijët tuaj?", të gjithë u përgjigjën me "po", madje një pjesë e tyre e konsideruan pyetjen në fjalë si një pyetje naive. Në krahun tjetër, kur fëmijëve të pashoqëruar me prindërit iu drejtua pyetja: "A mendoni se prindërit tuaj ju duan?", përgjigja e tyre ishte befasuese, rreth 80 – 90% e tyre u përgjigjën me "jo". Dikush prej fëmijëve thoshte: "Babi im më shumë do punën", dikush "sportin", dikush këtë e dikush atë dhe të njëjtën gjë thoshin edhe për nënën: "Ajo do më shumë

orenditë e shtëpisë, punët, etj".

E vërteta qëndron se ai që i jep përgjigje faktit se sa e do prindi fëmijën e tij, është vetë fëmija.

Parimi i dytë: vlerësimi i drejtë i sjelljes.

Ta vlerësosh drejt fëmijën tënd, do të thotë të mos shikosh se çfarë të shkakton ty sjellja e tij, por të shikosh se nga cili tipar i fëmijës buron kjo sjellje, nga tiparet e tij pozitive apo nga ato negative.

Parimi i tretë: procesi bindës.

Ne prindërit, siç thonë psikologët, duhet të jemi si shenjat e qarkullimit rrugor. Gjithësecili nga ne që ec me makinë, i sheh shenjat e qarkullimit rrugor dhe nuk vihet fare në siklet teksa u nënshtrohet atyre. Ai thotë se po i zbaton udhëzimet e këtyre shenjave me dëshirë, por e vërteta qëndron se ai është i imponuar t'i zbatojë këto shenja. Një pyetje që lind natyrshëm është: Si shpjegohet bindja e vullnetshme e njeriut në rastin në fjalë? Përgjigja është se një gjë e tillë vjen nga fakti se shenja nuk flet, por orienton në heshtje. Kështu duhet të jemi edhe ne prindërit me fëmijët tanë.

Kanë thënë: "Prindi duhet të jetë si elefanti, me gojë të vogël dhe veshë të mëdhenj, pra i flet pak fëmijës dhe e dëgjon shumë atë". Psikologët myslimanë në shpjegim të rëndësishëm të këtyre parimeve, japin dy qëndrimet në vijim:

QËNDRIMI I PARË:

QËNDRIMI I PRINDIT JOPARIMOR

Fëmija sapo ka hedhur mbi tapet një lëvozhgë bananeje.

Prindi: "Çfarë bëre kështu more? Ke apo s'ke tru ti? Kam thënë unë, se ti nuk merr vesh. Pse aty hidhet ajo? Ajo hidhet në koshin e plehrave more pleh, por gjithmonë kështu

bën ti..." Dhe të tjera ofendime, bërtitje dhe sharje.

E si mund të pritët paskëtaj që fëmija të ndihet mirë. Përkundrazi, ai së pari do të mendojë se prindi i tij nuk e do dhe së dyti do e bazojë sjelljen e tij tek frika, jo tek bindja.

Pra, duket qartë se parimi i parë, dashuria, nuk është realizuar, prandaj as që mund të mendohet nga ana e fëmijës se prindi i tij, që po silltet me të në këtë mënyrë, e do atë. Madje fëmija, faktin se prindi i tij nuk e do, e argumenton duke thënë: "E si më dashka prindi mua, kur për një lëvozhgë bananeje bën hatanë... Jo, jo, ai më shumë do tapetin sesa mua...". Madje, kjo bindje përforcohet më tej tek fëmija, kur prindi arrin deri aty sa veç britmës, sharjes dhe ofendimeve, vë dhe dorë mbi fëmijën... Është më se normal që ky të jetë konkluzioni për fëmijën dhe në fakt, po ky është konkluzioni i drejtë, ku do të arrinte çdo njeri i logjikshëm.

Në krahu tjetër, le të shohim se si ka influencuar tek fëmija qëndrimi prindëror joparimor në fjalë, sa i përket parimit të dytë, atij të drejtvlerësimit të sjelljes së fëmijës. Pra, pyetja që shtrihet vetveten në këtë kontekst, është: A është vlerësuar drejt sjellja e fëmijës përmes këtij qëndrimi të prindit?

Përgjigja sërish është "jo". Kur fëmija hedh një lëkurë bananeje mbi tapet apo bën diçka tjetër të kësaj natyre, ai nuk e bën këtë ngaqë do të shkaktojë probleme, por e bën sepse ndihet se është lënë pas dore. Gjithashtu, fëmija e bën një veprim të tillë, sepse sjellja e prindërve të tij i ka treguar atij se vetëm kur të bëjë të tilla veprime, do ta marrë vëmendjen e prindërve. Po kështu, kjo sjellja e fëmijës tregon dëshirën e tij për autonomi. Ai me këtë sjellje sikur do të thotë: "Jam edhe unë këtu..."

Në fakt, nga veprimet fëmimore të këtij lloji mund të nxirren shumë konkluzione të kësaj natyre. Është vërtetuar se një fëmijë i moshës 1-7 vjeç, i cili u bindet pa hezitim prindërve të tij dhe nuk i kundërshton ata asnjëherë, do të jetë ai që quhet "qole", pra do të jetë njeriu të cilin të tjerët e komandojnë dhe e çojnë nga të duan.

Kush nga ne prindërit do të dëshironte të kishte një fëmijë të tillë, robot të telekomanduar?

Për hir të së vërtetës, duhet thënë se shumë prej nesh nuk i kanë punët mirë me vlerësimin e drejtë të sjelljes së fëmijës, pasi siç duket, ne prindërit ende nuk e kemi hetuar faktin se: "Drejtvlerësimi i sjelljes së fëmijës nuk arrihet duke u bazuar në problemet që shkakton sjellja e fëmijës, por duke parë tiparet pozitive fëmimore, prej ku buron sjellja në dukje problematike e fëmijës sonë".

QËNDRIMI I DYTË: QËNDRIMI I PRINDIT PARIMOR

Më tej, psikologët myslimanë na japin shembullin model të një prindi parimor, i cili e edukon fëmijën e tij sipas rregullave dhe parimeve islame, duke na treguar se si vepron një prind i tillë me fëmijën e tij, që sapo ka he-

*Kanë thënë:
"Prindi duhet të jetë
si elefanti, me gojë
të vogël dhe veshë të
mëdhenj, pra i flet pak
fëmijës dhe e dëgjon
shumë atë".*

dhur në tapet një lëvozhgë bana-

neje:

Me ta parë fëmijën e tij që e ka hedhur lëvozhgën e bananes, pikë së pari ai thotë me vete: "Obobo, e paskam harruar fare fëmijën tim. Shumë keq që u kujtova vetëm kur ai e hodhi këtë lëvozhgë bananeje". Paskëtaj ai shkon e merr fëmijën, e puth, e ledhaton, ia bën qejfin, e bën të ndihet rehat dhe vetëm pas kësaj, e dërgon atë te vendi ku e ka hedhur bananen dhe i thotë: "O, po kjo lëvozhgë bananeje këtu? Po kjo është problem babi, se në qoftë se ty ose babit, mamit, vëllait apo motrës i rrëshqet këmba mbi këtë lëvozhgë bananeje, atëherë rrëzohemi, vritemi dhe mund të përfundojmë në spital. Nëse babi ose mami vritet, atëherë kush do të punojë për ty, kush do kujdeset për ty, kush do të të bëjë për të ngrënë, kush do të të sjellë lodra... ? Kështu pra xhan!".

Nëse ti si prind vepron kështu me fëmijën tënd, ajo që ke bërë në këtë rast është: **e para:** i tregove fëmijës tënd se ti e do shumë atë, pikërisht duke e përkëdhelur dhe duke i shprehur dashurinë para se ta udhëzosh dhe këshillosh; **e dyta:** e binde atë se përse veprimi i tij është i gabuar.

Më tej, prindi parimor, e merr lëkurën, e merr edhe fëmijën për dore, e dërgon tek koshi i plehrave, ia jep lëvozhgën në dorë dhe i thotë: "Këtu shpirti im, këtu hidhe lëvozhgën, këtu është vendi ku hidhen mbeturinat". Pra, i thua fëmijës që ai vetë, me dorën e tij ta hedhë në kosh mbeturinën dhe, teksa ai po e hedh lëvozhgën, i thua se ky është një veprim shumë i bukur. Pastaj e merr sërish për dore, e dërgon tek vendi ku qe hedhur banania dhe i thua: "A duket tani më e bukur dhe më e pastër shtëpia apo kur ishte hedhur mbi tapet lëvozhga e bananes?"

Pas këtij procesi, i cili përfshin dashurinë për fëmijën, drejtvlerësimin dhe bindjen, ti i ke ushqyer këtij fëmijë rregullin se çdo gjë tjetër, që është një lloj me veprimin në fjalë dhe shkakton të njëjtat probleme, duhet trajtuar në të njëjtën mënyrë.

Nga sa thamë, nuk duhet kuptuar kurrsesi se fëmija duhet lënë i lirë të bëjë veprime të dëmshme, por le ta shohim në shembullin në vijim qëndrimin e psikologut mysliman:

Më merr në telefon një nënë fëmije dhe më thotë: "E kam tepruar". "Pse? – i them- si është puna?" Më tha: "Ia kam djegur dorën vajzës sime pesëvjeçare. Vajza ime është



shumë e pabindur". I them: "Se si është vajza jote, këtë do ta vlerësoj unë, por më thuaj fillimisht se çfarë ka bërë vajza jote, që paska arritur puna deri këtu?" Më tha: "Vajza ime ka një ves shumë të keq. Kur e sheh se asnjë nga ne të rriturit nuk e ka mendjen, merr një qese dhe sendet më me vlerë, celular, unazë, çelës, pult televizori etj., i fut në qese dhe i fsheh në një vend, që edhe me dajak nuk e tregon se ku ndodhet; gjë e cila na ka sjellë shumë probleme. I kam bërë titur, madje edhe kam vënë dorë në të, por pa rezultat, ajo vazhdon në të sajën. Një ditë, pasi e kishte përsëritur për të disatën herë këtë veprim, e thirra dhe i thashë: 'Me cilën dorë e bën ti këtë veprim?' 'Ma nxori dorën e djathtë duke u mburrur. Unë mora një çakmak dhe ia dogja dorën, duke i thënë se kështu e meritonte kjo dorë, që bën një rrëmujë të tillë. Problemi është se ajo edhe pas kësaj, sërisht vazhdon në të sajën.' I thashë: 'Mos, çfarë ke bërë? Kjo sjellje, që ti e ke quajtur të gabuar, është prej sjelljeve që bëjnë vetëm fëmijët që janë gjeni.' 'Si ka mundësi?' – më tha. I thashë: 'Në këtë që më the, dalin në pah shumë prej tipareve të gjenit të ardhshëm: **i pari**, është se fëmijët që janë gjeni, jepen shumë pas sendeve me vlerë; **i dyti**, ata interesohen t'i grumbullojnë sendet me vlerë në një vend të vetëm; **i treti**, ata i mbajnë këto sende në një vend, të cilin s'e di askush tjetër përveç tyre; **i katërti**, gjeniu i ardhshëm është shumë këmbëngulës, sakrifikues, i durueshëm dhe s'fdues; si dhe një sërë cilësish të tjera të gjenit, që unë shoh të gjenden tek fëmija yt.' 'Ti – i thashë kësaj nëne – me këtë sjelljen tënde po i sakaton këto tipare të gjenit të ardhshëm, që për më tepër, është fëmija yt, për të cilin ti pretendon me të drejtë se po mundohesh dhe rropatesh. Ajo që ne duhet të bëjmë në rastet kur tiparet gjeniale të fëmijës sonë bëhen burim dëmi për ne, është thjesht t'i orientojmë këto tipare në drejtime që nuk na dëmtojnë, t'i ushqejmë dhe të mos i sakatojmë këto tipare. Por është vërtetë krim që ne sillemi në forma të tilla, që i gjykojmë këto tipare të mrekullueshme të fëmijëve tanë...'

Në rastin në fjalë, psikologu mysliman e porositi këtë prind të konsultohej me tregtarin e dyqanit të lodrave dhe t'i blinte vajzës së saj të mençur disa lodra, që do mund t'i ushqenin tiparet gjeniale të saj. Këtu mundimet e këtij prindi morën fund, ndërsa tiparet e fëmijës filluan të ushqeheshin më së miri. Prindi në fjalë, vetëm pas pak ditësh, shumë i kënaqur, e kontakton psikologun dhe i thotë se tani, pasi i kishte blerë lodrat, çdo gjë ishte në rregull: edhe ajo si nënë kishte rënë rehat e edhe vajza e saj ishte shumë e kënaqur dhe e relaksuar... Ndërsa, pas disa kohësh, ky prind e kontakton sërisht psikologun dhe lidhur me vajzën e saj, tanimë në klasë të dytë, i thotë, se ajo është një gjeni me kuptimin e vërtetë të fjalës dhe është thujse e paarritshme nga bashkëmoshatarët e saj; di përmendsh emra shtetesh, kryeqytetesh, lumenjsh, liqenesh, detesh e oqeanesh, di gjëgjëza të shumta, mban mirë mend numra celularësh etj., si dhe është përfaqësuesja e qytetit në olimpiadat e ndryshme në rangun e moshës së saj, me pak fjalë i ka mrekulluar të gjithë...

Pra, një rregull shumë i rëndësishëm i drejtvlerësimit, është hetimi i sjelljeve të fëmijës me synimin e zbulimit të tipareve pozitive të këtyre sjelljeve, pastaj orientimi i drejtë i këtyre tipareve e jo kundërshtimi dhe rrënimi i tyre...

Së fundi, lidhur me edukimin e fëmijëve, na vijnë në ndihmë edhe faktet e rëndësishme në vijim:

Shkencëtarët përmendin se moshë e njeriut 1-7 vjeç është moshë, në të cilën realizohet 90% e formimit të personalitetit të njeriut, bindjeve, vlerave dhe aftësive të gjenit të ardhshëm; nga 7 – 14 vjeç formohen vetëm 10% e vlerave të mbetura; ndërsa nga 14-21 vjeç formohet orientimi i njeriut, thënë ndryshe, kahu i tij në jetë. Bazuar në këto fakte, nëse duam që personaliteti i fëmijës sonë të jetë sa më i formuar, koha vendimtare është deri në 7 vjeç; nëse duam një fëmijë të kompletuar, koha është nga 7-14 vjeç dhe, nëse duam një fëmijë në rrugë të mbarë, jo rrugë pa krye, duhet treguar kujdes me të nga 14-21 vjeç.

Imam Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me të!), nxënësi i profetit Muhamed (lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të), ka thënë: "Lozni me fëmijët tuaj deri në shtatë vjeç, edukojini ata deri në 14 vjeç dhe pas kësaj moshe trajtojini si shokë". Bazuar në këtë thënie të imam Aliut (Allahu qoftë i kënaqur me të!), për një formim sa më të denjë të temperamentit të fëmijës sonë, fillimisht duhet të formojmë tek ai vlerat dhe parimet e duhura përmes zbatimit, pastaj përmes edukimit të denjë dhe së fundi, përmes trajtimit të fëmijës si shok.

Sa i përket adoleshencës, psikologët myslimanë thonë se moshë 14 – 28 vjeç përbën moshën, kur njeriu konsiderohet si sendet që kanë përsipër shenjën "fragile-lehtësisht i thyeshëm". Prandaj duhet të tregohet shumë kujdes me ta në procesin e mbartjes së tyre për në "vendet" që dëshirojmë. Psikologët na ftojnë që vazhdimisht ta kemi në mend këtë realitet të adoleshentit.

Sigurisht, psikologjia islame ka shumë material lidhur me çështjen në fjalë dhe të gjithë jemi të ftuar të studiojmë sa më shumë në këtë lëmë. Psikologët myslimanë e vlerësojnë studimin e psikologjisë së fëmijës, me të drejtë, si një detyrë obliguese, pasi një nga përgjegjësitë më të rëndësishme, me të cilat na ka ngarkuar Allahu i Lartësuar janë pikërisht fëmijët tanë.

Psikologët myslimanë na ftojnë të sillemi me fëmijët tanë si edukatorë dhe jo si gjykatës, policë apo xhelatë. Për fat të keq, shumica jonë po i bëjnë të gjitha rolet e lartpërmendura, përveç atij të edukatorit; jemi kthyer në gjykatës e policë të fëmijëve tanë, duke i gjykuar ata me "keq e mirë" dhe jo rrallëherë edhe duke i ndëshkuar.

Për të qenë një edukator i mirë, prindi ka nevojë për dituri, durim dhe orientim. Të gjithë ne prindërit i kemi besuar shprehjes që thotë se "të edukosh një fëmijë është art më vete"; dhe dihet se është thujse e pamundur të bësh art pa studim dhe përkushtim.

E lusim Allahun e Lartësuar të na japë sukses në edukimin islam të fëmijëve tanë. Amin!

Të blesh lumturinë

Një studim i bërë në perëndim, nxori në pah se njerëzit që e kanë bërë zakon dhënien e lëmoshës të varfërve (edhe nëse është e vogël si 1 apo 2 dollarë), e ndjejnë veten shumë më të lumtur. Përsëri, një studim tjetër në perëndim, vërtetoi se humanizmi është njëri prej faktorëve më kryesorë që shton lumturinë. Po ashtu, është zbuluar se këta lloj njerëzish, jo vetëm që flenë rehat, por në të njëjtën kohë, jetojnë edhe më gjatë.

Studimi që psikologët e Universitetit Michigam bënë mbi 423 çifte të moshuara, përgjatë pesë viteve, dha rezultat pro barmirësve me një ndryshim të qartë. Përgjatë këtij studimi, kishin vdekur 134 prej këtyre të moshuarve. Pastaj doli në pah se numri i të vdekurve bamirës, pothuajse ishte sa gjysma e të vdekurve që nuk kishin ndihmuar asnjëherë...

Sigurisht, ne nuk kemi nevojë për referencat perëndimore rreth urtësisë, virtytit dhe rezultateve pozitive shpirtërore e materiale të infakut (dhënies për hir të Allahut) dhe humanizmit, sepse të gjitha këto, besimtarët i kanë ditur shumë më parë. Ata mësuan nga i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, që para 1400 vjetësh se infaku, bujaria dhe humanizmi janë çelësi i dynjasë, ahiretit dhe prehjes shpirtërore.

Sahabët e nderuar, që ishin nxënësit e Hz. Pejgamberit (a.s.), mësuan prej tij aq shumë gjëra, saqë për hir të Allahut të Madhëruar dhe për qetësinë e tyre shpirtërore në këtë botë, arritën të hiqnin dorë nga çdo gjë që kishin. Ata shfaqën shembujt më të bukur të infakut. Në një kuptim, blenë me infak lumturinë dhe qetësinë shpirtërore të dy botëve. Ejani t'i vëmë veshin ngjarjes që tregon përpikërinë që kishin sahabët e nderuar në çështjen e bamirësisë, për të cilin edhe shkencërisht është vërtetuar se jep qetësi shpirtërore.

Një ditë të nxehtë, biri i Xhafer b. Ebu Talibit, Abdullahu, i cili ishte vëllai i madh i Hz. Aliut (r.a.), hyri në vreshtin e hurmave të një fisi. Ndërkohë që Abdullahu po pushonte aty, pa se robit që punonte në vreshtë, i erdhën për ushqim të vaktit tri copa bukë.

Kur robi po fuste në gojë njërin prej copave të bukës, përpara tij u shfaq një qen që dukej qartë se ishte i uritur. Ai ia dha qenit bukën që kishte në dorë. Qeni e hëngri bukën menjëherë. Robi ia dha qenit edhe copën e dytë. Qeni e hëngri edhe atë me një kafshatë. Pastaj ia dha qenit edhe copën e tretë. Ndërkohë që po ngrihej për t'u kthyer në punën e tij, Abdullahu (r.a.), që e pa çdo gjë nga larg, iu afrua dhe e pyeti:

-O rob! Sa ushqim kish për sot?

Robi iu përgjigj duke hezituar:

-Ja, këto tri copa bukë.

-Atëherë, përse nuk le asgjë për veten tënde?

-Pashë se qeni ishte shumë i uritur dhe nuk desha ta lija në atë gjendje.

-Po ti, çfarë do të hash tani?

-Do të agjëroj.

Abdullah b. Xhaferi (r.a.), e pyeti robin për shtëpinë e zotërisë së tij. Pastaj shkoi dhe bleu vreshtën e hurmave bashkë me robin. U kthye dhe i tha robit se e kishte blerë vreshtën bashkë me të nga zotëria i tij. Pastaj shtoi:

-Po të jap lirinë. Edhe këtë vreshtë po ta dhuroj ty.

Kur Abdullah b. Xhaferin (r.a.), i cili njihej për bujarinë e tij, e pyesnin se njihte apo jo dikë më bujar se veten, tregonte këtë ngjarje. Ndërsa, kur i thoshin:

-Por ai i dha qenit thjesht tri copa bukë, ndërsa ti i dha atij një vreshtë të madhe dhe lirinë:

-Ai dha çdo gjë që kishte, ndërsa unë vetëm një pjesë...

A. Jasîn Demirxhi

La tahzen

Mos u brengos

Në një dërrasë të nxirë nuk mund të shkruhet. Nëse Allahu Teala të jep ndonjë fatkeqësi apo të bën të qash, dije se me këtë Ai dëshiron të pastrojë tabelën e zemrës, për të gdhendur mëshirën e Tij.

La tahzen

Mos u brengos

Frika, uria, pakësimi i pasurisë dhe sëmundja, nxjerrin në pah thesarin e shpirtit.

La tahzen

Mos u brengos

Junusi u poq në barkun e peshkut. Junusi doli në tokë, ngaqë madhëroi Allahun. Të durosh, është tesbih e shpirtit. Durimi është urë. Kështu që, mos u anko kur të kalosh, sepse rruga jote, sidoqoftë, do të të shpjerë në xhenet.

La tahzen

Mos u brengos

Nëse halli bëhet shkak për të përkujtuar fshehtazi Allahun (xh. xh), atëherë ai është më i mirë se e gjithë pasuria e kësaj bote. Lutja pa halle është e ftohtë. Duaja me shqetësime vjen nga zemra dhe dashuria. Durimi është çelësi i halleve dhe shqetësimeve.



HYRJE RRETH TË LEXUARIT

1

Të lexuarit nuk duhet të ketë asnjë lidhje me të ashtuquajturin *pasion*, ashtu siç e përdorin dhe e kuptojnë këtë fjalë pjesa dërrmuese e njerëzve në përditshmërinë e tyre të ngjyrosur nga një shkujdesje që mpin rëndë ecurinë e qenësorës. E si mund të jetë *pasion libri*, kur edhe futbollit, notit, bilardoja, loja me letra, dominotë etj., etj. janë po pasione!

2

Të lexuarit, sidomos, nuk duhet të na shkëpusë nga të jetuarit, nga misioni për të përmirësuar veten e më pas rrethanat ku jetojmë. Të lexuarit nuk duhet të na bëjë pasivë apo të ndrojtur në raport me të afërmit tanë; sikundërse, nga ana tjetër, nuk duhet të na bëjë të dhënë pas atyre që nuk i njohim, përdërisa janë të panjohur për ne. Është pikërisht arti i romanit që e shkakton këtë gjendje tëhuajësuese.

3

Libri ka shumë cilësi të përbashkëta me një shok apo me një mik tonin. Për shembull, libri, ashtu si një i afërt i yni, ka prirjen t'i durojë e t'i justifikojë disa sjellje jo të hijshme tonat me të: kur e harrojmë për njëfarë kohe, duke e lënë të lexuarit përgjysmë dhe, kur rikthehemi për ta takuar, është i gatshëm të na kujtojë fillin e humbur. Apo kur blejmë një libër të ri, që do të thotë se kemi vendosur të krijojmë miqësi, por më pas e lëmë në harrësë diku në bibliotekën tonë apo në ndonjë qoshk pa e lexuar, madje pa i hedhur asnjë sy; dhe kur një ditë, ashtu befasisht, kujtohemi që e kemi dhe bëjmë t'i zgjasim dorën, ai është krejt i gatshëm të pranojë për të kuvenduar me ne si ditën e parë kur kemi njohur, pavarësisht se rikthimi ynë tek ai mund të ndodhë edhe pas disa vitesh.

4

Të lexuarit nuk duhet të na prishë balancën e nevojshme ndërmjet përjetimit dhe të të menduarit, sepse kur mbizotëron përjetimi mbi të menduarit, njeriu përballet me utopikën në formë pasive, ndërsa kur mbizotëron të menduarit mbi përjetimin, ka përsëri përballje me utopikën, por në formë aktive. Kjo e fundit, me gjasë, është më problematike.

5

Të lexuarit kultivon te njeriu maturi dhe, mbi të gjitha, na shtyn të mendojmë, aq më tepër sot që njeriu mendon përherë e më pak, sepse një jetesë që dominohet nga ndërveprimi me mjete të caktuara, që i takojnë botës së teknologjisë nuk ta lejon një gjë të tillë. Teknologjia na thotë që nuk duhet të mendoni, se mendoj unë për ju; prandaj dhe, jo pa qëllim, teknologjia i ka hesapet e hapura me librin, duke e kërcënuar atë herë pas here me ushtarë të caktuar. Mjafton thjesht të kemi parasysh faktin që vetëm njeriu mendon në këtë univers, të paktën me aq sa dimë ne, për t'u ndërgjegjësuar si duhet për rëndësinë fundamentale të çështjes.

6

Të lexuarit na mbron nga format që rrezikojmë të marrim nga shtypjet intensive të shtypit të përditshëm, pra nga bota e informacionit, ku ngarkesa trysnuese dhe fundekrye e panatyrshme, që vjen nga "njohja" me njerëz, ngjarje, vende e zhvillime të caktuara, e mbush njeriun me të dhëna pa kurrfarë rëndësie, me imazhe¹ pafund, të ngjyera si ngaherë në solucione ndrydhëse, me gjendje artificiale që shkojnë e vijnë brenda mendjes edhe për pak sekonda... e kështu me radhë – të gjitha këto, pra, nuk bëjnë tjetër vetëm sa shpërfytyrojnë hierarkinë apo rendin e gjërave në jetën tonë, atë rend që na dikton hap pas hapi se çfarë jemi në gjendje të bëjmë, madje edhe se çfarë duhet të bëjmë. Streha e librit mund të na mbrojë nga ky rrebesh.

7

Në fund të fundit, vërtetësia dhe vlera e asaj që ne lexojmë vihet në provë nga të jetuarit tonë, jo në kuptimin e ngushtë të asaj që njihet si praktike/praktikja, por shumë më përtej saj. Prandaj, pa e vënë re, ne harrojmë e lëmë

1. "Unë nuk i lexoj reklamën, sepse do ta harxhoja gjithë kohën duke kërkuar gjëra." (Kafka)



mënjëherë aspak rasteisht shumëçka nga leximet tona, pikërisht sepse nuk e kanë kaluar provën në raport me të jetuarit tonë në veçanti dhe me jetën në përgjithësi.

PAMUNDËSIA E MUNDSHMË E ROMANIT

Le ta nisim nga gjysma, ose nga fundi i një rrugëtimi përplot prova. s. idioqoftë, romani i shekullit XIX mori një mision përsipër nga njeriu për njeriun dhe me njeriun në qendër. Pra, fjala është për personazhin që gjakon me çdo mënyrë për t'u bërë personalitet e që nuk ia doli asnjëherë, ose ia doli në disa drejtime, nga ku mund të shquajmë vetëm disa cilësi të personalitetit (mjaft bindëse), si në rastin e romanit rus me Dostojevskin dhe Tolstoin, por prapëseprapë të pamjaftueshme. Të pamjaftueshme për t'u dhënë udhë shqetësimeve dhe krejt të mjaftueshme për t'i shumuar ato.

Personazhet që ne i çërmojmë për të marrë diç prej tyre dhe qëndrimeve të tyre, pikërisht këtë bëjnë me ne ose kështu na ndodh kur rrahim që të jemi si ata – në të shumtën e herëve krejt pavetëdijshëm.

Romani i shekullit XIX është një ndërmarje e pamundur, prandaj është aq i ndryshëm dhe aq larg *Don Quijote*-it. Çdo roman i këtij shekulli mund të shihet si një dëshmi e kësaj nisme të pamundur, si një rrugë pa krye, që po iu fute, më qafë paç veten!

Në këtë kuptim, romani i shekullit XX u mor në mënyrë thuajse sistematike me këtë pamundësi flagrante të romanit të shekullit XIX.

Atë që mori përsipër njeriu në shekullin XIX përmes romanit, njeriu i shekullit pasardhës e hodhi poshtë, ose tregoi me dëshmi – po përmes romanit – nismën e pamundur në të cilën diçka nuk shkonte.

A mund të themi se romani i shekullit XIX është kryesisht përshkrues/imitim dhe hera-herës i përzier me fantazi (jo me imagjinatë; sepse imagjinata mbetet një orvatje për të dalë nga kulti i vetëmjaftueshmërisë; ndërsa fantazia shërben për ta mbajtur edhe ca në këmbë këtë kult)? Apo aq sa është përshkrues, po aq është edhe një model që propozohet? Një gjë vihet re shumë ndjeshëm te romani i kësaj epoke, pikërisht mendimi që përvijohet

aty për aty kur sapo ke mbaruar së lexuari një roman tipik të asaj kohe, që është (mendim e përjetim njëherësh) se kjo që lexova duhet të ketë ndodhur patjetër ose – le ta modifikojmë ca – pikërisht kështu duhet të ndodhë, sipas autorit. Për shembull, pas leximit të *E kuaja dhe e zeza, Zonja Bovari* ose *Viti 93*. Ndërsa te romani i shekullit XX nuk e dimë se çfarë ndodh ose nuk kemi qoftë edhe një grimë sigurie se *ku fle lepuri*, si në rastin e romanit *Amerika* të Kafka-s apo *I huaji* i Camus-ë, ose *Ujku i stepës* i Hermann Hesse.

Por nuk është shaka apo çështje formimi e kulture, kur mendojmë që ne evropianët jemi fort të mëkuar e të prekur nga një, le të themi, eksperiment i tillë, që me sa duket, nuk kishte e vazhdon të mos ketë akoma një ide se ku do na shpjerë ky ngulm i shprehur me aq devotshmëri për të panjohurën/të paditurën/asgjënë, deri edhe për kryeneçësinë ngazëlluese prej viçi për të *renë*, aq kult/idhull sot. Sepse ne menduam e përsëri duam të mendojmë që jemi zotër të vetes e na lejohet të bëjmë çfarë të dëshirojmë.

Përdërisa kur hedhim shikimin nga e kaluara (zanafilla) përballëmi me errësirë dhe, kur e hedhim nga e ardhmja (përveç-kjo-bota) përsëri errësirë, atëherë si të mos provojmë e të mos eksperimentojmë si e ku të jetë e mundur nëse duket ndonjë grimë dritë në tunel... – ja një arsytim, i cili haset aq shpesh.

Libri ka shumë cilësi të përbashkëta me një shok apo me një mik tonin. Për shembull, libri, ashtu si një i afërt i yni, ka prirjen t'i durojë e t'i justifikojë disa sjellje jo të hijshme tonat me të: kur e harrojmë për njëfarë kohe, duke e lënë të lexuarit përgjysmë dhe, kur rikthehemi për ta takuar, është i gatshëm të na kujtojë fillin e humbur.

Kështu, njeriu i shekullit XX (i parë edhe si produkt i romanit të shekullit të mëparshëm) gjendet papritur ndërmjet dy errësirave, që gjithsesi shërbejnë si motivim për të kërkuar se çfarë është cenuar nga pikëpamja ontologjike.

Duke qenë se përmes ndodhies romani shënjon një parim/rregull/koncept të caktuar, mbetet vazhdimisht prë e një përpjekjeje që përvijohet pashmangshëm, pasi ajo shkaktohet nga një sfidë që vetë njeriu e ka kërkuar.

Prandaj, çdo libër lind si vijim i kësaj sfide që është kërkuar nga ne, e cila mund të jetë pro ose kundër nesh, në varësi të asaj se si

e kuptojmë dhe si e manifestojmë me pozicionin tonë.

Së këndejmi, ja përse asnjë libër nuk ia ka dalë dot të jetë Libër.

ROMANI: KUNDËRVAJTJE DHE DËSHMI

Sidoqoftë, një roman është edhe histori; pavarësisht se vetëm një histori e sajuar (*fiction*). Ndryshimi ndërmjet historianit dhe shkrimtarit, në këtë rast romancierit, është se, historiani i qaset së shkruarës dhe synon t'i rrëfejë gjërat siç kanë ndodhur; kurse romancieri, edhe pse mund t'i qaset një subjekti që ka të bëjë me të shkruarën, synon

ta paraqesë atë ashtu siç do të donte ai të ishte, ose të kishte ndodhur. Ndërsa, kur subjekti nuk ka një lidhje të caktuar me të kaluarën, atëherë romancier i ngulmon pikërisht në "se si duhet të jetë/ndodhë".

Te romancieri ka më shumë individualizëm sesa individualitet, sepse, përderisa me anë të romanit paraqet një rend të caktuar gjërash, pra një *modus vivendi*, një platformë që propozohet në vazhdimësi, ku pleksen ngjarje dhe personazhe, atëherë nënkuptimi gati sa nuk këlthet: *kështu duhet të jetë!* Mbase autori mund të mos e ketë këtë qëllim, por në këtë rast jemi të detyruar ta lëmë autorin mënjane e të merremi me veprën, e cila flet vetë fare shkoqur.

Pas leximit të çdo romani, është e pamundur që një lexuesi të kujdesshëm të mos i përvijohet një ide e caktuar, qoftë edhe si e vagullt, gjë që provon se romani shkaktonte një këndvështrim të caktuar për një çështje të caktuar, pavarësisht se a përputhet kjo ide apo jo me formimin dhe botëkuptimin e lexuesit.

Është e vërtetë që në rreshtat që hedh historiani nuk ka asgjë tjetër përveç tyre, në kuptimin që nuk ka gjë midis rreshtave. Nga ana tjetër, është po aq e vërtetë që në rreshtat që tjerromancieri, përgjithësisht, ajo që është kryesorja është ajo që duhet të pikaset midis rreshtave – pasi kjo është çështje qëllimi. Është pikërisht qëllimi që shënon dallimin.

Por, ajo që mbetet pothuajse e përbashkët, si për historianin, ashtu edhe për romancierin, është pikërisht "imponimi" që rrahin t'i bëjnë lexuesit nën presionin e vazhdueshëm (për aq sa ekziston vepra): *kështu ka rrjedhur historia* (historiani) dhe *kështu duhet të jetë* (romancieri). Në rastin e dytë kemi kundërvajtje.

Përhapja e romanit, në veçanti në shekullin XIX e në vazhdim, kryesisht në Europë, është një tregues që ngërthen një domethënie kyçe se ka diçka serioze që nuk shkon, përderisa, siç e theksuam, çdo roman lëshon thirrjen se *kështu duhet të jetë*; dhe jo siç janë gjërat në jetën e jetuar, e cila, së këndejmi, duhet t'i nënshtrohet një ndryshimi. Këtu qëndron kundërvajtja. Kjo gjithnjë nëse romanin e marrim edhe si një matës që na ofron matje (përmasa) të caktuara që shërbejnë për të marrë me mend shumëçka.

Ja përse në vendet tradicionalisht islame dhe myslimane mund të themi se romani nuk është lëvruar pothuajse fare, duke lënë mënjane raste të rralla që mbeten përjashtime, që lidhen me rrethana jashtë romanit si kulturë dhe model; sepse, sipas Islamit, jeta dhe njeriu, bashkë me të mirat dhe të këqijat, mbeten krijimi i Zotit, e jo "mbretëria e djallit".

Sipas botëkuptimit islam, në këtë jetë njeriu është

vetëm një kalimtar, ku duhet të përgatitet për botën tjetër (për rikthim) sipas mësimave profetike, pa lënë apo braktisur pjesën që i takon në këtë botë. Po sipas këtyre mësimave, njeriu që synon të vërtetën, do e gjejë atë më shumë duke vepruar sesa duke menduar; pra, në jetën e jetuar në harmoni me veten, me të tjerët dhe me natyrën që e rrethon; dhe e gjithë kjo vjen si pasojë e të vepruarit dhe jo e të menduarit. Fjala është për atë formë të të menduarit që nuk premtonte e nuk të jep mundësinë për të vepruar në drejtim të ruajtjes së njerëzores, ose të shpluhurosjes së saj dhe asaj çfarë mbetet më tej. Pra, ky lloj i të menduarit, ose kjo mënyrë mendimi e paralizon qenien, duke mbjellë thellë rrënjën e pasivitetit.

Në të shumtën e tyre, të tillë janë edhe shkrimtarët, gati të paralizuar dhe pasivë për të vepruar, dhe si rrjedhojë, të pamundur për të frymëzuar te të tjerët veprim dhe qëndrim ndaj botës; pavarësisht se kumtimet e shumë shkrimtarëve të mëdhenj janë të qenësishme e plotësisht të vërteta për jetën dhe njeriun – por këto kumte janë të kyçura për shumicën e njerëzve: ato i kuptojnë vetëm një pjesë fare e kufizuar njerëzish, të cilët, në pjesën më të madhe të kohës janë të zënë me diskutime rreth këtyre kumtimeve, dhe jo me përcjelljen e tyre, që lipset bërë përmes një modusi veprimi që farkëton/ri-përtërin njerëzoren, së cilës i duhet të përballojë tjetërsimin që imponon sprova *për një jetë të gjatë e me emër*.

Kjo pra është çështja: çfarë raporti ka romani me njerëzoren? Që romani ka ushtruar ndikime tjetërsuese ndaj njerëzores, kjo është provuar dhe provohet, por pyetja që shtrohet është se sa kanë qenë të huajsuere këto ndikime? Kjo kërkon hedhjen e një hapi të dytë në këtë hulli. I pari qenë radhët e mësipërme.

ROMANI DHE REALITETI

1

Bota e romanit është një realitet që synon t'i qaset realitetit, në mënyrë që autori të realizojë/përmbushë një qëllim vetjak (një qëndrim), qoftë edhe duke tejkaluar ligjësi të caktuara brenda realitetit në formë ose në përmbajtje, siç ka ndodhur në veçanti me disa autorë të shekullit të kaluar apo bashkëkohorë.

2

Romani e sfidon realitetin duke mbjellë te lexuesi njëfarë dëshire për t'u arratisur nga realiteti, duke e zhvendosur kështu lexuesin nga e mundshmjia në realitet drejt së pamundshmes, pra drejt utopisë së shkaktuar nga romani. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë në këtë pikë nxjerrin krye disa pyetje, jo domosdoshmërisht të qenësishme, si: A mund të na shkaktojë pasivitet leximi i romaneve? Ose,



e thënë tjetërsoj, a mund të biem pre e njëfarë ndjesie paralize përballë realitetit që na rrethon? Nëse nuk ndodh kjo, por e kundërta, duke na mbushur me një dëshirë të caktuar për të vepruar, a rrezikon të jetë i vonuar ose i parakohshëm veprimi? Ose, thjesht i pamundur?

Mund të thuhet se pse duhet të jetë pikërisht kështu, pasi fare mirë dëshira për të vepruar mund të jetë krejt e mundshme. Por, si mund të jetë e mundshme, kur ajo që kemi lexuar janë vetëm rrethana të ndërtuara nga dikush tjetër (autori), i cili nuk është si ne dhe ka jetuar ose jeton në të tjera kondita krahasuar me të tonat?

3

Nga një tjetër qasje, në të shumtën e herëve te romani fshihet një metaforë, e cila, si e tillë, e tejkalon autorin dhe u takon edhe të tjerëve. Një roman si *Don Quijote* e kapërcen autorin, kohën dhe hapësirën prej së cilës ka dalë, dhe kjo për një arsye krejt të thjeshtë: autori ka synuar t'i kumtojë diçka njeriut si të tillë, duke mos u marrë me askënd dhe me asgjë që bën pjesë në një kohë apo hapësirë të caktuar, përveçse në rrafshin e formës, ku dihet që ngjarjet e sajua zhvillohen në Spanjë, pas rënies së Andaluzisë myslimane, që me gjasë e ka një lidhje me këtë të fundit, sidomos kur kujtojmë se rrëfyesi është "muhamedani" Sid Hamidi.

Nga ky këndvështrim, leximi i *Don Quijote*, e thënë shkoqur, të fisnikëron, pasi përgjatë gjithë rrëfimit të jep mundësinë për t'u thelluar në kuptimin e njerëzores, që kërcënohet vazhdueshëm nga tjetërsimi që rrethon genien-në-botë.

4

Romani ka lindur edhe si nevojë për të fshehur mesazhe të caktuara, që për arsye të ndryshme nuk mund të thuhet drejtpërdrejt, por vetëm tërthorazi; dhe mbase mënyra më e qëlluar për ta arritur këtë është metafora, pa lënë aspak mënjane simbolikën dhe alegorinë.

E dimë fort mirë se shpeshherë rrethanat na detyrojnë të mos e themi hapur/shkoqur një gjë, gjë që na ndodh shpesh në marrëdhënie me të tjerët, dhe për pasojë, shtrëngohemi të zgjedhim forma të caktuara shprehjeje, ku me kohën kuptojmë që bëhen pjesë e personalitetit tonë; dhe më tej (duhet të) kuptojmë se ka diçka që nuk shkon në një shoqëri, përderisa lind nevoja të flasësh duke përdorur një figurë të caktuar letrare ose me nënkuptime; por, kjo e fundit u përket artistëve, pra krijuesve në fusha të ndryshme artistike.

Më shumë sesa rezultat i të menduarit, metafora, në thelb, mbetet dhunti; dhe shembulli më tipik është autori i *Don Quijote*, Cervantes-i, i cili, përveç këtij romani ka edhe disa të tjerë, por edhe disa vëllime me poezi, që aspak rastësisht pothuajse nuk njihen fare nga lexuesi.

Pra, e shprehur ndryshe, është vepra ajo që e bën autorin, dhe jo anasjelltas. Nëse do që ndryshe puna, i bie që të gjitha veprat e tjera të Cervantes-it të ishin në nivelin e *Don Quijote*, por ja që nuk është aspak kështu.

Vepra e provon vetë identitetin/burimin e saj metafizik. Është forma ajo që, sapo shfaqet brenda kohës dhe hapësirës, na bën që këtë identitet/burim ta kërkojmë diku

po brenda kohës dhe hapësirës. Duke mos pasur asnjë rezultat në këtë kërkim, dhe tanimë, duke e ditur që nuk do ketë ndonjë rezultat, e gjithë kjo ka shkaktuar një paradoks: pretendohet që kërkimi është më i rëndësishëm se e vërteta, pra më i rëndësishëm se burimi!

AUTORI DHE PERSONAZHI

Le ta nisim me një pyetje:

A mund të themi se galeria kryesore nga ku autori (poeti/shkrimtari) nxjerr materialin për veprën është vetë vetja e tij? Mendoj se nuk përbën asnjë problem përgjigjja me *po* ndaj kësaj pyetjeje, edhe nëse kjo *po* qëndron si konfirmim i një të vërtete të pjesshme në këtë mes.

E kë mund të njohë më mirë se veten autori i një poeme apo i një romani? Padyshim që askënd. Personazhet e ndryshme brenda një romani mund të shihen si *alter-ego*-t e autorit, përmes të cilëve kërkon të bëjë diçka për të njohur veten; për t'i dhënë përgjigje vetes për pyetje që nxjerrin kryet herë pas here; për t'i dhënë të drejtë një të vërtete që besohet nga ana e autorit; për të paralajmëruar rreth një gjëje; për të "gjykuar" një ngjarje të caktuar të së shkruarës e kështu me radhë.

Thellë-thellë personazhet e një shkrimtari kanë diçka të përbashkët, pavarësisht nga fakti se mund të shfaqen të ndryshëm apo krejtësisht të ndryshëm. Personazhet e Tolstoit nuk mund të jenë kurrë ato të Balzac-ut, sepse Tolstoi është ai që është dhe, Balzac-u, po ashtu. Sepse personazhet e të parit kanë shumëçka nga karakteri i tij, ashtu sikurse ato të të dytit karakterizohen nga tipare të caktuara të karakterit të tij. Prandaj, biografitë dhe sidomos autobiografitë e shkrimtarëve na shërbejnë jo pak për të hyrë në botën e personazheve të tyre.

Kjo që parashtroam gjer më tani, i përket më shumë formës së një veprë letrare, por jo se nuk ka lidhjet e veta me përmbajtjen.

Natyrisht, për të ndërtuar një përmbajtje të caktuar shkrimtarit i duhet të merret me gjëra konkrete, si: një ose disa njerëz, një ose disa vende, një ose disa ngjarje, një ose disa sende e kështu me radhë. Duhet thënë se për botën e artit gjërat ekzistojnë konkretisht, e asnjëherë në një trajtë të përgjithshme e të papërcaktuar. Së këndejmi, kemi Akilin, Uliksin, Kleopatërën, Don Kishotin, Hamlet-in, Ana Kareninën, Jozef K. -në etj. – personazhe konkrete që ndjekin e duan me ngulm të kuptojnë fatin e tyre e të për-kasin diku. Në këtë mënyrë, krijimtaria artistike mbetet ajo veprimtari që lidhet në mënyrë të pandërprerë me çështjen e personalitetit. Te *Lufta dhe paqja* hasemi me 529 portrete, ndërsa te *Komedia hyjnore* përballemi me një botë të tërë personalitetesh, ku asnjëri nuk është lënë pas dore; asnjëri nuk përhum në masë/turmë; secili prej tyre është shpirt më vete dhe ekziston aq realisht me përgjegjësinë dhe mëkatin e vet, sa që pamja e Gjyqit të tmerrshëm me miliarda njerëz që qenë e shkuan na duket krejt e mundshme dhe e njëmendtë. E njëmendtë në përjetimin e genies dhe larg mendjes që ka shtypur dhe i ka zënë vendin përjetimit.

Afresket në *Cappella Sistina*, të frymëzuara nga pjesa

biblike për zanafillën, përbëjnë një galeri të pazakontë fytyrash, krejtësisht të individualizuara, shkurt personazhe. Ajo që e bën një portret personazh, është individualiteti, bota e brendshme, liria – që është kulmi, kusht i patjetërsueshëm për të ruajtur gjendjen zanafillore dhe për ta përmbyshur atë. Personazhi nuk është identik me fytyrën njerëzore: ai është një synim që pasqyrohet në të. Personazhi dhe natyra korrespondojnë si shpirti dhe trupi, cilësia dhe sasia, kultura dhe qytetërimi, vetëdija dhe përhumbja, drama dhe utopia.

Personazhi i kundërvihet natyrës ngaqë është i lirë, i papërsëritshëm dhe i pavdekshëm në një farë mënyre. Natyra është (përbën) barazi, homogjene, koincidence dhe rastësore (!). Ndërsa personazhi është individualitet, spontaneitet, liri, madje përbën gjithnjë një mrekulli unike.

Përmes personazhit autori kërkon të gjejë ose të konfirmojë personalitetin e tij ose ta mbajë të gjallë atë. Jo rastësisht autori merret aq gjatë me personazhin e tij, ku një rast përfaqësues dhe emblematisht është *Don Kishoti* i Servantesit ose *Ana Karenina* e Tolstoit, vepra të cilat shkojnë rreth njëmijë faqe secila, duke na shfaqur dimensione nga më befaseset të jetës së këtyre personazheve, e cila reduktohet në një kullm proverbial, çast i cili jepet si gjasë për të ngjizur personalitetin ose për ta ripërcaktuar atë.

Nga Raskolnikovi te Josef K.

Libri i parë është *Krim dhe ndëshkim*, i Dostojevskit; ndërsa i dyti, *Procesi* i Kafka-s. Kujtesa për këta dy tituj është plotësisht e motivuar, përderisa m'i ofron pa ndonjë përsiatje nga ato **sistematiket** që na ushtrojnë trysni me të dhëna racionale, që më pas na duhet t'i rendisim për të qenë objektivë apo shkencorë e gracka të tjera të kësaj natyre, që kanë si stinë të vazhdueshme dimrin.

Romani i parë, *Krim dhe ndëshkim*, është më i hapur me lexuesin; duke u nisur që nga titulli i cili të orienton për t'u përgatitur për dy gjendje me të cilat do përballësh – pra, me *krimin* dhe *ndëshkimin*. Natyrisht, deri këtu nuk ka asgjë të pazakontë, pasi është krejt normale, madje e domosdoshme, që për një *krim* të caktuar duhet të ketë edhe një *ndëshkim* të caktuar. Por, cili është *ndëshkimi*: gjendja në "liri" që vijoi pas krimit apo dënimi me internim, ("riedukim") që iu dha Raskolnikovit pasi u vërtetua se ishte fajtor?

Sikurse vihet re edhe përgjatë romanit, nuk lipset ndonjë përpjekje akademike për të kuptuar që *ndëshkimi* ishte pikërisht gjendja e brendshme e Raskolnikovit fill pas krimit. Që në çastin që ai kryen vrasjen e dyfishtë, gjendja e tij e brendshme merr një drejtim krejtësisht tjetër, rëndohet sa s'ka ku të vejë me peshën e papërbalueshme të fajit. Çdo gjë në jetën e tij mbetet në vendnumëro ose

përhumbet diku ndër shtjellat e qenies dhe vendin qendror ose hapësirën më të madhe e zë përjetimi i vrullshëm i krimit që kish kryer.

Pothuajse të gjithat ditët pas aktit kriminal janë të njëjlojta për të: ndrojtje në përsëri, fiksime mbërthyes, përshtjellime të vrullshme mendimesh, që sa vinë e bëhen edhe më ngatërruese, pendesë që nuk gjen një vend ku të shprehet e ku të blatohet, përbalje e ashpër me fenomenin e fatit (caktimit), pasiguri e plotë për të ardhmen dhe mbi të gjitha, një nevojë e ethshme për rikthim (pastrim/shlyerje/dalje/çlirim).

Ndërsa dënimi (që nuk mund të jetë asnjëherë *ndëshkim*) që merr në fund pasi provohet fajësia, është vetëm sheshim i konfliktit të tij në rrafsh horizontal (marrëdhënia me tjetrin me të drejtat e ndërsjella, shoqëria dhe ligjet që e **sistemojnë** atë), por jo edhe davaritje e problemit të tij vertikal, që me gjasë e ka tejkaluar apo shlyer përmes gjendjes në "liri", pra përmes *ndëshkimit* që përjetonte së brendshmi.

Një rast tjetër është *Procesi* i Kafka-s. Te ky roman, në njëfarë kuptimi, kemi vetëm *ndëshkimin*, gjendja e cila zë të gjithë romanin. Që në rreshtat e parë të rrëfimit, supozohet që Jozef K. (me gjasë...) kish bërë një faj, dhe për "këtë" ai shoqërohet krejt papritur nga dy vetë të cilët e vënë në dijeni se e pret një proces gjyqësor që është hapur për të, pa i dhënë kurrfarë shpjegimi se pse.

Jozef K., ashtu si Raskolnikovi, nis të përjetojë *ndëshkimin* e tij në "lirinë" e kushtëzuar, por ndryshe nga ky i fundit, i cili e dinte fare mirë se pse ndodhej në atë gjendje *ndëshkuese*, Jozef K. nuk dinte asgjë se çfarë kishte bërë, në mënyrë që të justifikonte procesin gjyqësor që ish hapur nergut për të.

Mos ndoshta ai kishte bërë vërtet diçka, pavarësisht se nuk i kujtohej asgjë? Apo/ose ishte thjesht një i dyshuar dhe duhej të përballlej me një trupë gjyqtarësh, të cilët kërkonin të vinin drejtësinë në vend?

Apo mos ndoshta ky është realiteti i secilit prej nesh sot, ku pushtete të caktuara brenda shoqërisë sa vijnë e bëhen më të koklavitura dhe për rrjedhojë, kështu siç po marrin punët në një botë (që është mpirë nga harresa e Qenies) pa Zot, nuk është çudi që të shpallemi të fajshëm dhe të na kërkohet të japim llogari pa ditur asgjë se për çfarë?

Absurdin dhe thellësinë religjioze i atribuon Kamyja Kafkës në esenë e tij depërtuese te *Miti* i *Sizifit*. Plotësisht të vërteta këto dy cilësime. Sepse, që në çastin që harrohet Qenia, rrjedhimisht harrohet edhe vetja (qenia), dhe kështu absurdi bëhet sinonim i jetës sonë. Së këndejmi dhe shprehja e famshme "jetë absurde"; pra, jo që "jeta është absurde", por ajo e disave është bërë e tillë.



Zemra e pastër

M. Sami Ramazangollu

Allahu Teala urdhëron:

“Mos më turpëro në Ditën, kur do të ringjallen njerëzit, në Ditën, kur askujt nuk do t’i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!” (esh-Shuara, 87-89)

Zemër e pastër, është zemra e pastruar prej dobësive morale, si mendjemadhësia, smira, dashuria për pasurinë dhe ambicia për pozitën. Profeti ynë (a.s.), na paralajmëron se “...Ai që në zemrën e tij ka qoftë edhe një grimcë mendjemadhësie, nuk do të hyjë në xhenet.” (Muslim, Iman 148) Prandaj, pa u pastruar nga mendjemadhësia, zemra nuk mund të quhet e pastër.

Edhe Iblisi i mallkuar, megjithëse adhuroi Allahun vite të tëra, për shkak të mendjemadhësisë u mallkua dhe u dëbua përjetë. Në të njëjtën mënyrë, edhe dashuria për pasurinë i pengon besimtarët prej adhurimit të Allahut.

Në një ajet fisnik, Allahu Teala urdhëron:

“O besimtarë, mos lejoni që pasuria dhe fëmijët tuaj t’ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin.” (el-Munafikun, 9)

Ja pra, një sëmundje tjetër e zemrës është edhe dashuria për dynjanë. Në një hadith fisnik thuhet:

“Mos e angazhoni zemrën me dashurinë për dynjanë, që të mos ju pengojë prej adhurimit, përmendjes dhe dashurisë ndaj Allahut.” (Munavi; Dejlemi, Musned)

Në një hadith tjetër, Profeti ynë (a.s.), thotë:

“Allahu Teala do t’ia prishë rehatinë dhe do t’ia vështirësojë punët atij, që gjëja e parë që mendon sapo zgjohet në mëngjes, është dynjaja.”

Megjithëse koha e namazit të sabahut është koha e adhurimit të Allahut, e duasë dhe përgjërimit, disa besimtarë e braktisin këtë dhe e angazhojnë zemrën me shqetësimet dhe dashurinë e kësaj bote. Dhe kjo, në një farë mënyre do të thotë t’i kthesh shpinën Allahut.

Dashuria për dynjanë është burimi i çdo gjynahu. Dashuria për dynjanë është më e madhja e gjynaheve të mëdha. Dashuria e tepërt për dynjanë është edhe arsyeja që sot po shohim veprimin e çdo lloj pune të ndaluar.

Njerëzit e mençur e kanë përkufizuar dynjanë me këto fjalë:

“Çfarë është dynjaja? Dynjaja është ajo që e bën njeriun të pakujdesshëm dhe e largon prej Allahut. As ari, as argjendi dhe as fëmijët nuk janë dynja, derisa ta pengojnë njeriun nga adhurimi i Allahut Teala. Nëse nuk e pengojnë atë nga dashuria dhe adhurimi ndaj Allahut, ato nuk konsiderohen dynja.”

Abdu’l-Kadir Gilani (Allahu e mëshiroftë!) ka thënë:

“Malli dhe pasuria janë të lejuara të mbahen në xhep, në shtëpi apo në dyqan. Por nuk është e lejuar të mbahen në zemër, sepse zemra e besimtarit është vend-shikimi hyjnor.”

Allahu Teala gjithmonë shikon në zemrat e besimtarëve. Në një hadith fisnik urdhërohet:

“Me të vërtetë që Allahu nuk shikon fizionominë dhe pasurinë tuaj. Ai shikon vetëm punët dhe zemrat tuaja.” (Ibën Maxhe, Zuhd, 4143)

Në këtë hadith, puna dhe zemra janë përmendur së bashku, sepse puna është përkthyesja dhe treguesja e zemrës. Ndërsa në një hadith tjetër, thuhet:

“Çdo gjë ka treguesin e saj. Dhe treguesi i besimit, është namazi.” Në shumë ajete fisnike është urdhëruar: **“Ata që besojnë dhe bëjnë punë të mira...”**, gjë e cila tregon se besimi dhe puna janë gjithmonë bashkë dhe të domosdoshme. Kjo, sepse puna, adhurimi dhe bindja, e forcojnë besimin.

“Shkatërrimi i çdo populli vjen prej një të keqeje. Ndërsa shkak i shkatërrimit të popullit tim do të jetë pasuria e dynjasë.”

“Ari dhe argjendi shkatërroi popullin që ishte para jush. Nëse nuk ruheni nga koprracia, ambicia dhe mburrja, do të jetë edhe shkak i shkatërrimit tuaj.” (Muslim)

“Të parët e këtij umeti gjetën devotshmërinë, dijen, besimin dhe shpëtimin. Kurse të pasmit e umetit tim do të shkatërrohen prej koprracisë dhe dëshirave të pafundme.” (Ramuz)

“Zemra e një të moshuari është e re vetëm për dashurinë ndaj dy gjërave: Njëra është dashuria për të jetuar shumë dhe tjetra për të mbledhur para.” (Xhamiu’s-Sagir)

“Pleqëria është një shenjë që mjafton si këshillë.”

“Ata që vdesin, pasi e kanë kaluar jetën me adhurime dhe devotshmëri, Allahu do t’i ringjallë të lumtur. Kurse ata që vdesin, pasi e kanë kaluar jetën duke bërë gjynahe dhe vrapuar pas dynjasë, do t’i ringjallë të humbur e të dëshpëruar.” (Munavi)

“Xhibrili (a.s.), më ka thënë:

O Muhamed! Jeto si të duash, por patjetër do të vdesësh. Duaj kë të duash, por patjetër do të ndahesh prej tij. Vepra çfarë të duash, por çfarëdo që të veprosh, e mirë apo e keqe qoftë, atë do të gjesh!”

Ky hadith fisnik, është mësim për të gjithë umetin. Prandaj, ai që vepron të mirën apo të keqen, një ditë do ta gjejë atë përballë. Gjithashtu, të gjithë do të vdesin e do të ndahen prej asaj që duan.

Bejazid Bistami (Allahu e mëshiroftë), ka thënë:

Që prej tridhjetë vjetësh, në adhurimet e mia iu binda nefsit (egos) tim. Një ditë, dëgjova dikë të thoshte:

- O Bejazid! Thesaret e Allahut mbushi me adhurime. Nëse dëshiron të takohesh me Allahun, duhet ta ulësh e ta poshtërosh nefsint tënd dhe të bësh punë të mira e të sinqerta.

Koha e edukimit të njeriut

Xhafer Durmush

Kurani Fisnik urdhëron që ta përdorim kohën me vetëdije dhe të arrijmë rezultate të begata nga kapitali që po mbaron. Ndërsa ajeti i pesëmbëdhjetë i sures el-Ahkaf, tregon rëndësinë jetike që ka mbartja e trashëgimisë së mirë për në ditët e nesërme, të cilën e kemi marrë nga e djeshmja, duke e gjallëruar atë në ditët e sotshme:

"Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellshëm ndaj prindërve të tij. Nëna e mbart dhe e lind atë me mund. Ai mbartet dhe ushqehet me gji për tridhjetë muaj dhe, kur arrin në moshën e burrërisë e mbush dyzet vjet, ai thotë: 'O Zoti im! Më frymëzo të të falënderoj për begatitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi dhe të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur! Më dhuro pasardhës të mirë! Tek Ty kthehem i pënuar dhe Ty të dorëzohem!'". (el-Ahkaf, 15)

Në ajetin fisnik ftohet për në zgjim njeriu, i cili ka arritur kohën që konsiderohet si fillim i moshës së pjekurisë. Prej tij kërkohet të shikojë se nga cila pikë e ka filluar jetën, të falënderojë prindërit për përpjekjet e mëdha që kanë bërë për të dhe të falënderojë Allahun Teala, i cili ia ka dhënë të gjitha këto mirësi atij. Njeriu duhet t'i kërkojë ndihmë Allahut të Madhëruar për ta falënderuar Atë dhe të njëjtën vetëdije duhet të përpiqet t'ua trashëgojë brezave pas tij.

"O Zot! Më jep mua dhe pasardhësve të mi vazhdimisht prej mirësisë Tënde!"

Njeriu në moshën dyzet vjeçare, duhet t'i shohë gjithë këto mirësi që i ka dhuruar Allahu Teala dhe të bëjë një llogari serioze, në mënyrë që ta kryejë falënderimin për to. Ai duhet t'i kërkojë llogari vetes së tij, që ka shijuar shumë gjëra në emër të mirësive të kësaj bote. Kjo nuk është llogaria e pasurisë, që të mbajë peshoren e atyre që ka fituar dhe atyre që ka harxhuar deri më tani. Kjo është llogaria e suksesit që ka arritur t'ua japë fëmijëve vlerat që ka marrë nga gjyshërit.

Sipas komentimit të ajetit, Hazreti Ebu Bekri (r.a.), e

1. Për shkak se i kemi shtjelluar më parë dy titujt e parë, për të cilët bëhet fjalë në ajetin fisnik (Shik. *Kirk Yaş Muhasebesi*, Cafer DURMUŞ, *Altinoluk*; nr. 251), këtu do të shtjellojmë vetëm të tretin.

arriti suksesin në kuptimin që flitet në ajetin fisnik. Me përpjekjet, begatinë e lutjeve të tij dhe me mirësinë e Allahut të Madhëruar, e gjithë familja e tij, me në krye prindërit, u nderuan me Islam.

Ajeti fisnik, me metodën e tij koncize, paralajmëron se falënderimi ndaj Zotit (xh.xh.), ka kuptim, aq sa jep flizë të begatshme që shtrihen drejt së ardhmes. Nisur nga kjo, njeriu duhet të bëjë plane të detajuara në lidhje me personat për të cilët është përgjegjës t'i edukojë. Siç na e ka bërë të qartë edhe i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ai duhet "të përpiqet t'u lërë një trashëgimi të mirë nipërve të tij".

Për shembull, le të mendojmë për moshën nga zero në gjashtë vjeç:

Kjo periudhë kërkon interesim të veçantë dhe është shumë e rëndësishme në edukimin e fëmijëve, sepse në këtë periudhë formohet personaliteti dhe merren zakonet. Të gjitha vlerat ngjizen ndërmjet moshës zero deri në gjashtë vjeç, lulëzojnë ndërmjet moshës gjashtë deri në dymbëdhjetë vjeç dhe pastaj japin frytet e tyre përgjatë gjithë jetës. Për këtë arsye, vitet e para të fëmijërisë janë periudha e mundësive të arta, që fitohen ose humben për një popull apo familje. Nëse e neglizhojmë dhe ia lëmë dikujt tjetër fushën në të cilën duhet të punojmë në atë periudhë, atëherë nuk do të kemi më mundësi për ta gjetur përsëri të njëjtin shans.

Sa e rëndësishme është që t'ua bëjmë të dashur atyre besimin, ibadetin, Kuranin dhe ndershmërinë, në një periudhë kur janë gati të marrin atë që u jepet. T'i mësojmë si të heshtin dhe të flasin sa duhet kur është e nevojshme... T'ua rregullojmë gabimet pa i lënduar. T'u japim mundësi për t'i rregulluar gabimet e tyre me qortime konstruktive dhe orientuese... T'i ndjekim me durim, rregull dhe dashuri në çështjen e praktikimit të atyre që kanë mësuar... Sa e rëndësishme është që të duan, të duhen dhe t'u afrohen të tjerëve me dashuri, sepse vetëm të dhënat që mbruhën me brumin e dashurisë, janë të qëndrueshme dhe të përhershme. Të mos harrojmë se çdo fëmijë, është i etur për gjërat e pastra që i jepen me dashuri. Ndërsa prindërit, janë të detyruar ta bëjnë këtë.

Nëse njeriu do të ulet dhe të mendojë duke filluar që nga mosha dyzet vjeçare, duhet të shqetësohet për çështjen bazë të llogarisë, e cila është mbartja me dashuri për në të ardhmen e trashëgimisë së marrë nga e kaluara.

Kujt do t'ia lë sexhaden time ditën kur të largohem nga kjo botë? Kujt do t'ia lë amanet tespihet, takijen dhe shaminë time? Kush do të ulet në vendin tim nëpër kuvendet, ku flisja vetëm për mirë dhe për të përkujtuar emrin e Allahut? Njeriu duhet t'i mendojë këto.

A e dëshiron fëmija i tij, po aq sa ai, të gjendet nëpër vende ku ai gjendej me plot dëshirë? A largohet nga vendet e mëkatit, në të cilat ai nuk dëshironte të gjendej? A përputhet botëkuptimi juaj kundrejt jetës me botëkuptimin e tij? Nëse jo, si mund të kompensohet ndryshimi që ka ndërmjet jush? Si mund të orientohen për te e drejta me një metodë të mirëfilltë dëshirat e pasionet që ndiqen pa dijeni dhe pa marrë parasysh parimet fetare?

Nga ajeti fisnik mund të kuptojmë qartë se këto pyetje dhe të tjera si këto, secili prej nesh duhet t'ia bëjë vetes. Baza e të gjitha sukseseve të rëndësishme është një e vërtetë, në të cilën gjendet ndjekje me durim dhe vlerësim i mundësive në kohën e duhur. Mund të themi se edhe ajeti fisnik pikërisht këtë tregon.

Ndoshta në disa punë mund të jetë e nevojshme të pritret dhe të gjendet koha e duhur, por përgjegjësia e mbartjes së besimit tonë për te brezat që janë duke u rritur e edu-

kuar, nuk mund ta përballojë një pritje të tillë, sepse jeta nuk ndalon dhe ngjarjet përparojnë me vull në rrjedhën e tyre natyrale, edhe pse ne e kryejmë apo jo detyrën tonë. Ai që lind, rritet...

Aktivitetet e fshehta, që tani po bëhen haptazi për t'i mbajtur larg gjërave të shenjta brezat që po vijnë, e shtojnë edhe një herë më shumë rëndësinë e përpjekjeve me vetëdije për të cilat bëhet fjalë në ajetin fisnik. Nisur nga kjo, ne nuk kemi luksin të humbim asnjë njeri të cilin mund ta arrijmë.

Zemra jonë nuk mund të jetë e kënaqur që ndonjëri prej tyre të shkatërrohet në anaforën e mohimit të fesë. Ne kemi përgjegjësinë t'i shpjegojmë fenë tonë të bukur, ta njoftojmë për moralin e Islamit dhe t'ia bëjmë të dashur Kuranin e ibadetin çdo njeriu që mund të arrijmë. Dhe kjo përgjegjësi, është një proces që nuk mbaron kurrë, sepse ajeti fisnik që shfaq domosdoshmërinë e një llogarie të tillë, nuk i lë pas dore edhe pjesët e tjera të kohës. Kuptimi i kësaj duhet të jetë ky:

Ai që nuk e ka bërë një llogari të tillë deri atë ditë, të paktën ta bëjë në kohën e pjekurisë dhe ta mbajë këtë vetëdije, duke mos e neglizhuar më. Para së gjithash, rëndësi ka që kjo vetëdije, të mbahet e gjallë përgjatë gjithë jetës.

Lexo, Mendo

Zbukuroje vendin tënd

Kurani Fisnik i bën të shikojnë horizontet, ata që lexojnë shembujt e tij. Vendet i fut nëpër zemra dhe zemrat i bën të gjera sa vendet. Ja, në njërin prej ajeteve, thuhet:

“Toka e mirë i jep frutat me lejen e Zotit të saj, ndërsa toka e keqe, zor se jep gjë. Kështu, në mënyra të ndryshme, Ne ia shpjegojmë shpalljet Tona njerëzve mirënjohës.” (el-A'raf, 58)

Këtu shprehen dy të vërteta me anë të përngjasimit. Zemra e besimtarit përngjasohet me tokën e mirë dhe pjellore, gjë e cila sjell begati, sepse e pranon të vërtetën kur e dëgjon. Si rezultat i këtij pranimi, nga ajo rrjedhin vepra të mira.

Ndërsa, zemra e politeistit dhe hipokritit përngjasohet me tokën e keqe dhe jopjellore. Ajo është e verbër dhe e shurdhër

kundrejt së vërtetës.

Te ajo mbijnë vetëm ferra dhe bimë të padobishme. Ajo nuk sjell përfitime, për shkak se është e privuar nga Haku dhe e Vërteta. Madje, në një lloj mënyre, dëmton çdo njeri. Nga ajo zemër dëgjohe vetëm fjalë lënduese dhe fyese. Ajo shfaq vetëm vepra që i shqetësojnë të tjerët.

Por ti, me besimin që zotëron, ke merituar të përngjasohesh me “beldei tajjibe”. Atëherë duhet t'ia dish vlerën zëmres sate dhe duhet ta zbukurosh vendin tënd. Nga lulishtja jote duhet të përhapen aroma si misku...

Pastërtia dhe ndershmëria jote duhet të dallohet menjëherë. Ti duhet të kesh fryte të begatshme që t'ia shfaqësh njerëzisë në çdo periudhë të jetës tënde.

RËNDËSIA DHE ROLI I KURANIT DHE

Në historinë klasike islame nuk kemi *teologji* në kuptimin që e gjejmë në historinë e doktrinës kristiane apo hebraike. Në Islam nuk lejohet të mendohet për vetë qenien e Zotit (la tefekkeru fi dhatihi - hadith), por lejohet, madje, urdhërohet të mendohet në drejtim të krijesave të Tij (tefekkeru fi mahlukat'il-Lah - hadith). Në vend të kësaj, historia klasike teologjike islame njih shprehjet, si: *ilm'ut-tewhid, ilmu usul'id-ddin, ilm'ul-kelam, ilm'ul-akaid* etj. Më të njohura ndër myslimanët, por edhe ndër studiuesit e tjerë janë shprehjet *kelam* dhe *akaid*.¹ Nuk ndaj mendimin se kjo shkencë burimet e saj i ka në besimet dhe kulturat e huaja, si ajo greke apo persiane. Përkundrazi, kjo shkencë është plotësisht islame, që gjatë historisë ka pasur fërkime dhe natyrisht ndikime. Për fat të mirë, kolosët, si Imam Ebu Hanifeh, Imam El-Maturidiu, Imam El-Esh'ariu e disa të tjerë, çdo ndikim të huaj e kanë identifikuar, refuzuar, duke dhënë shpjegimet e shëndosha në veprat e tyre.

Normalisht, në kristianizëm kemi një gjendje tjetër krahasuar me Islamin. Ajo që në kristianizëm është teologjia, në Islam është fikhu, i cili është manifestim karakteristik i frymës islame.² Islami e vendos theksin më tepër në akt e më pak në mendim.³ Këto disiplina i ofrojnë besimtarit përgjigje në pyetjet:

- Si të jetohet në pajtim me vullnetin e Krijuesit?

- Si të arrihet lumturia në këtë botë dhe shpëtimi në botën e ardhme?⁴

Rruga e drejtë e myslimanit në pajtim me vullnetin e Krijuesit, sipas dijetarëve islamë, njihet dhe mësohet nëpërmjet Shpalljes (vahjit), të cilën e sjellin të dërguarit apo ferrëfyesisit (rusul e enbija). Shpallja është manifestuar me kuptim dhe tekst në Kuran dhe me kuptim në hadith. Kurani është Fjala e Zotit, dhuruar njeriut, kurse Hadithi është ortopraktika e Pejgamberit Muhamed, i cili e shpjegon dhe sqaron Shpalljen e Allahut. Për këtë arsye, Islami i njeh edhe hadithit karakter normativ obligues:

"Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit..." (En-Nisa, 59) dhe

"...Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë prej saj..." (El-Hashr, 7)⁵

Krahas këtyre dy burimeve, Islami njeh edhe burimin suplementar, ndihmues, fuqizues e ai është *arsyeja, mendja njerëzore*. Arsyeja, mendja, akli, ratio, luan rol me rëndësi në rrugën e shpjegimit të fjalës së Krijuesit dhe në praktikën e Pejgamberit (a.s.) dhe në nxjerrjen e

1. Shih: Nexhat Ibrahimli, Vepra 3, Shkup, Logos-A, 2009, fq. 87 e tutje.

2. Omer Nakicevic, Znacaj Kur'ana ..., në: Enes Kariq, Kur'an u savr - menom dobu, II, Sarajevo, 1997, fq. 241.

3. Muhammed Ikbali, Ripërtëritja e mendimit fetar në Islam, Logos-A, Shkup, 2006, fq. 9.

4. Omer Nakicevic, po aty, fq. 241.

5. Shih: Nexhat Ibrahimli, Vepra 2, po aty, fq. 321.

përfundimeve dhe paraqet burim dytësor në doktrinën islame, si norma e mirësjelljes në raportet private juridike (el-muammalat), respektivisht ajo që ndër njerëzit gjatë historisë është e gjithëpranuar si e mirë (el-ma'ruf), bëhet e sanksionuar me ligj në të drejtën islame.⁶ Kjo mënyrë e trajtimit të burimeve ka lidhur vlerat, por edhe autoritetin tradicional, racional, perceptues dhe shpjegues të Kuranit.

Shkaku i shpalljes së Kuranit, sipas dijetarëve, përbëhet prej dy aspekteve kryesore:

- Aspekti i mrekullisë (mu'xhizes): Ky aspekt nevojitej për konfirmimin e vërtetësisë së pejgamberisë së Muhamedit (a.s.), para kundërshtarëve të hapur dhe të fshehtë, para njerëzve të hamendur, por edhe për vetë besimtarët që t'ua plotësojë dhe forcojë edhe më shumë besimin. Kjo pejgamberi hyjnore manifestohej në shumë gjëra, por sidomos në ligjëvënie, njohje, domethënie, njohuritë e së kaluarës, të tashmes dhe të së ardhmes, të stilit kuranor, të kuptimit etj. Ja si e sfidon Kurani tërë njerëzinë:

"Nëse ju dyshoni në atë që ia kemi zbritur robit tonë (Muhamedit a.s.), atëherë hartoni një sure të ngjashme me atë që ia kemi shpallur atij! Thirrni në ndihmë edhe dëshmitarët tuaj (që i adhuroni) në vend të Allahut, nëse jeni të sinqertë. Nëse nuk mundeni, dhe kurrsesi nuk do të mundeni, atëherë ruajuni zjarrit, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët dhe që është përgatitur për të ndëshkuar mohuesit..." (El-Bekare, 23-24)

- Aspekti i udhëzimit dhe orientimit: Ky aspekt manifestohet në udhëzimin e njeriut në njohjen e ligjësisve dhe dispozitave, të cilat janë të domosdoshme për jetën e përditshme dhe në vrojtimin e mrekullisë kuranore në këto ligjësi e dispozita.

Dijetarët myslimanë janë unanimes se Kurani është burimi themelor i tërë mësimi islam. Kjo bindje e tyre është bindje fetare për të gjitha kohët dhe hapësirat. Çdo kufizim i vlefshmërisë së Kuranit në kohë apo hapësirë, në një gjuhë apo popull, për një problem apo çështje, do të thotë refuzim i tërësisë mu'xhizore të Kuranit.⁷

Të vërtetat e para që i vendosi Kurani janë:

1. Besimi i drejtë, i cili manifestohet në:

- Besimi në një të vetmin Zot (la ilaha il-lall-llah)
- Besimi në engjëj (melekë)
- Besimi në libra
- Besimi në pejgamberë
- Besimi në Ditën e Gjykimit.

2. Etika, morali islam, i cili fiksikëron shpirtat e njerëzve, si individë apo si bashkësi, kundrejt veseve të liga që e

6. Omer Nakicevic, po aty, fq. 242. Nexhat Ibrahimli, Vepra 3, po aty, fq. 73-86.

7. Omer Nakicevic, po aty, fq. 242.

E HADITHIT NË TEOLOGJINË ISLAME

përshkojnë shoqërinë njerëzore kohë pas kohe.

3. Përsiatja është komponent me rëndësi në teologjinë islame, në orientimin e njeriut që të vështrojë vetveten, rrethin, por edhe fshehtësitë e Zotit në gjithësi. Përsiatja ndërpret besimin e imituar të pararendësve dhe siguron besimin vetjak, që është kusht për besim të mirëfilltë.

4. Rrëfimi për të kaluarën, për individët e njohur dhe për popujt, me qëllime edukative, arsimore etj.

5. Shpërblimet dhe ndëshkimet janë tërësia tjetër, që e trajton Kurani dhe që sendërtohet në dy mënyra:

- Me shpërblimin apo ndëshkimin në këtë botë, nëpërmjet individëve autoritarë e dhunues dhe duke jetuar në vende i nënshtruar ndaj nënçmimit dhe përbuzjes.

- Me përvetësimin e njeriut me begatitë e botës tjetër, me kënaqësinë në xhenet apo me frikësimin me xhehenem në botën tjetër. Kurani thotë qartë: **"Këta janë kufijtë e caktuar prej Allahut. Atë që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai e shpie në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojnë përherë. Kjo është fitorja e madhe. Ndërsa atë që nuk i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe shkel kufijtë e vënë prej Tij, Allahu e shpie në zjarr, ku do të qëndrojnë përherë dhe për të ka ndëshkim poshtërues."** (En-Nisa, 13-14)

6. Aspekti juridik i Kuranit, i cili ndër të tjera rregullon raportet. Fjala vjen, rregullohen ibadetet, si namazi, agjërimi, zekati e të tjera, pastaj edhe kurora, divorci, edukimi, trashëgimia etj.⁸

Hadithi është burimi i dytë i mësimit islam. Dijetarët islamë i drejtohen hadithit / sunetit në rastet kur Kurani nuk shpjegon tema të caktuara. Atëherë, dijetarët kulturorë islamë, në bazë të frymës së ajeteve dhe praktikës së Pejgamberit (a.s.), ofrojnë zgjidhje të caktuara. Këto zgjidhje do të jenë obliguese, deri sa nuk kemi diçka më të fuqishme se ajo, deri në kohën kur aktualizohet kjo temë. Është e qartë, nuk veprohet sipas hadithit, deri sa ekziston zgjidhje nga Kurani.⁹

Për këtë arsye, raporti i hadithit ndaj Kuranit, në aspekt të argumentimit, mund të jetë:

1. Teksti i hadithit ta konfirmojë dispozitën të bazuar në tekstin e Kuranit. Në këtë rast, dispozita do të ketë dy dëshmi: dëshminë e konfirmuar me Kuran dhe dëshminë e përmbajtur me hadith. Në këtë mënyrë, bazohen dispozitat për aplikimin e namazit, zekatit, agjërimin, haxhit, besimit në një Zot etj. Në të dyja burimet, Kuran dhe Hadith, kemi dëshmi për vlefshmërinë e tyre.

2. Hadithi komenton dhe përpunon diçka që në Kuran është theksuar në parim. Roli i hadithit në këto raste është në shpjegimin, përshkrimin apo në sqarimin e ho-

8. Enes Karic, Tefsir - Uvod u tefsirske znanosti, Sarajevo, 1995, fq. 149 etj.

9. Omer Nakicevic, po aty, fq. 244-245.

llësishëm të asaj që është theksuar në Kuran në mënyrë të përgjithësuar. Kjo bëhet në bazë të teksteve kuranore, që lejojnë një gjë të tillë, siç është bërë me shpjegimin e hollësishëm të namazit, agjërimin, haxhit, zekatit etj. Në këtë shpjegim, ai ka përdorur metodë të katërfishtë: kuptimin tekstual dhe tre kuptime shpirtërore: alegorik (fusha e besimit), tropologjik (fusha e moralit) dhe analogjik (fusha eskatologjike).¹⁰

3. Hadithi, si burim kryesor dhe i vetmi i ndonjë dispozite për të cilën nuk flitet në Kuran. Një dispozitë e tillë është me rastin e ndalimit të përdorimit të mishit të shtazëve mishngrënëse në ushqimin e njeriut, si dhe mishit të shpendëve grabitqarë, pastaj dispozita për ndalimin për meshkujt myslimanë të veshin rroba mëndafshi, të bartin unaza ari etj.¹¹ Kemi edhe çështjen e vakufit, të cilin Kurani nuk e thekson fare se ai nuk mund të dhurohet, të shitet apo të trashëgohet apo çështjen e lartësisë së testamentit prej 1/3 etj.¹²

Nga e gjithë e theksuara mund të konkludohet se porositë kuranore dhe hadithore të Muhamedit (a.s.), vijnë në pajtim me tri mënyrat vijuese:

1. Që në Kuran dhe hadith të Pejgamberit (a.s.), të jenë paraparë dispozita të caktuara;

2. Që në hadith të shpjegohet ajo që në Kuran është thënë në mënyrë të përmbledhur dhe të përgjithësuar;

3. Që në bazë të vetë Hadithit të nxirren disa dispozita, për të cilat nuk ka njoftime nga Kurani.¹³

Pas kësaj ekspozite, nuk duhet harruar apo shpërfillur fakti se Kurani është burimi kryesor dhe forca kryesore që e nxitin dhe obligoi Muhamedin (a.s.), në gjetjen dhe nxjerrjen e dispozitave më të përshtatshme dhe më funksionale për njeriun. Nga grupi i tretë, Muhamedi (a.s.), më së shumti është mbështetur në kijas (analogji), i bazuar në dispozitat e përgjithshme dhe parimet e Kuranit. Kjo ka bërë që të mos kemi kundërthënie ndërmjet dispozitave të bazuara në tekstin e Kuranit dhe dispozitave të bazuara në tekstin e Hadithit.¹⁴

Shpallja (Kurani) dhe Tradita pejgamberike (Hadithi / Sunneti) kanë qenë dhe do të jenë një ndër çështjet themelore të teologjisë islame. Teologjia myslimane në vazhdimësi vepron dhe ndërton aksese të reja dhe të llojllojshme shkencore ndaj tekstit të këtyre dy burimeve normative të Islamit.

10. Adnan Silajdzic, Sunnet kao hermeneutika Kur'ana, në: Zuhdija Hasanovic, Pristup sunnetu, Sarajevo, 2005, fq. 100-103.

11. Po aty, fq. 245-246. Krhs. : Adnan Silajdzic, Sunnet..., po aty, fq. 98 etj.

12. Adnan Silajdzic, Sunnet ..., po aty, fq. 99.

13. Po aty, fq. 246.

14. Po aty, fq. 246.



PA E NJOHUR **ALLAHUN**

Ahmet Tashgetiren

Të gjitha fetë hyjnore janë organizuar rreth **“njohjes së Allahut”**.

Edhe njeriu edhe fetë kanë ardhur prej Tij.

Edhe njeriu edhe fetë ekzistojnë falë Tij.

Fetë përcaktojnë ligjet dhe kufijtë e njeriut mbi tokë. Kurse Ai që i ka shkruar këto ligje dhe ka vendosur këta kufij, është Krijuesi i njeriut.

Pa njohur Krijuesin, pa e kuptuar Atë në mënyrën më të mirë dhe pa u lidhur me Të, njeriu nuk mund të kuptojë as veten e tij dhe as **“përgjegjësitë e tij ndaj fesë”**.

Gjithësia qarkullon në sajë të marrëdhënieve ndërvepruese *Rububije¹ – Ubudije²*. Kjo është marrëdhënia midis Zotit dhe njeriut. Ekziston Ai dhe krijesat e Tij. Krijesat do të organizohen sipas vullnetit të Krijuesit. Ndërmjet të gjitha krijesave, vetëm njeriut i është dhënë e drejta për të zgjedhur. Për këtë arsye, fjala e Allahut i është drejtuar atij. Gjithashtu, edhe ligjet, edhe kufijtë hyjnorë janë dizajnuar në atë mënyrë, që

njeriu të jetë i lirë të bëjë zgjedhjen që dëshiron, pra të qëndrojë brenda apo të dalë jashtë tyre.

Për ta vendosur në një bazament të sigurt marrëdhënien Rububijet-Ubudijet dhe për t'i dhënë asaj (marrëdhënies) formën e duhur, kërkohet që “Njohja e Allahut” të konsiderohet si një proces i domosdoshëm.

Profetët janë ngarkuar me detyrën e njoftimit të njerëzve me Krijuesin e tyre dhe përgjegjësitë e tyre ndaj Tij.

Librat hyjnorë janë fjala e Allahut dhe Ai personalisht me anë të fjalës së Vet ua ka prezantuar Vetën njerëzve.

Megjithëse në Kuran gjenden kriteret e jetës së njeriut mbi tokë, kjo fjalë hyjnore rrotullohet rreth boshtit të njoftimit të njeriut me Zotin e tij.

Surja “el-Ihlas” fillon me urdhrin **“Kul-Thuaj!”** dhe vazhdon me ajetet që njoftojnë në lidhje me Allahun:

“Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amëshim.

1. Plotësimi i çdo nevoje të krijesave nga ana e Krijuesit

2. Bindje, devotshmëri e krijesës ndaj Krijuesit

Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!"

Kjo sure është vlerësuar prej Rasulallahut (a.s.), si **"Zemra e Kuranit"**. Kjo do të thotë se ai që e kupton plotësisht dhe ashtu siç duhet **"Rububijetin"** në suren el-Ihlas, në një farë kuptimi ka arritur në zemrën e Kuranit, pra ka arritur thelbin e mesazhit të fundit hyjnor.

Edhe ajetu'l-Kursi, është një prej ajeteve më të preferuara të Profetit tonë (a.s.). Gjithashtu edhe ky ajet fillon duke vënë në plan të parë teuhidin **"Allahu la il-laheil-la huue."** dhe më pas vazhdon duke radhitur cilësitë e Allahut Teala. **"Allahu! Nuk ka zot tjetër përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit. Mbajtësit të gjithçkaje!."**

Këto janë ajete në të cilat Zoti ynë prezanton Vetën e Tij. Kjo do të thotë se Allahu Teala dëshiron kështu ta njohin robërit e Tij. Gdhendja e kësaj njohurie në mendjen e njeriut, është një kërkesë hyjnore. Nëse njeriu do ta arrinte këtë njohuri, ai do të kuptonte në mënyrë të plotë edhe Ubudijetin e tij. Ose e kundërta e kësaj, pra, nëse njeriu nuk do ta njihnte ashtu siç duhet Zotin e tij, nuk do të mund të kuptonte dhe përjetonte ashtu siç duhet as bindjen dhe robërinë ndaj Tij.

Pa i kuptuar mirë shprehjet: **"Hajju"** / i Gjallë, ekziston gjithmonë, i Pafillim dhe i Pafund" dhe **"Kajjum"** / Zotëruesi, Dominuesi dhe Drejtuesi i gjithçkaje", pa e ditur se çfarë përfshijnë ato dhe pa bërë përpjekje të veçantë për t'i kuptuar, nuk është e mundur ta njohim Zotin tonë.

Në vazhdim të Ajetu'l-Kursi, njeriut i tregohen disa cilësi të tjera të Allahut:

"...Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk mund të përveçojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron. Kursi-u i Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën dhe Ai nuk e ka të rëndë t'i ruajë ato. Ai është i Larti, Madhështori!" (el-Bekare, 255)

Janë edhe tre ajetet e fundit të sures el-Hashr, të cilat na njoftojnë për cilësitë e Allahut Teala:

"Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër.

Njohësi i së dukshmes dhe i së padukshmes, Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti!"

"Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër. Ai është Sunduesi, i Shenjti (i pastër nga çdo e metë), Paqedhënësi, Dhënësi i sigurisë, Mbikëqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori. Qoftë i lartësuar Allahu mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)!"

"Ai është Allahu, Krijuesi, Zanafillësi, Ai që i jep trajtë çdo gjëje. Atij i përkasin emrat më të bukur; Atë e përlëvdon gjithçka që ndodhet në qiej dhe në Tokë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti." (el-Hashr, 22-24)

Të gjitha cilësitë që zënë vend në këto ajete dhe që nga Vetë Allahu Teala janë cilësuar si **"esma-i husna / emrat më të bukur"**, janë përmendur me qëllim që njerëzit ta njohin sa më mirë Krijuesin e tyre.

Kjo do të thotë se Zoti ynë i Madhërishtëm, dëshiron që ne të dimë se Ai është **"Një i Vetëm"**, **"Melik / Sunduesi i vërtetë i gjithësisë"**, **"Kuddus / i Pastri, i Shenjti, larg prej çdo të metë"**, **"Selam / Paqedhënësi"**, **"Mu'min / Siguruesi, Mbajtësi i premtimit"** dhe **"Muhejmin / Mbrojtësi, Mbikëqyrësi"**.

Kjo do të thotë se Zoti mund të jetë vetëm një dhe vetëm kështu. E nëse pranoni me gjithë shpirt se Zoti mund të jetë vetëm kështu, nuk do t'u drejtoheni më zotave të rremë.

Sigurisht që ajetet me anë të të cilave Allahu na prezantohet, nuk janë të kufizuara me kaq. I gjithë Kurani, qoftë direkt, qoftë indirekt, e thërret njeriun në përpjekjen për të njohur Zotin e tij.

Në suren Fatiha, njeriu takohet me cilësitë Rrahman, Rrahim, Sunduesi i ditës së gjykimit dhe prej aty, dërgohet në **"besimin - dijen se Falënderimi duhet të bëhet vetëm ndaj Allahut, se vetëm Ai duhet të adhurohet, se vetëm prej Tij duhet kërkuar ndihmë dhe se shpëtimi prej devijimit, arritja e mirësive të Allahut, orientimi në rrugën e drejtë dhe qëndrimi në atë rrugë, mund të arrihen vetëm duke iu lutur Atij"**. Njeriu që i gjen këto, fjalën e tij do ta fillojë **"duke falënderuar Zotin e tij"**. Çështja është të kuptojmë Allahun Teala, i cili na e prezanton Vetën e Tij me cilësitë Rrahman, Rrahim dhe Sunduesi i ditës së gjykimit. Ai sikur dëshiron të na thotë: **"Njihe Allahun si Rrahman dhe Rrahim, sep-**

"Ai është Allahu, Krijuesi, Zanafillësi, Ai që i jep trajtë çdo gjëje. Atij i përkasin emrat më të bukur; Atë e përlëvdon gjithçka që ndodhet në qiej dhe në Tokë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti."

(el-Hashr, 22-24)

se këto janë mirësitë që i janë dhuruar njeriut. Por ka edhe një ditë gjykimi, Sunduesi i së cilës është Allahu. Prandaj, mos harro se në ditën e gjykimit do të dalësh përpara Allahut.”

Shumë ajete të Kuranit tregojnë për gjendjet e ndryshme të njeriut dhe popujve, duke filluar me **“In-nallaha... / Me të vërtetë Allahut”** dhe mbarojnë më fjali që tregojnë gjykim të prerë, si **“Alimunhakim”** ose **“Azizundhu’ntikam”**.

Allahu Teala është Rrahman dhe Rrahim, por nëse njeriu është përzier në padrejtësi, ka shkelur të drejtat e dikujt, nëse fuqinë të cilën i ka dhënë Allahu e ka përdorur për të shkelur kufijtë e Allahut dhe, nëse e ka tepruar, duhet të dijë se ka edhe një Krijues, i cili do ta dënojë për ato që ka bërë. Cilësia e Allahut, e cila i njoftohet njeriut në raste të tilla, është me qëllim që njeriu të orientohet në vijën e drejtë të devotshmërisë. E shprehur ndryshe, mund të quhet edhe si paralajmërim: **“Mos e harro Zotin tënd”**.

“Ai është me ju kudo që të gjendeni!” (el-Hadid, 4)

“Ai është më pranë tij se damari i qafës së vet.” (Kaf, 16)

Edhe këto janë informacione të Kuranit, të cilat na njohin me Zotin tonë.

Në disa ajete zënë vend shprehjet: “Allahu Teala i do ata që veprojnë kështu...!” **“Allahu i do ata që pendohen, ata që bëjnë mirësi, ata që jetojnë sikur ta shihnin**

Allahun, ata që janë të pastër brenda dhe jashtë...”

Është e qartë se Allahu Teala dëshiron që njeriu dhe shoqëritë njerëzore të arrijnë pjekurinë, në sajë të së cilës do të fitojnë dashurinë e Allahut. Këta janë kufijtë që vendos Ai përpara njeriut... (Shih. Maide, 54)

Përkundër kësaj, ekziston edhe mospëlqimi i Allahut... Madje edhe urrejtja... Madje edhe mallkimi...

Atëherë, njeriu i duhet të bëjë një kujdes të veçantë, për të mos shkaktuar urrejtjen dhe mallkimin e Allahut...

Kur shohim nga kjo pikëpamje, mund të themi se “Marifetullah / Njohja e Allahut”, është një disiplinë shpirtërore, e cila nuk është vetëm për sufitë. Përkundrazi, besimi arrin përsosmërinë vetëm duke e njohur me të vërtetë Allahun. Nga kjo pikëpamje, marifetullah, është shprehja e vërtetë e besimit.

Kur duam të përkufizojmë fenë, themi: “*Ta’dhim li emrillahue’sh-shefaktu li halkillah / Të kuptosh Madhështinë e Allahut dhe të mëshirosh gjithçka që ka krijuar Allahu*”. Dhe kjo mund të arrihet vetëm nëse e njohim mirë Madhështinë e Allahut, nëse e dimë se njeriu dhe gjithësia doli në skenën e ekzistencës me urdhrin e Tij “Kun!” dhe se për këtë arsye, është e paktim të mburremi para krijesave të tjera.

Prandaj, nuk është gabim nëse themi: **“Feja është e barabartë me marifetullah / njohjen e Allahut”**.



يَا اَللّٰهُ
وَ اَعْلٰى اَللّٰهِ فِى تَوَكُّلِكَ
وَلِ التَّوَكُّلِ كَوْنٍ

Vetëdija ndaj Mirësive

Askush nuk mund ta dijë vlerën e mirësive për të cilat nuk është i vetëdijshëm. Vlera e tyre kuptohet vetëm atëherë kur ato mirësi dalin prej duarve. Por kur ndodh kjo, atëherë në dorë ngelet vetëm keqardhja. Ajo që i ka hije çdo myslimani, është të jetë i vetëdijshëm ndaj mirësive të panumërta që i janë falur dhe në radhë të parë, të përkujtojë e të falënderojë Atë që ia ka falur këto mirësi dhe së dyti, t'i konsiderojë ato mirësi si amanete e t'i ruajë me shumë kujdes.

Të jesh i krijuar si njeri, të jesh krijesa më fisnike, të jesh i nderuar me Islam dhe të konsiderohesh halifi, (mëkëmbësi) i Allahut në tokë, janë disa nga mirësitë më të mëdha ndër të gjitha mirësitë e panumërta që na janë falur. Allahu Teala, në shumë ajete të Kuranit Kerim, u kujton njerëzve mirësitë që u ka dhënë, por vë në pah edhe qëndrimin mosfalënderues dhe mosmirënjohës të tyre:

"Allahu është Ai që ka krijuar qiejt dhe Tokën. Ai lëshon ujë nga qielli e nëpërmjet tij, nxjerr fruta si ushqim për ju. Ai i ka vënë në shërbimin tuaj anijet, që me lejen e Tij, ju të lundroni me to nëpër dete. Ai i ka krijuar lumenjtë për dobinë tuaj e po ashtu edhe Diellin dhe Hënë, që lëvizin vazhdimisht. Ai ka vënë në shërbimin tuaj natën dhe ditën. Ai ju jep gjithçka që i kërkon. Edhe nëse përpiqeni t'i numëroni dhuntitë e Allahut, nuk do të mund t'i numëroni dot. Njeriu është vërtet i padrejtë dhe mosmirënjohës." (Ibrahim, 32-34)

"A nuk shihni se si Allahu jua ka bërë të mundur t'i shfrytëzoni të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë dhe ju ka mbuluar me dhuntitë e Tij të dukshme e të padukshme? E megjithatë, disa njerëz polemizojnë për Allahun pa kurrfarë dijenie, pa kurrfarë rrëfyese dhe pa libër ndriçues." (Lukman, 20)

Çdo gjë që kemi, është pronë e Allahut. Madje, ne nuk jemi as pronarët e vetes sonë. Ne nuk mund të veprojmë

si të duam me trupin tonë. Pra, jemi të detyruar që trupin tonë ta përdorim sipas udhëzimeve të Allahut Teala, i Cili edhe na e ka dhënë atë. Jemi të detyruar që organet tona të mos i përdorim për të bërë gjynahe dhe në kundërshtim me natyrshmërinë e tyre. Askush nuk ka të drejtë të thotë: "Kjo është jeta ime." Nëse dua, vetëvritem dhe i jap fund asaj, sepse edhe shpirti edhe trupi janë të Allahut. Dhe askush nuk mund të veprojë në kundërshtim me urdhrat e Allahut në pronën e Tij.

Ashtu si peshqit që nuk janë të vetëdijshëm për detin, ashtu edhe disa njerëz nuk janë të vetëdijshëm për mirësitë në të cilat notojnë. Të marrësh frymë, të shohësh, të dëgjosh, të mendosh, të ndjesh, të hash, të pish, të flesh, të ecësh, të flasësh dhe shumë cilësi të tjera si këto, janë mirësi të mëdha e të paçmueshme.

Një njeri, i cili nuk ishte i vetëdijshëm për mirësitë që kishte, shkoi te një njeri i mençur dhe iu ankua për varfërinë duke i thënë se s'kishte asgjë. Pasi e dëgjoi, njeriu i mençur i tha:

- A dëshironi dhjetë mijë dirhem në këmbim të dy syve?

- Jo, tha ai.

- Po sikur të jesh memec, por të kesh dhjetë mijë dirhem?

- Jo.

- Po sikur të mos kesh as duar dhe as këmbë, por të kesh njëzet mijë dirhem?

- Jo.

- Po sikur të jesh i çmendur, por të kesh dhjetë mijë dirhem?

- Jo.

- Atëherë, a nuk të vjen turp? Megjithëse zotëron të gjitha këto të mira të Allahut me vlerë pesëdhjetë mijë dirhem, përsëri ankohesh.

Sipas një transmetimi, profetit Ejub (a.s.), i është thënë:

“O Ejub! Lutju Allahut të të lehtësojë sëmundjen!”

Ejubi (a.s.), tha: “Shtatëdhjetë vjet kam gëzuar shëndet të mirë. Kurse koha e sëmundjes sime është më e shkurtër. Prandaj më duhet të duroj shtatëdhjetë vjet për hir të Allahut.”

Sigurisht që ne mund të lutemi e të kërkojmë shërim e kurim, por nuk duhet të ankojemi. Ajo që i takon njeriut, është të falënderojë për mirësinë dhe të durojë ndaj fatkeqësisë. Ky është durimi, të qëndrosh në këmbë e i palëkundur.

Nëse shohim veten tonë dhe përreth nesh, do të vëmë re se ka aq shumë gjëra për të cilat duhet të falënderojmë, sa që kur i mendojmë, nuk do të gjejmë asnjë arsye për t’u ankuar.

Një prej sahabëve, Urve bin Zubejr, u godit me dy fatkeqësi në një ditë. Për shkak të shkëlqimit të kalit, i vdiq djali dhe për shkak të sëmundjes së rëndë, e cila i kishte mbuluar të gjithë trupin, doktori i preu njërin këmbë. Megjithatë, ai nuk u ankua, por falënderoi Allahun. Në fillim pa djalin e vdekur, pastaj atë që kishte gjallë dhe tha: “O Allah! Megjithëse ma more njërin, ma ke falur tjetrin”. Pastaj pa këmbën e prerë dhe këmbën e shëndoshë dhe tha: “O Allah! Megjithëse më sprovove me njërin, ma ke falur tjetrin.” Ky pra, është vlerësimi i duhur.

Nëse njeriu shikon vetëm anën negative, nuk mund të shohë asgjë pozitive. Por, nëse sheh anën pozitive, do të kuptojë se në çdo gjë ka mirësi dhe urtësi. Në shumë gjëra që mund të duken si fatkeqësi, në vetvete mund të jenë edhe mirësi. Ato mund të jenë edhe paralajmërime, me qëllim që njeriu të mos bjerë në gjendje edhe më të këqija. Pra, shuplaka mëshiruese. Një fatkeqësi është më e vlefshme se njëmijë këshilla. Fatkeqësia nuk lypet, por kur të bie në kokë, analizohen arsyet, shikohen gabimet dhe merret mësim prej saj.

Transmetohet se Omeri (r.a.), ka thënë: “Kur më ka goditur një fatkeqësi,

kam vënë re se në këtë fatkeqësi, Allahu më ka dhënë katër mirësi”:

- 1- Që kjo fatkeqësi nuk është në lidhje me fenë time.
- 2- Që nuk është fatkeqësia më e madhe.
- 3- Që nuk më pengon të jem i kënaqur prej Allahut.
- 4- Bëhet shkak që të shpresoj shpërblim prej Allahut.

Nëse shihet në mënyrë pozitive, mund të korrësh mirësi edhe prej fatkeqësisë. Por nëse shihet në mënyrë negative edhe mirësitë kthehen në fatkeqësi.

Vetëdija ndaj mirësive është shkak lumturie. Ndërsa njerëzit mosmirënjohës nuk janë asnjëherë të lumtur, sepse ata gjithmonë ndihen të privuar nga diçka. Ata vuajnë skamjen edhe kur janë të kamur. Dhe për shkak se nuk i shohin mirësitë e panumërta që kanë përpara syve, e harxhojnë jetën duke rendur pas të mirave imagjinare. Ata që nuk dinë çfarë kërkojnë, nuk dinë as se çfarë kanë gjetur.

Mosvetëdija ndaj asaj që zotërohet vjen ose nga injoranca, ose nga ambicia. Të dyja këto e verbojnë njeriun. Të varfrit, që janë të kënaqur me atë që kanë, gëzohen edhe me diçka të vogël. Kurse të pasurit tamahqarë nuk lumturohen as me pasuritë më të mëdha. Kthimi i mirësive nga përfitimi në humbje dhe Nemrudizimi e Faronizimi i njeriut, vjen për shkak të mosfalënderimit dhe mosmirënjohjes. Ata që e përdorin mirësinë e sundimit për të shtypur njerëzit dhe ata që e përdorin mirësinë e pasurisë si mjet urrejtjeje, në vend që ta përdorin si mjet mëshirë, janë ata të cilët kanë harruar

pronarin e vërtetë të këtyre mirësive dhe që e vënë veten në vend të Zotit.

Adhurimet janë falënderim ndaj Allahut për mirësitë e pafundme që na ka dhuruar. Të ndash të mirat që të ka dhënë Allahu me krijesat e tjera të Allahut, është mënyra më e bukur e falënderimit. Ata që falënderojnë Allahun, meritojnë edhe falënderimin. Ata fitojnë edhe kënaqësinë e Allahut edhe duatë e njerëzve të tjerë. Ky është fitimi më i madh që mund të arrihet me anë të mirësive. Falënderimi është shkak begatie. **(Kujtoje) kur Zoti juaj kumtoi: "Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t'ju shtoj edhe më shumë begatitë e Mia..."** (Ibrahim, 7) Fatkeqësitë prej të cilave vuan bota, vijnë gjithmonë për shkak të mosmirënjohësve. Ata gjithmonë bëhen shkak i dënimit të ashpër të Allahut.

Të gjithë do të japim llogari tek pronari i mirësive për mirësitë që na ka falur, qofshim apo jo të vetëdijshëm për to. **"Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!"** (et-Tekathur, 8) Kur u zbrit ky ajet, një i varfër u çua në këmbë dhe tha: "Po unë s'kam asnjë shenjë prej mirësive! Kurse Profeti ynë (a.s.), ia ktheu: "Ke këpucët, pi ujë të ftohtë dhe freskohesh në hije".

Sa mirësi të madhe gëzon dikush që s'ka këpucë, në krahasim me atë që nuk ka këmbë! Një gram shëndet vlen sa të gjitha pasuritë e botës. Dëshira më e madhe e dikujt që i kanë rënë flokët dhe dhëmbët, është të gëzojë flokë të dendur dhe dhëmbë të bukur si rruaza. Mirëpo, kur kishte flokë dhe dhëmbë, ai nuk i konsideronte këto si mirësi. Vlera e mirësive, si rinia, shëndeti, pasuria, pozita,

pekti dhe shumë mirësi të tjera njihet më mirë në kohë të pleqërisë, sëmundjes, varfërisë, dobësisë dhe braktisjes.

Askush nuk ka të drejtë të protestojë ndaj Allahut Teala. Dhe mbi të gjitha, nuk mund të pretendojë të marrë gjë prej Tij, sepse Ai çdo gjë na e ka dhënë. Dhe ai që jep, ka të drejtë edhe të marrë. Ne prej Tij vijmë dhe tek Ai do të shkojmë.

Për shkak se pandehim që çdo gjë është e jona, harrojmë të falënderojmë, por kur dikush na dhuron diçka, menjëherë e falënderojmë. Pra, ne nuk i konsiderojmë si dhuratë mirësitë e Allahut. Mirëpo, në fakt edhe dhuratat që na bëjnë të tjerët, janë në sajë të Allahut. Pra, sido që të jetë, në fund të fundit çdo falënderim dhe mirënjohje kthehet tek Allahu. Nëse Ai nuk lëshon shiun nga qielli, e nëse nuk e bën të mundur mbirjen e bimëve, si do të vejë halli ynë?

Vetëdijësimi ndaj mirësive të Zotit tonë, shfaqja e falënderimit dhe mirënjohjes për ato mirësi dhe përdorimi i tyre pa i shpërdoruar, duke menduar se ato janë amanet për ne, i jep rregull dhe kuptim, si jetës individuale, ashtu edhe asaj shoqërore. Dhe kjo është detyra e çdo myslimani të devotshëm, sepse sido që të jetë, do të vijë një ditë kur ne do të japim llogari për to. Profeti ynë (a.s.), në lidhje me këtë gjendje shprehet:

"Në ditën e gjykimit, asnjë rob nuk do të lëvizë prej vendit pa dhënë llogari për këto gjëra: Si e ka harxhuar jetën, çfarë punoi me diturinë, ku e ka fituar dhe shpenzuar pasurinë dhe ku e ka konsumuar trupin?" (Tirmidhi, 2417)

Për çdo gjë që na është falur, na është ngarkuar edhe një përgjegjësi. Në fakt, bartja e përgjegjësisë, është edhe cilësia themelore, e cila e dallon njeriun nga krijesat e tjera. Dhe në krye të këtyre përgjegjësisë, qëndron vetëdija ndaj mirësive dhe Pronarit të tyre të vërtetë dhe falënderimi për to.



Një Ajet

"Allahu ia hap zemrën për (të pranuar) Islamin atij që dëshiron ta udhëzojë, ndërsa atij që dëshiron ta lërë në humbje, (ia mbyll zemrën e) ia shtrëngon gjoksin, si të jetë duke u ngjitur në qiell. Kështu, Allahu, i ndëshkon ata që nuk besojnë!"

(El-E'nam, 125)

Kush beson dhe zbaton urdhëresat e Krijuesit, Allahu i jep atij një qetësi shpirtërore. Zemra e tyre ndriçohet nga drita e imanit. Detyrat e ngarkuara i bëjnë me zell të madh, pa asnjë lloj dembelizmi. Kurse jobesimtarët, megjithë të mirat materiale që zotërojnë, janë gjithmonë në stres e depresion. Një nga qëllimet kryesore të njeriut në këtë botë është edhe sigurimi i një jete të lumtur pa probleme e telashe. Gjithë jetën njeriu përpiqet ta arrijë këtë qëllim. Dikush mendon se lumturia arrihet duke plotësuar objektivat materiale dhe kënaqësitë trupore. Ky grup e kufizon lumturinë vetëm me zotërimin e të mirave materiale të kësaj bote.

Dikush tjetër e shikon lumturinë në një këndvështrim tjetër, duke besuar se është një shpëtim shpirtëror në botën e amëshuar. Në këtë kuptim, rruga e vetme për të arritur lumturinë e përjetshme është devotshmëria ndaj Allahut. Për rrjedhojë, lumturia nga këndvështrimi material me lumturinë në këndvështrimin shpirtëror, janë të ndryshme. Ndërsa njëra realizohet duke plotësuar në mënyrë të shfrenuar dëshirat trupore, tjetra realizohet duke arritur përsosmërinë shpirtërore përmes mbajtjes nën kontroll të dëshirave.

Nga ky këndvështrim dallohet se Islami ka sjellë një sistem për ta bërë njeriun të lumtur. Feja islame merr parasysh edhe anën materiale edhe atë shpirtërore. Islami e vlerëson njeriun si të tërë, pa bërë ndarjen

trup-shpirt. Islami nuk e shikon jetën të kufizuar vetëm në këtë botë, përkundrazi jeta e vërtetë dhe e pafundme fillon pas jetës tokësore. Dëshirat dhe nevojat e njeriut janë të pafundme, kurse mundësitë për t'i plotësuar janë të kufizuara. Për këtë arsye, nuk mund të plotësohen të gjitha dëshirat në këtë botë. Nga kjo pikëpamje, bota e përtejme është një shpresë për besimtarët, të cilët besojnë se do të shpërblehen me mirësi të pafundme nga ana e Allahut. Kurse për jobesimtarët nuk mund të mendohet një gjë e tillë, sepse sipas tyre, i vetmi vend ku mund dhe duhet të plotësohen dëshirat është kjo botë. Kjo filozofi jete e shtyn njeriun në një liri totale për të plotësuar dëshirat, nëpërmjet të cilave, gjoja realizohet lumturia, por kjo është një iluzion, sepse përmbushja e gjithë dëshirave, së pari është e pamundur dhe e dyta, asesi nuk sjell lumturi. Ndërsa për jobesimtarin, fundi i kësaj bote ndjell frikë, kurse për besimtarët nuk ndodh një gjë e tillë, ata e presin me mall dhe aspiratë. Kjo gjendje rrjedh, sepse Islami e mëson njeriun të jetë pozitiv dhe optimist për jetën. Ai e shikon botën të mbushur me mirësi, krijuesi i të cilave është Allahu. Dhe për këtë falënderon Allahun për mirësitë e pafundme që i janë dhënë. Njeriu, duke qenë i vetëdijshëm se krijuesi dhe zotëruesi i të gjitha këtyre është Allahu, i dorëzohet vullnetit dhe përcaktimit të Allahut dhe kjo sjell tek ai një qetësi shpirtërore të papërshkruar. **Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai.** (Talok. 3)

Transmetohet nga Ebu Musa el-Esh'arij (r.a.),
se Pejgamberi -sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem-, ka thënë:

*"Shoku i mirë ngjan me tregtarin e aromave të këndshme.
Prej tij mund të blihet parfum, mund të të vijë dhuratë
një parfum ose tekefundit, mund të të vijë era e parfumit.
Kurse shoku i keq është si farkëtari, qëndrimi pranë të cilit
ose të djeg teshat ose të mbyt nga era e keqe."*

Ky hadith është në përputhje të plotë me ajetet që këshillojnë besimtarët të shoqërohen gjithmonë me njerëz të mirë e të devotshëm. Shoqëria dhe miqësia, përtej një marrëdhënieje shoqërore natyrale, e ka të nevojshme sinqeritetin dhe sinqeriteti arrihet më së miri midis njerëzve që ndajnë besim dhe ideale të njëjta. Hadithi i mësipërm na këshillon të jemi të kujdesshëm në zgjedhjen e shokut, për vetë faktin se, edhe pse me besim të njëjtë, por me sjellje të papajtueshme, njerëzit ndikohen reciprokisht pozitivisht apo negativisht. E këshillueshme është shoqërimi me njerëz të mirë, për të përfituruar nga edukata e morali i tyre dhe distancimi nga personat me sjellje të keqe, sepse shoqërimi sjell patjetër ndikim. Siç e shpreh më qartë hadithi tjetër: *"Personi është në fenë e shokut të tij, prandaj të shikojë çdonjëri prej jush se me kë shoqërohet"* (Ahmed. ibn. Hanbel, Musnedi, 2/334)

Ky hadith i mrekullueshëm, i thënë katërmëdhjetë shekuj më parë, e ruan edhe sot aktualitetin. Tema e ndikimit zë një vend të

rëndësishëm, sidomos përsa i përket edukimit të fëmijëve dhe të rinjve. Sepse sjelljet që fitohen në këtë moshë, do të përbëjnë një pjesë të karakterit të tij në të ardhmen. Në shumicën e rasteve duhanpirja fillohet thjesht duke u nxitur nga një shok, për të vazhduar gjithë jetën. Përhapja e veseve të tjera të këqija, si alkooli, droga dhe kumari është e lidhur ngushtë me ndikimin e rrethit shoqëror. Prandaj, zgjedhja e shokut është shumë e rëndësishme, për më tepër në kohën tonë, ku komunikimi ka marrë përmasat e një zhvillimi marramendës duke bërë të mundur edhe krijimin e shoqërive virtuale. Familja duhet të tregohet shumë e kujdesshme për grupmoshat nga klasa e parë deri në moshën e pjekurisë, sepse kjo është moshë ku fillon të formësohet personaliteti, por është edhe moshë, e cila është shumë e prirur ndaj ndikimeve pozitive apo negative.

Mburoja më e sigurt për të mbrojtur fëmijët nga ndikimet negative është strehimi tek feja islame.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Nxitja për t'u shoqëruar me njerëz të mirë.
2. Njeriu ndikohet nga shoku me të cilin shoqërohet.
3. Qëndrimi larg shoqërisë së keqe.

Një Hadith



TË ZGJEDHËSH AHIRETIN NË VEND TË DYNJASË

Padyshim që njeriu është një rrugëtar vdekatar, që ka nisur udhëtimin drejt ahiretit. Të mohosh një gjë të tillë, bie në kundërshtim me mendjen, logjikën dhe arsyen e shëndoshë dhe është sikurse të mbyllësh sytë dhe të thuash: "Nuk ekziston dielli!". Prandaj dhe të rregullosh jetën sipas kësaj të vërtete, është një detyrim mendor, logjik dhe ndërgjegjësor.

Myslimanët, ashtu sikurse duhet të bëjnë kujdes ndaj gjërave që bëjnë në këtë botë, njëkohësisht nuk duhet të harrojnë kurrë të përgatiten për botën e përtejme, sepse jeta e kësaj bote nuk është dhuruar vetëm që të shijohen kënaqësitë kalimtare dhe të plotësohen dëshirat epshore. Përkundrazi, është një hapësirë që të është dhuruar të mbledhësh ushqim për ahiretin, të bësh vepra të mira dhe të bësh bamirësi të ndryshme përmes lëmoshave që nuk u kufizohet shpërblimi (sadaikai xharije). Ndaj dhe miqtë e Allahut kanë thënë:

"Sado vuajtje të kesh për një lumturi të përjetshme, tekefundit ikën mundimi dhe mbetet lumturia. Mirëpo, nëse mëkaton për shijet e përkohshme të kësaj bote kalimtare, në fund do të të ikë kënaqësia e shijes dhe tek ti do të mbesin vetëm pendesa, ndëshkimi dhe vuajtja."

Ibn Mina shpjegon:

Isha nisur për në varreza, i veshur me një rrobë të hollë. U përballa me një acar të mprehtë dhe u shtriva pranë një varri, që të ruhesha nga i ftohti. Fala dy rekatë namaz aty dhe rashë të flija. Pasha Allahun, duke qenë i zgjuar dëgjova një zë të tillë:

- Ngrihu nga varri im! Ju mund të bëni akoma vepra. Ah sikur ta dinit gjendjen e varreve. Ne e përfunduam jetën e dynjasë dhe kemi nisur jetën e varrit, e pamë të gjithë të vërtetën dhe e kuptuam. E kuptuam mjaft mirë se sa gjë e vyer është të bësh vepra të sinqerta në dynja. Mirëpo, nuk na ka mbetur tashmë ndonjë mundësi që të bëjmë vepra, sikur të mund të falja këto dy rekate namaz që ti i fale lehtësisht, pasha Allahun, kjo do të ishte më e vyer dhe më e dashur se e gjithë bota dhe gjithçka që ajo ka brenda. (Bejhaki, Delail, VII, 40-41)


Hazreti Mevlana ka thënë:

"Kush sheh fundin e punës, sapo të ketë nisur punën, bëhet më i lumtur dhe i gëzuar. Njerëz të tillë i përkushtohen më shumë punës, mbjellin më shumë dhe në fund mbledhin shumë fruta, sepse e dinë se kjo botë është botë e të mbjellave, është parapërgatitje për të hyrë në ahiret. Kurse ahireti është bota e të korrurave, është bota e tjetërsimit"

Të zgjedhësh ahiretin, nuk do të thotë të shpërfillësh këtë botë. Kjo gjë ka të bëjë më shumë me rregullimin e qëllimit në zemër. Njeriu duhet ta rregullojë jetën sipas asaj që pëlqen Allahu dhe kur punon me qëllim që të fitojë riskun e tij prej hallalli dhe të bëjë vepra të mira, atëherë çdo hap që hedh, çdo punë që bën, vlerësohet si ibadet.

Hazreti Omeri e shpjegon kështu:

"Një ditë shkova pranë Profetit tonë të dashur. Pashë që ai ishte shtrirë mbi një rrogëz. Motivet e



rrogosit kishin lënë gjurmë në trupin e tij. Nuk kishte as edhe një dyshek që të shtronte mbi rrogos. Kishte një jastëk prej lëkure të mbushur me fije hurmash...

Kur pashë që Zotëriu ynë po buzëqeshte, iu ula menjëherë pranë dhe pashë përreth dhomën. Pasha Allahun, nuk kishte asgjë me vlerë përveç tri lëkurave që prisnin të përpunoheshin. Nuk durova dot dhe i thashë:

- O Resulullah! Bëni dua Allahut, që Ai t'i falë pasuri umetit tuaj, sepse, romakëve dhe persëve u ka dhënë pasuri dhe shumë begati të tjera, edhe pa adhuruar fare Allahun.

Resulullahu (a.s.), u drejtua nga vendi ku ishte mbështetur dhe tha kështu:

- *O biri i Hattabit, a ke dyshim (lidhur me fjalën hyjnore për botën tjetër)? Ata janë njerëz që e kanë dhënë jetën pas kësaj bote dhe kanë ndër-tuar gjithçka kundrejt saj.*

Pas kësaj edhe unë i thashë:

- O Resulullah, bëj istigfar për mua." (Buhari, Mezalim, 25)

Sërisht një ditë tjetër, Resulullahu (a.s.), lidhur me këtë çështje pati thënë:



"Ditën kur do ta shohin atë, (njerëzve) do t'u duket se kanë qëndruar (në Tokë) veç një mbrëmje apo një mëngjes."

(En-Naziat, 46)

"Për çfarë mund të më duhet kjo botë! Lidhja ime me këtë botë është si shembulli i atij rrugëtarit që po bën udhëtim, pushon nën hijen e një peme dhe pastaj ngrihet e vazhdon rrugën." (Tirmidhiu, Zuhd, 44/2377; Ibni Maxhe, Zuhd, 3; Ahmed, I, 301)

Kurani Famëlartë thotë:

"Ditën kur do ta shohin atë, (njerëzve) do t'u duket se kanë qëndruar (në Tokë) veç një mbrëmje apo një mëngjes." (En-Naziat, 46)

Abdullah ibni Mes'ud (r.a.), u thoshte miqve të vet:

- Ju falni më shumë namaz se sahabët dhe përpiqeni më shumë se ata. Mirëpo, ata ishin më të virtytshëm se ju."

- Çfarë bënin ata, që ishin më të virtytshëm?

- Ata ishin më asketë se ju ndaj kësaj bote dhe më të dhënë për ahiretin sesa ju. (Ibni Xhevzi, Sifatus-Safve, I, 420)

Shumë njerëz i kushtohen së tepërmi posteve, karrierave dhe prestigjeve të kësaj bote dhe për t'i mbrojtur ato, tregohen tolerantë ndaj ahiretit. Në fakt, një mysliman, për ahiretin e tij, duhet të marrë përsipër të gjitha llojet e shqetësimeve të kësaj bote, nuk duhet të marrë përsipër kurrë të vuajë në ahiret për arsye të kësaj bote.

Resulullahu (a.s.), para se të ndërronte jetë, këtë çështje e ka shprehur në këtë mënyrë në testamentin e tij:

“O njerëz! Secili që i ka hyrë në hak tjetrit, le ta shlyejë menjëherë atë, le të mos mendojë për poshtërimin në këtë botë. Le ta dini mirë që poshtërimi në këtë botë, përballë poshtërimit të botës tjetër nuk ka fare vlerë.” (Shih. Ibni Sa'd, II, 255; Taberi, Tarih, III, 191)

Një pjesë e njerëzve, pasi dëgjuan këtë fjalë të të Dërguarit të Allahut, rrëfyan disa padrejtësi dhe gabime që kishin bërë më parë dhe iu lutën Profetit të bënte dua dhe istigfar për ta. Njëri prej tyre u ngrit në këmbë dhe tha:

- O Resulullah! Pasha Allahun, unë jam shumë gënjeshhtar, jam edhe hipokrit. Nuk kam lënë gjë të keqe pa bërë.

Atëherë Resulullahu (a.s.), tha:

- O Omer! Poshtërimi në këtë botë nuk është asgjë përballë poshtërimit në botën tjetër! – dhe më pas u lut për këtë njeri në këtë mënyrë:

“O Allahu im! Bëje të mundur që ai njeri të jetë njeri me fjalë të drejta dhe të piqet nga aspekti i besimit! Bëje të mundur që veprat e tij të këqija, t'ia kthesh në të mira!” (Taberiu, Tarih, III, 190)

Le të japim këtë shembull kaq domethënës, që tregon se sa rrezik i madh është të lësh mënjane ahiretin dhe t'i përvishesh pasurisë dhe posteve të kësaj bote:

Në periudhën e emevive ushtria islame kishte nisur udhëtimin me shpresën që ta meritonte ajo përgëzimin dhe lajmin e mirë profetik lidhur me ngadhënjimin e Stambollit. Në mesin e kësaj ushtrie gjendej edhe **Ebu Ejub el-Ensari** (r.a.). Kur bizantët po luftonin duke u mbështetur në kështjellat e qytetit, një njeri nga ensarët shkoi hipur në kalin e tij deri në mes të Bizantit. Pasi besimtarët e panë këtë gjë, duke u nisur nga ajeti **“Mos e hidhni veten tuaj në rrezik”**, thirrën të tmerruar duke e qortuar sahabiun në këtë mënyrë:

“La ilahe il-lall-llah! Pa shikoni si e hedh veten në rrezik!”

Kurse Ebu Ejub el-Ensari (r.a.), tha kështu:

“O besimtarë! (Të mos keqkuptohem!) Ky ajete ka zbritur lidhur me ne ensarët. Kur Allahu e ndihmoi Pejgamberin dhe i dha triumf fesë së tij, ne i patëm thënë: “Le të qëndrojmë në krye të punëve tona dhe të angazhohemi me to.” Atëherë, Allahu i Madhëruar i pati shpallur këtë ajete të Dërguarit të Tij: **“Shpenzoheni pasurinë në rrugën e Allahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; Allahu me të vërtetë i do bamirësit.”** Qëllimi i “mos e çoni veten tuaj në shkatërrim”, që përmendet në këtë ajete, ishte për arsye se ne kishim mënjeluar dhe kishim lënë përpjekjen për rrugën e Allahut dhe ishim krehur në angazhimin e gjërave të kësaj bote, si vreshatat dhe kopshtet.” (Shih. Ebu Davud, Xhihad, 22/2512; Tirmidhiu, Tefsir, 2/2972)

Pejgamberi ynë i dashur (a.s.), thotë po ashtu:

“Sikur dynjaja të kishte vlerë në syrin e Allahut sa një krah i mushkonjës, Ai nuk do të bënte të mundur asnjë të pafe që të pinte qoftë edhe një gllënjë ujë.” (Tirmidhiu, Zuhd, 13)

“Kujtojeni shpesh vdekjen, e cila shkul nga rrënjët të gjitha dëshirat.” (Tirmidhiu, Kijamet, 26)

“Kush ka dëshirë ahiretin, Allahu i jep pasuri zemrës së tij dhe ia bën të mbara punët. Pas kësaj, dynjaja i përulet atij dhe ikën pas tij. Dhe cilitdo që ka vënë synim dynjanë, Allahu i vendos varfërinë mes dy syve dhe ia ngatërron punët. Si përfundim, njeriu nuk arrin të përvetësojë nga kjo botë më shumë sesa i është caktuar.” (Tirmidhiu, Kijamet, 30/2465)

Një nga paraardhësit (shehzade) e pafat të historisë osmane, Xhem Sulltani, ishte zënë rob nga kalorësit e Rodosit, si përfundim i betejës për pushtet dhe ata ia shitën Papës. Papa Inoçenti VIII, i premtoi Xhem Sulltanit se, nëse do të bëhej i krishterë, do ta ndihmonte të kalonte në pushtet. Ky propozim i erdhi shumë i rëndë Xhem Sulltanit. U mërzi dhe tha:

1. El-Bekara, 195.

“Jo pushtetin osman, por pushtetin e të gjithë botës sikur të ma jepnit, nuk ndërroj fe!”

Kur vuri re se do të përdorej nga kryqëzatat kundër myslimanëve, iu drejtua Zotit dhe tha kështu:

“O Zot! Nëse të pafetë duan të më bëjnë vegël kundër myslimanëve, mos e bëj të mundur që ky njeri i yti të jetojë më shumë! Bëma të mundur të ma marrësh shpirtin në praninë Tënde!”

Një ditë, padishahu i Telemsanit, Sulltan Jahjai, kishte dalë me oborrtarët të shëtiste qytetin. Popullit po i shkëlqenin sytë përballë madhësisë së tij dhe të atyre që kishte përreth, nga frika u ngrit në këmbë dhe po e nderonte duke brohoritur: “Rroftë Padishahu!” Por padishahut, po i binte në sy një njeri që ishte i shkëputur nga masa, një njeri, nuri i të cilit po vezullonte përreth. Kur pyeti se kush ishte ai njeri, ata i thanë:

- Madhëri, ai është Shejhu i njohur nga Tunizia. Jeton një jetë askete (inziva) në një shpellë.

Sulltanin e zuri një kureshtje edhe më e madhe, e drejtoi kalin drejt Shejhut nga Tunizia dhe i bëri këtë pyetje:

- A është e lejuar të fal namaz me këtë rrobë të mëndafshtë që kam sipër?

Sado që Shejhu nga Tunizia refuzoi të përgjigjej dhe rekomandoi t’ia bënte këtë pyetje dijetarëve të sarajit të vet, për arsye të këmbënguljes së sulltanit, dha këtë përgjigje:

- Mendoni sikur një qen të ketë gjetur një kafshë të ngordhur, ta ketë ngrënë atë duke pëlcitur, ta ketë bërë berbatë përreth dhe të ngrrej këmbët lart që të mos përlyhet me ndotjen kur ai po kryen nevojën...

Sulltani nevríkose dhe thotë:

- Çfarë do të thuash me këtë?

Shejhu i tha:

- Dua të them këtë, që stomaku dhe trupi juaj është i ngarkuar me peshat më të mëdha të haramit dhe me padrejtësi ndaj njerëzve. Ndërkohë, ju më pyesni nëse është e lejuar apo e ndaluar të fal namaz me veshje të mëndafshëta?



“O njerëz! Secili që i ka hyrë në hak tjetrit, le ta shlyejë menjëherë atë, le të mos mendojë për poshtërimin në këtë botë. Le ta dini mirë që poshtërimi në këtë botë, përballë poshtërimit të botës tjetër nuk ka fare vlerë.”

në mes dhe tha:

- Myslimanë! Bëmani hallall dhe gjeni tjetër sulltan për veten tuaj!

Pasi tha këto, shkoi pas Shejhut nga Tunizia dhe u bë nxënësi besnik i tij.

Sulltan Jahjai arriti në një stad aq të lartë në edukimin shpirtëror nga Hazreti Shejhu, sa që Shejhu nga Tunizia, kur filloi t’i kërkonte populli të bënte dua për ta, tha:

- Kërkojeni duanë nga Jahjai, sepse po të isha unë në vendin e tij, nuk do të bëja atë që ka bërë ai... Sikur sulltanët ta dinin thesarin e lumturisë që ka arritur ai, edhe ata do të sakrifikonin gjithçka të tyre, siç bëri Jahjai!”

Hazreti Ibrahim bin Ed’hem, i cili la pushtetin e kësaj bote dhe arriti pushtetin shpirtëror, ka thënë kështu:

“Sikur të ishte diçka konkrete entuziazmi dhe përmallimi ynë në dashurinë hyjnore; mbretërit do të flijonin të gjithë thesarin dhe të gjithë pushtetin për ta përvetësuar atë.”

Këto fjalë të urta ndikuan thellë te sulltani. Pas kësaj, i flaku tutje rrobat e mëndafshëta. Më pas, hodhi në një krah shpatën që kishte

Besimi në Allahun

Prof. dr. M. Jashar Kandemir

Allahu Teala, i ka urdhëruar të gjithë robërit e Tij, duke u thënë:

“...S’ka Zot tjetër përveç Meje, andaj vetëm Mua më adhuron!” (el-Enbija, 25)

Me anë të këtij urdhri të prerë, Allahu i Madhëruar na e bën të ditur se s’ka Zot tjetër përveç Tij. Dhe na thotë se ai që i beson Atij, ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë.

Ai thekson se çdo krijesë në qiej dhe në tokë, me dëshirë apo pa dëshirë, i përulet Atij dhe se njeriu nuk duhet të kërkojë fe tjetër përveç Islamit.

Shkurtimisht

Të gjithë duhet t’i kthehen Zotit të tyre dhe të gjithë duhet të nxjerrin në pah ndjenjën e fesë, të cilën Allahu Teala e ka vendosur brenda njeriut, kur e ka krijuar. Kjo, sepse ashtu siç ka thënë edhe Profeti ynë (a.s.), të gjithë kanë kapacitetin e duhur për të pranuar fenë e Allahut.

Në shumë ajete të Kuranit Kerim thuhet:

Ata që i besojnë Allahut dhe bëjnë punë të mira, përgëzohen me mirësitë e pafundme të xhenetit. Ndërsa, ata që nuk besojnë Allahun, do të përballen me fatkeqësi, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër.

AJETI QË TREGON MË MIRË PËR ALLAHUN

Allahu Teala, në Kuranin Kerim, ka treguar për Vetën e Tij, aq sa ka dëshiruar që ne të dimë për Të. Ajeti që jep infor-

macione më të qarta dhe më të organizuara në lidhje me besimin në një Zot të vetëm, është “ajetu’l-Kursi”. Profeti ynë (a.s.), ka thënë se ai është ajeti më rëndësishëm i Kuranit.

Kuptimi i këtij ajeti, është si më poshtë:

“Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron. Kursi-u i Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën dhe Ai nuk e ka të rëndë t’i ruajë ato. Ai është i Larti, Madhështori!” (el-Bekare, 255)

FORMULA E TEUHIDIT

Si do ta tregojë një rob që i ka besuar Allahut, pra që është besimtar? Sipas asaj që ka thënë Profeti ynë (a.s.), besimi ka deri në gjashtëdhjetë

ose shtatëdhjetë degë. Në krye të këtyre, zë vend fjala, "La ilaheil-lallah".

Ai që thotë "La ilaheil-lallah", ka thënë se **"Allahu është një dhe i vetëm"**. Këtë shprehje e njohim ndryshe edhe si Formula e Teuhidit. Por le të dëgjojmë se çfarë ka thënë i Dërguari i Allahut (a.s.), në lidhje me rëndësinë e Formulës së Teuhidit dhe se çfarë përfitojmë prej saj:

"Kush thotë La ilaheil-lallah, hyn në xhenet."

"Kush vdes duke besuar se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, hyn në xhenet."

"Ai që thotë fjalën e fundit të tij: "La ilaheil-lallah", hyn në xhenet."

"Ai që thotë "La ilaheil-lallah", le të ketë bërë ç'të dojë më parë, sepse një ditë kjo fjalë do ta shpëtojë."

Profeti ynë (a.s.), kishte shumë dëshirë që xhaxhai i tij, EbuTalibi, të bëhej mysliman. Dhe këtë dëshirë ia paraqiti shumë herë. Prandaj, kur xhaxhai i tij ishte në shtratin e vdekjes, ai i tha edhe njëherë:

"Xhaxha! Thuaj La ilaheil-lallah, që në ditën e gjykimit të dëshmoj pro teje."

Mirëpo, xhaxhai i tha:

"Nipi im! Sikur ta dija se kurejshët nuk do të më akuzonin duke thënë se "u bë mysliman nga frika", do ta kisha plotësuar dëshirën tënde duke e thënë atë fjalë!"

Mbi këtë ngjarje zbriti edhe ajeti i më poshtëm:

"Vërtet, ti (Muhamed) nuk mund të udhëzosh kë të duash, por është Allahu Ai që udhëzon kë të dëshirojë. Ai i njuh më mirë ata që janë të udhëzuar." (el-Kasas, 56.)

EMRAT E BUKUR TË ALLAHUT

Kur idhujtarët e Mekës i kërkuan

Profetit tonë (a.s.), t'u tregonte për Zotin në të cilin besonte, zbriti surja el-ihlas, e cila e prezanton Allahun shkurt dhe me cilësitë më të spikatura:

"Thuaj: 'Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amëshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Të!'" (el-ihlas, 1-4)

Në Kuranin Kerim janë përmendur **"Emrat më të bukur të Allahut"**.

Këta emra, të cilat quhen edhe "esmaul-husna", janë përmbledhur në këto tre ajete:

"Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër. Njohësi i së dukshmes dhe i së padukshmes, Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti!"

"Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër. Ai është Sunduesi, i Shenjti (i pastër nga çdo e metë), Paqedhënësi, Dhënësi i sigurisë, Mbikëqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori. Qoftë i lartësuar Allahu mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)!"

"Ai është Allahu, Krijuesi, Zanafillësi, Ai që i jep trajtë çdo gjëje. Atij i përkasin emrat më të bukur; Atë e përlëvdon gjithçka që ndodhet në qiej dhe në Tokë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti." (el-Hashr, 22-24)


Profeti ynë (a.s.), na ka përgëzuar, duke thënë: "Allahu ka nëntëdhjetë e nëntë emra. Njëqind pa një. Kush i mëson përmendsh, duke ua ditur edhe kuptimin, hyn në xhenet. Allahu është tek dhe e do tekun." (Buhari, Muslim, Nesai, Tirmidhi, Ibën Maxhe)

AI ËSHTË KRIJUESI I ÇDO GJËJE

Sipas atyre që kemi mësuar prej shumë ajeteve, Allahu Teala është i Vetmi që mban gjithçka në dorë, që merr dhe jep, që lartëson dhe poshtëron, që vdes dhe ngjall. Këtë e tregojnë më së miri këto dy ajete:

"Thuaj (o Muhamed): 'O Allah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash; Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Çdo e mirë është në Dorën Tënde! Ti je vërtet i Plotfuqishëm për çdo gjë."

"Ti bën që nata të hyjë tek dita dhe dita të hyjë tek nata. Ti e nxjerr të gjallën prej së vdekurës dhe të vdekurën e nxjerr prej së gjallës. Ti i jep kujt të duash pa kufij." (Ali Imran, 26-27)





Ndjeshmëria ndaj shpërdorimit ose etika e konsumit

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Shpërdorimi (israf) është një koncept kuranor, që ka kuptimin e të tejkaluarit të asaj çfarë konsiderohet e mesme, pra teprimi në përdorimin e diçkaje. Edhe nëse përdoret për mundësitë dhe vlerat materiale, si pasuria dhe trashëgimia, ky koncept përfshin çdo gjë që tejkalohet në përdorim. Shpërdorimi, ashtu sikurse mund të përdoret në raste konsumi ushqimor apo veshjesh, mund të përdoret edhe për kohën, shëndetin dhe ambientin. Shkalla më e ulët e konsumit është koprracia, kurse ai që ndodhet në skajin e kundërt të koprracisë është shpërdorimi. Në këto dy ajete, kjo temë përmendet në këtë mënyrë: **“Dhe ata që, kur shpenzojnë nuk janë as dorëshpuar, as dorështrënguar, por i përmbahen së mesmes;”** (Furkan, 67) **“Mos e shtrëngo dorën, as mos u bëj dorëshpuar e të mbetesh i qortuar dhe i mjerë.”** (Isra, 29)

Sipas Islamit, edhe koprracia edhe shpërdorimi janë ndjenja e pashprehur. Për shkak të dobësisë që ka për nefsën, njeriu shpërdoron duke bërë shpenzime të pakontrollueshme. Njeriu, po ashtu, duke u bazuar në ndjenjën e të kursyerit, bën koprracin dhe i bën rojën pasurisë së vet. Zekati, që është një obligim hyjnor dhe fetar, në këtë rast është një spastrim; edukon ndjenjën egoiste që ka njeriu, e shpëton atë nga smira dhe koprracia. Kështu, e mëson atë të jetojë ekonomikisht, pa tejkaluar masën në përdorim. Obligimi i zekatit ka veçorinë e të ndarit të mundësive materiale që ka njeriu. Islami është një rrugë e mesme që urdhëron drejtësinë, që i kushton rëndësi ekuilibrit dhe këshillon të jemi etikë edhe kur konsumojmë. Ata që bëjnë koprracin në jetë,

janë pikërisht ata që bëjnë shpërdorime të shfrenuara dhe adhurojnë nefsën e tyre, pasi koprraci, për arsye se mendon vetëm për veten e vet, nuk ndan gjë me të tjerët. Gjithashtu edhe shpërdoruesi, ngaqë mendon vetëm për dëshirat e veta, e përdor pak kontroll gjithçka ka në duar. Ndaj dhe shpenzimi i tepruar që bën njeriu për veten e vet, është quajtur shpërdorim. Kurse ajo çfarë shpenzon për tjetrin nuk hyn në këtë kallëp. Shpërdorim do të thotë të shpenzosh më shumë seç duhet dhe të qenit i papërmbytur në konsum. Myslimanët përkufizohen në Kuran si një popull që ndjek rrugën e mesme. (shih. Bekare, 143) Gjithashtu, në Kuran gjenden plot ajete që ndalojnë shpërdorimin. Dy nga këto janë:

1. “Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë.” (Araf, 31)

2. “Është Ai që ka krijuar kopshte vreshtash të larta dhe të shtruara, hurma dhe bimë me shije të ndryshme, ullinj e shegë, të ngjashme dhe të ndryshme. Hani frutat e tyre kurdo që të prodhojnë dhe jepni atë që është detyrë në ditën e vjeljes së tyre! Por mos e teproni, se Allahu nuk i do ata që e teprojnë!” (Enam, 141)

Në Kuran gjendet edhe një tjetër koncept që ka kuptimin të përafërt me shpërdorimin, ai është *tebzir*. (Isra, 26) *Tebzir* është në kuptimin “të derdhësh dhe të shpërndash”, “shpenzimi që bëhet në një vend të palejuar”. Është një përmasë më tej shpërdorimit. Shpërdorimi përfshin shkeljen e kufijve që ka vendosur feja jonë e bukur dhe ekstremizimin e veprimeve. Ndaj dhe Allahu i Madhëruar

na mëson që ne të bëjmë dua: **“O Zoti ynë! Na i fal gjynahet tona dhe teprimin në punën tonë, na i forco këmbët (në istikam) dhe na ndihmo kundër popullit jobesimtar!”** (Ali Imran, 147)

DËMET E SHPËRDORIMIT

Shpërdorimi është një çmenduri e konsumit. Shpërdorimi ka dëme, si materiale ashtu edhe shpirtërore në planin personal dhe në atë shoqëror.

1. Dimensionimi personal i dëmit të shpërdorimit

Shpërdorimi në jetën e njeriut ka dëme si materiale, ashtu edhe shpirtërore. Ngaqë shpërdorimi është të konsumosh më tepër sesa prodhon ose të shpenzosh më shumë sesa ajo çfarë ka nevojë njeriu, fillimisht shkatërron buxhetin personal dhe atë familjar. Ndërsa, ata që përkufizojnë ekonominë thonë se “ekonomia është shkenca që përballon nevojat e pakufijshme përmes burimeve të kufijshme”. Pra ekonomia pranon që nevojat janë të pakufijshme dhe burimet të kufijshme. Ndaj dhe burimet duhen përdorur shumë mirë, duhen kufizuar nevojat dhe konsumi duhet bërë sipas normave etike. Kjo gjë arrihet duke ndaluar shpërdorimin dhe duke ekuilibruar konsumin. Dëshirat dhe nevojat e njeriut nuk zënë të ndalen. Për të realizuar këto nuk mjafton një jetë e tërë. Kështu njeriu duhet të shpenzojë tërë jetën për nevojat e tij dhe nuk do mund të kishte kohë për nevoja shpirtërore, si, adhurim, art etj. Thonë se “Ai që nuk di çfarë kërkon, nuk e vëren atë që gjen”. Njeriu i sotëm nxiton për dëshirat dhe shpenzimet e shfrenuara të tij, ngaqë ka humbur vlerat e larta dhe gjykimet e sakta. Po ashtu, i ka humbur interesi për ndjenjat e larta, si arti, letërsia, adhurimi dhe ndjesia e të shërbyerit, që i shkojnë njeriut.

Shpërdorimi ka edhe dëmet shpirtërore dhe etike, të cilat nuk janë më pak të rëndësishme sesa dëmi material dhe ekonomik i konsumit. Kjo dëshirë e drejton njeriun nga ndjenja për të pasur dhuntitë e dynjasë, që quhen *tul-i emel* (të vepruarit sikur nuk do të vdesësh kurrë) dhe ambicie. Konsumi i shfrenuar e bën njeriun egoist. Kështu, njeriu kap dhe gëlltit gjërat e dynjasë, sikurse toka që thith ujën. Vesi kryesor i njeriut është egoizmi. Njeriu, si pasojë e dashurisë dhe e lidhjes që ka me nefsën e vet, përpiqet të plotësojë dëshirat e nefsit dhe të gjejë mënyra që ta realizojë këtë gjë. Pa pasur një edukim të nefsit dhe të dëshirave, është e vështirë, madje e pamundur të frenohen këto ndjenja. Kjo qasje edukative, që synon të parandalojë shpërdorimin, mund ta pengojë sado pak njeriun të sillet

si pronari i vërtetë i pasurisë, duke përfituar nga dhuntitë e botës.

Epërsia e ndjenjës së altruizmit lind solidaritetin e jo shpërdorimin. Shpërdorimi i ndaluar është shpenzimi që bën njeriu për vete, mbi nevojën që ka. Nuk është shpërdorim ajo çfarë shpenzon për të tjerët. Sipas qasjes “futuvvet”, që njihet si një normë etike, shpenzimi i tepruar që bën njeriu për vete, është shpërdorim, kurse shpenzimi që bën njeriu për të tjerët, sado shumë qoftë, nuk është shpërdorim. Shpërdorimi ushqen egoizmin dhe pragmatizmin. Egoizmi dhe pragmatizmi e largon njeriun nga sakrifica për tjetrin, duke menduar “jeto jetën tënde”, e frenon atë të jetë bujar. Në fakt, sjellja që del në kundërshtim me këtë është qasja “një kafshatë një triko”, sepse sipas këtij botëkuptimi, nuk është e rëndësishme pasuria e kësaj bote, por ndarja me të tjerët, të duash të tjerët më shumë se veten dhe të shpërndash gjithçka ke tjetër përveç një kafshate dhe një trikoje. Kjo nuk do të thotë të braktisësh punën dhe të mos jesh produktiv, por duke punuar të mos shpenzosh për vete, por për tjetrin dhe të ndihmosh vëllain që është në vështirësi, pra të bëhesh altruist. Vendi ku mund të ketë më shumë efekt dhe që mund të funksionojë më së miri botëkuptimi “një kafshatë një triko”, është fusha e konsumit. Veçanërisht sot, “ekonomia e shpërdorimit” përmes publiciteteve të ndryshme ka marrë përmasa të mëdha. Gjithçka bazohet në parimin e konsumit, ndaj dhe shpërdorimi është shtuar me hapa galopantë. Duke u bazuar në mendimin “një kafshatë një triko”, hyjnë nën kontroll nevojat e njeriut dhe vendin e ekonomisë së konsumit

e zë ekonomia e nevojës. Kështu, njerëzit do të shpëtojnë së përdoruri në mënyrë të tepruar mundësitë që ofron teknologjia, i pasuri nuk shtyp të varfrin, i varfri do të shpëtojë së shikuari me zili pasurinë e të pasurit dhe nuk do ta vuajë tërë kohën dhimbjen e skamjes. Shpërdorim quhet kur njeriu do të realizojë çdo dëshirë që i shkon në mendje dhe mospasja kufi në këtë pikë. Kufizimi që u bën njeriu dëshirave dhe nevojave, përbën thelbin e etikës së konsumit. Një ditë, Hz. Omeri e sheh të birin, Abdullahin, tek po hante mish dhe e pyet: “Ç’ne, mish po ha?”. “Po – i përgjigjet i biri, - më vajti mendja për mish, prandaj”. Hz. Omeri u mërzi dhe i drejtohet të birin: “D.m.th. ti ha çfarë të shkon në mendje. A nuk e di ti se Profeti ynë ka thënë se të hash gjithçka të shkon në mendje është shpërdorim?” (Shih. Ibn Maxhe, Et’ime, 51.) Shpërdorimi e pengon njeriun të kontrollojë nefsën. Njeriun e bën që të bëhet skllav i nefsit dhe nefsën e bën perëndi të tij. Ajeti: **“A e ke parë ti atë që epushin e vet e ka marrë për zot?”**

*Shpërdorimi ka edhe dëmet shpirtërore dhe etike, të cilat nuk janë më pak të rëndësishme sesa dëmi material dhe ekonomik i konsumit. Kjo dëshirë e drejton njeriun nga ndjenja për të pasur dhuntitë e dynjasë, që quhen *tul-i emel* (të vepruarit sikur nuk do të vdesësh kurrë) dhe ambicie.*

A do t'i bëhesh mbrojtës atij? (Furkan, 43), pikërisht këtë dëshmon. Njeriu zakonisht nuk e vëren që po bën shpenzime të tepruara, sepse **"Kështu, shpërdoruesve i zbukurohet ajo që punojnë."** (Junus, 12) Tejgopja nga dhuntitë e Zotit sjell në pah nevoja dhe skamje të reja. Në syrin e një njeriu që ushqehet, vishet apo konsumon në forma të tjera, zvogëlohet vlera e dhuntive. Njeriu që nuk bën shpërdorim dhe që frenon disa dëshira të tij, është i lumtur, sepse dhuntitë kanë më vlerë në syrin e tij.

2. Dimensioi social i shpërdorimit

Shpërdorimi, ndoshta më shumë se një devijim që bën individi, është një devijim që bën shoqëria. Ai që mësohet me shpërdorimin, shkon në një gjendje që nuk mendon më për të tjerët. Në këtë mënyrë, rritet edhe ndarja klasore në shoqëri. Sjellja që bëjnë të pasurit si shpërdorues, shtyp të varfrit dhe hap disa plagë sociale tek ata, plagë të cilat mund t'i drejtojnë për në shpërdorim. Në fakt, njeriu, për sa kohë që di të ndajë me tjetrin, është i respektuar dhe i lumtur. Kushti kryesor i dashurisë është ndarja dhe sakrifica. Të ndash pasurinë me të tjerët. Ata që i ka zënë sëmundja e shpërdorimit, nuk ndajnë me të tjerët. Ndaj dhe që të mos mësohen njerëzit me shpërdorimin, Muhamedi (a.s.), u ka thënë: *"Ujin nuk duhet ta shpërdoroni, edhe sikur të merrni abdest në lumë."* (Ibn Maxhe, Tahere, 48.) Çdo lloj shpërdorimi që bëhet sot në shtëpitë tona, është një plagë shoqërore, duke ia nisur nga uji që harxhohet kot nga rubinetet e shtëpisë sonë, deri tek ushqimi që hidhet në kosh. Thuhet se sasia vjetore e shpërdorimit që i bëjmë pasurisë dhe energjisë e ka kaluar në shifër debitorit buxhetor. Lumturia e shoqërisë është e bazuar në dy shtylla të veçanta, njëra është materiale dhe tjetra shpirtërore. Fuqia ekonomike i përket asaj materiale, kurse besimi dhe etika janë shpirtërore. Shoqëritë që i ka prekur shpërdorimi, nuk mund të arrijnë fuqinë e duhur ekonomike. Kjo shoqëri nuk mund të shpëtojë pa u bërë debitorë. Huaja i bën ata skllevër edhe nga aspekti ekonomik edhe nga ai kulturor, ata mbesin të varur prej tyre. Çdo investim dhe shpenzim që bëhet në dobi të shoqërisë, është jashtë asaj çfarë quajmë shpërdorim.

Shkaqet që përgatisin shpërdorimin:

Në krye të shkaqeve që përgatisin shpërdorimin është dëshira për të konsumuar, e cila është e natyrshme (fitri) tek njeriu. Për sa kohë që kjo dëshirë nuk edukohet që të frenohet ose për sa kohë që të ketë një klimë që e mban gjallë këtë ndjenjë, njeriu gjithnjë do ta teprojë në përdorim. Një nga shkaqet që paralizojnë shpërdorimin është rrethi shoqëror, ndikimi që bëjnë njerëzit tek njëri - tjetri. Sot kësaj i është shtuar edhe elementi "publicitet". Mjetet reklamuese, që i drejtohen veçanërisht syrit dhe

veshit, u bënë lokomotivat e ekonomisë së konsumit.

RRUGËT E SHPËRIMIT NGA SHPËRDORIMI

Për të parandaluar shpërdorimin dhe ekuilibruar konsumin, ka disa detyra dhe përgjegjësi që bien mbi shoqërinë:

1. Në planin individual

Edukimi është rruga e parë që shpëton të mos biesh pre e shpërdorimit. Njeriu duhet edukuar fillimisht në familje, pastaj në shkollë dhe në shoqëri, lidhur me shpërdorimin. Ata duhen edukuar që të mos bëjnë shpenzime të tepruara. Të rriturit duhet të jenë shembull për të vegjëlit lidhur me kujdesin që duhet bërë ndaj materialeve të shtëpisë dhe shkollës dhe ndaj pasurisë së shtetit. Duhet ta ngulisim mirë në mendje e zemër se çdo lloj dëmi që i shkaktojmë rrethit shoqëror apo fizik, është brenda shpërdorimit. Duhet të jemi të ndërgjegjshëm që, aq sa ne edhe të tjerët kanë të drejtë për të jetuar. Nuk duhet harruar që për gjithçka që shpërdoret, ka njerëz që kanë nevojë për të.

2. Në planin shoqëror

Në jetën shoqërore parandaluesja kryesore është të mësohet të ndash. Duhet larguar nga ideja e shfrytëzimit të mallit të shtetit. Ne duhet të mbrojmë si të tonat vendet dhe mundësitë që përdorim në mënyrë të përbashkët. Duhet të botojmë gjëra që sensibilizojnë individin dhe shoqërinë lidhur me shëndetin dhe shfrytëzimin e kohës së lirë dhe ne na duhet të zhvillojmë zakonet e të lexuarit.

3. Në planin shtetëror

Pa konsumuar nuk prodhohet, por detyrë e shtetit është t'i shpëtojë nga dhuna e publiciteteve, që vështirësojnë gjendjen ekonomike dhe shkallën sociale të njerëzve. Shteti duhet të ndër marrë hapa parandalues për shpërdorimin e kohës, mundësive dhe duhet ta shpëtojë popullin nga ambicia e luksit dhe shpërdorimit.

E kundërta e shpërdorimit është produktiviteti. Rritja e produktivitetit në punë, në industri, në prodhimtari, pikësepari është detyrë e shtetit.

Përfundimisht, shpërdorimi është përdorimi pa ndërgjegje dhe në mënyrë të panevojshme i çdo lloj burimi dhe mundësie. Mënyra për të shpëtuar nga kjo gjë kalon përmes ndërgjegjësimit individual apo social, sensibilizimit të shtetit dhe bërjes së marrëveshjes mes shtetit dhe popullit. Nëse duam të jetojmë të lumtur në vendin tonë dhe t'u lëmë gjëra të bukura brezave që vijnë pas, atëherë le të bëjmë shpenzime më të ekuilibruara, brenda kornizës së etikës së konsumit, duhet të kërkojmë rrugë për të shpëtuar nga çdo lloj shpërdorimi.



DIS-EQUILIBRIUM DIS-EQUILIBRIUM

Nuredin Nazarko

Njeriu është qenia që shqetësohet për fatin e vet, mbi sipërfaqen e tokës. Natyrshëm që ky shqetësim buron prej pasigurisë se çfarë pret ai t'i ndodhë në të ardhmen e panjohshme. Edhe pse i trazuar nga shqetësimi për qetësi, faqeza tij qëndron mundësia e zgjedhjes mbi mënyrën e jetësimit të ekzistencës së tij, mbi mënyrën e jetësimit të *modus vivendi*-t. I gjendur përballë së ofruarës, njeriut i duhet të përcaktojë sipas çfarë rendi gjërash duhet të jetësojë ekzistencën e tij, pasi përkundraill tij përvijohet realiteti i të kundërtave: mirë-keq, drejtë-gabim, morale-jomorale, etike-joetike, trup-shpirt, shëndet-sëmundje, vuajtje-lumturi, jetë-vdekje. Në këtë gjendje, vendimi dhe përgjegjësia mbi vendimin e të zgjedhurit mbetet të jetë personale dhe e tillë është. Njerëz të moshave të ndryshme, të karaktereve të ndryshme, të formimeve të ndryshme realizojnë zgjedhjen e tyre, në bazë të së cilës fillon e përvijohet jetësimi i ekzistencës. Duke marrë të mirëqenë faktin se zgjedhja si akt i një ngjarjeje madhore dhe dramatike, është bërë përputhshmërisht me parimet e epërme, të cilat në thelb janë universale, të mbarëkohshme dhe të pandryshueshme, ne ngremë shqetësimin se në çfarë mënyre përjetohet ky ndryshim dramatik i mënyrës së të jetuarit tek njeriu që ka marrë këtë vendim dhe çfarë impakti ka ky përjetim në përvijimin e mëpasshëm të *modus vivendi*. Natyrisht, do të ishte fare pa vend që ne t'i vendosim të gjithë njerëzit që kanë vendosur t'i përkasin së njëjtës përkatësi, në të njëjtin rrafsh përjetimi dhe

emocionaliteti. Secili përjeton autentikisht dhe në mënyrë krejt origjinale ndjesinë e ndryshimit përbrendësor të tij. Nuk ka shkallë matëse që të na ofrojë përmasën e ndryshimit të përjetuar, përdërisa ky ndryshim është metafizik, por është Koha (*në thelb metafizike*) gjykatësi që zbulon vërtetësinë e përkatësisë sonë të pretenduar në erën e pasndryshimit. Kalimi nga një gjendje në një gjendje tjetër shtron përpara nesh një trajektore lëvizjeje, që mbart në vetvete vendin prej nga ku filloi ndryshimi, rrugën nëpër të cilën kaloi dhe vendin ku synon të arrijë. Çdokush që ka prekur truallin e ndryshimit, e ka prekur në një stad të caktuar kohor dhe në kontekstin e rrethanave të caktuara të realitetit me të cilin dhe në të cilin jetojmë. Kjo do të thotë se pakkush mund të ketë pasur fatin që trajektorja e lëvizjes së tij të jetë shenjuar dhe frymëzuar nga një model i gjallë i jetësimit të parimeve të epërme, qysh nga fëmijëria e tij. Trajektorja e lëvizjes për shumë njerëz ka qenë dhe është një miksaturë mes pasojave të tranzicionit postkomunist, kuptimit personal të asaj çfarë ka lexuar dhe interpretimit e ligjërimit religjioz të një kaste të caktuar njerëzish, të cilët në vetvete janë produkt i kësaj miksature, duke i shtuar dhe një përbërës të rëndësishëm, të jetuarit e tyre për njëfarë kohe në kontekste dhe rrethana të ndryshme nga realiteti me të cilin dhe në të cilin jetojmë. Kësisoj, rrugëtimi i trajektores së lëvizjes mbetet



një sfidë e hapur në përpjekjet e vazhdueshme për jetësimin e ekzistencës sipas parimeve të epërme. Por këto përpjekje nuk mund të jenë të imunizuara nga influenza e të jetuarit në shpellën platoniane në stadin e parandryshimit. Por si përjetohet ky ndryshim dramatik në trajektoren e lëvizjes për jetësimin e ekzistencës? Pranimi i parimeve të epërme dhe përkatësia në të vërtetën që na shfaqet nëpërmjet tyre, është ndryshim epokal për qenien njerëzore. Pas këtij ndryshimi, nuk do të thotë që ndryshimi mbetet konstant dhe nuk vazhdon të ndryshojë. Fillet e këtij ndryshimi epokal janë tmerrësisht emocionante dhe idealistike. Emocionante, sepse po shkel në një rrugë të re, po lëviz në një terren të pashkelur më parë, në pritie të surprizimeve që do të rrjedhojnë nga njohja me të panjohshmen e deridjeshme. Idealistike, sepse beson se tashmë e ardhmja e tij e pasndryshimit do të jetë një e ardhme e ndritur e imunizuar ndaj çfarëdolloj rragimi kontraversal në interioritetin e tij. Ky njeri idealistik dhe me frymëzim të lartë, beson se tashmë duhet të japë gjithçka dhe asgjë. Gjithçka për botën, asgjë për veten. Po përse gjithçka për botën dhe asgjë për veten? Pikërisht sepse beson se, duke pranuar përkatësinë tek parimet e epërme, qenia e tij është plotësuar njëherë e përgjithmonë dhe jetësimi i ekzistencës për të është përsosmëri e këtij plotësimi. Dhe, meqenëse ndihet i plotësuar njëherë e përgjithmonë, çfarë do t'i duhej t'i jepte vetes më së shumti? Atëherë beson se fusha e misionit të tij është shpëtimi i botës, duke e ndryshuar atë dhe jo vetvetja. Nisur nga kjo premisë bazike për veprimtarinë e mëtutjeshme, përpiqet me mish e me thonj të jetësojë deri edhe detajet më të imta të parimeve të epërme, sepse vetëm kështu nuk ndihet i kërcënuar nga rragimet kontraversale të interioritetit. Duke u përkapur pas jetësimit të detajeve të imta, trajektorja e lëvizjes fillon e shformohet në thelbin e vet, duke ofruar tashmë një panoramë të përmbysur të këtyre parimeve. Detajet kthehen në bosht qendror, ndërsa boshtimi përreth thelbit të këtyre parimeve zhvendoset drejt periferisë. Kjo përmbysje raportesh nuk mund të mos japë impaktin e saj, tek njeriu ku zë vend kjo përmbysje. Ekstremizimi është pasoja e menjëherëshme dhe qendërlëkundëse e këtij njeriu. Ngjyrat që sheh optika e tij janë bardh e zi. Ai fillon e ndërton në

përfytyrimet dhe imagjinatën e tij një realitet idealistik dhe përpiqet të jetësojë ekzistencën sipas këtij realiteti të ngritur mbi ekstremizimin dhe interpretimin e njëanshëm, selektiv, fragmentar të parimeve të epërme. Ndërkohë që ai jeton në kështjellën e tij "të pamposhtur", realiteti jashtë kësaj kështjelle është tjetërfarë. Që të mos molepset nga ky realitet i zi dhe i kobshëm, mosdalja nga kështjella është gjëja që do të dëshironte më së shumti. Mirëpo njeriu është qenie që jeton në botë dhe bota nuk është as standarde, as njëdimensionale dhe as që mund të jetë ndonjëherë, pasi ajo është botë për të jetuar njeriu, pikërisht sepse përvijohet mbi realitetin e të kundërtave. Ky njeri, që jeton në kështjellën e tij, themelisur përmbi shenjtërimin e detajzimeve, sa herë që hedh vështrimin tej bedenave ndjen neveri dhe pështirosje për realitetin jashtë kështjellës. Mirëpo, kështjella e tij nuk është vetëprodhuese dhe herë pas here i duhet të bëjë ndo-

një shkëmbim jashtë kështjelle. Këto dalje ia përforcojnë bindjen e patundshme se ai ka gjithmonë e kurdoherë të drejtë, sepse ai është i frymëzuar sipas pretendimeve të tij, nga parimet e epërme. Dalëngadalë, universalitetin dhe gjerësinë e parimeve të epërme fillon dhe e zvogëlon aq sa, për të jetësimi i ekzistencës prej tjetrit është i drejtë dhe i vërtetë, vetëm në qoftë se realizohet sipas modelit të kështjellës së tij. Çdo model jashtë kështjellës së tij është vetëm se anatëmë, madje edhe kur këto modele ndajnë të njëj-

Njeriu duhet të synojë të njohë të vërtetën dhe ai mund të bëhet në kuptimin e plotë njeri, vetëm në atë shkallë në të cilën del mbanë në zgjidhjen e kësaj detyre.

tën përkatësi. Mirëpo, siç thonë edhe latinët, *non semper erit aestas (jo gjithmonë do të jetë verë)*. Përballë sfidës së hapur të jetësimit të ekzistencës në muret brenda kështjellës, përkundraill qëndron një realitet që nuk mund të ndryshohet në tërësisshmërinë e tij. Kjo vështrësi e ndryshimit të realitetit jashtë kështjellës, edhe pse koha rrjedh, prodhon frikë, pasiguri, pafuqishmëri dhe entuziazmi revolucionar i ndryshimit të botës fillon e fashitet rrëshqanthe. Përballë dështimeve dhe mossuksesit, në vend që t'i kërkojë shkaqet në vetvete, fillon e tjerr alibi me furkën e akuzës, përmes të cilave fajëson destruktivitetin e faktorit të jashtëm dhe mbron kështjellën e themelisur keqas. Por a mund të fajësohet shiu pse pikon çatia? Ky moskthim drejt vetes dhe moskritikim i saj, është produkt i drejtpërdrejtë i edukimit në shpellën platoniane, ku besohen për të vërteta dukjet dhe shmanget

soditja dhe veshtimi ndaj thelbit të gjërave. Dogmatizimi i detajeve të parimeve të epërme është simptomë dukshme e qartë, e pakuptimësisë së thelbit të parimeve të epërme. Pafuqia e ndryshimit të rrjedhës së gjërave dhe dështimet e revolucionarizimit mesianik, mund të derivojnë me përfundje në shtjellat e humnerave të fundbotshme, degdisje në zgrip të humnerave të fundbotshme, shtrembërime dhe deformime të personalitetit ose reflektim për kuptimësi të thelbit të parimeve të epërme. E natyrisht që nuk përfundon me kaq. Po aq sa nuk janë të imunizuar ata që ekstremizojnë përkatësinë e tyre ndaj parimeve të epërme, po aq nuk janë të imunizuar as ata të cilët, duke dashur t'i shpëtojnë ekstremizimit në ngurtësi, bien në ekstremizim në përshtatshmëri. Edhe trajektorja e lëvizjes në rastin e përshtatshmërisë, gati-gati të tërësishme, paraqitet në thelbin e saj e shformuar dhe e përmbytur. Njeriu që përshtatet, shformohet në thelbin e vet dhe bosht qendror i përkatësisë së tij ndaj parimeve të epërme është përshtatja e këtyre parimeve sipas dobësive të preferencave të tij individuale, edhe pse përdor si alibi pamundësinë e ndryshimit të realitetit në të cilin dhe me të cilin jetojmë. Kjo pamundësi është reale, por ai e përdor pamundësinë si mbulojë të dobësisë së personalitetit të tij dhe përkundrajt përshtatshmërisë nuk bën më dallim se çfarë është qendrore dhe çfarë është periferike, çfarë është thelbësore dhe çfarë është detaj, madje dhe thelbësoren mund ta kthejë në një detaj të përshtatshmërisë, duke lundruar kështu me anije pa direk në detin plot shkulme dhe tallaze. Përshtatshmëria si shformim i thelbit të parimeve të epërme, tregon dobësi, pasiguri, frikë në vetvete dhe kompleks inferioriteti. Ky njeri "e ka shndërruar veten e tij në mall, i privuar nga të gjitha cilësitë e qëndrueshme dhe të përcaktuara, përveç nevojës që të pëlqehet dhe gatishmërisë sa duhet shpesh, për të këmbyer rolet e veta. Përderisa përpjekjet e tij sjellin sukses, ai në një farë shkalle e ndjen veten në siguri, por humbja e gjithçkaje të mirë nga vetja, heqja dorë nga të gjitha vlerat njerëzore, shpien në një zbrazëti të brendshme dhe pasiguri, të cilat zbulohen gjatë çdo disfate të tij".¹ Nevoja për t'u pëlqyer është diçka së cilës nuk mund t'i ikësh lehtësisht. Por kjo nevojë është prezente më së

Njeriu duhet të jetë i pavarur dhe i lirë, ai duhet të jetë qëllim dhe të mos shërbejë si mjet i realizimit të qëllimeve të njerëzve të tjerë.

shumti tek i përshtaturit, ndryshe nga ngurtësuesi, që pranon të marrë mbi vete shigjetimet e të tjerëve, si rezultat i përkatësisë së tij. I përshtaturit duhet të ndrydhë përkatësinë e tij ndaj parimeve të epërme, duke u sjellë në një masë të konsiderueshme si bashkëkohor, për të përfutur pëlqimin dhe miratimin e shumicës. I përshtaturit, nisur nga nevoja për pëlqim mund të rrëshqasë drejt reklamimit, spektaklit, fanfarizimit, banderolizimit të parimeve të epërme, pra drejt një forme pa përmbajtje, drejt një përjashtësie pa brendësi. Në këtë gjendje, kahja poshtërorizuese, mund të godasë përçdoanshëm, të përshtaturin dhe këto goditje mund të jenë aq qendërlikundëse, saqë mund të përdorë si mbulojë parimet e epërme për përmbushjen e dimensionit materialistik, sepse i shenjtë për të mund të jetë tashmë pragmatizmi.

Por çfarë duhet të synojë njeriu, për t'i shpëtuar *dis-equilibrium*? Nuk është e lehtë, por as e pamundur, pasi që njeriut nuk mund t'i kërkohet realizimi i së pamundurës. Përkatësia ndaj parimeve të epërme nuk do të thotë engjellizim për njeriun. Ato i dëftojnë qartë njeriut se është vetëm njeri dhe si i tillë, duhet ta jetësojë ekzistencën e tij. Njeriu nuk mund të jetë kurrsesi i përsosur, edhe pse në opinionin e njerëzve, ata që u përkasin parimeve të epërme nuk duhet të bëjnë qoftë dhe një gabim të vetëm. Njeriu duhet të ndërgjegjësohet se është njeri dhe si i tillë, do të gabojë, por ai duhet të ngrihet me gjithë fuqinë e personalitetit të tij përmbi këto gabime, duke u përpjekur të ekuilibrojë dikotominë e tij. Ky ekuilibrim nuk nënkupton mesatare aritmetike, por kuptimësi të thelbit të parimeve të epërme, kuptimësi që buron nga thellësia e thellësisë së zemrës, pastërtisht e sinqertë, prej nga buron urtësia, shpirtmadhësia dhe mençuria e njeriut.

"Njeriu duhet të synojë të njohë të vërtetën dhe ai mund të bëhet në kuptimin e plotë njeri, vetëm në atë shkallë në të cilën del mbanë në zgjidhjen e kësaj de-tyre. Njeriu duhet të jetë i pavarur dhe i lirë, ai duhet të jetë qëllim dhe të mos shërbejë si mjet i realizimit të qëllimeve të njerëzve të tjerë"², sepse siç thonë edhe latinët *nemo liber est qui corpori servit* (nuk është i lirë askush që skllavërohet nga dëshirat e trupit).

1. Fromm, E, "Psikoanaliza dhe feja", Tiranë 2002, Plejad, faq. 72

2. Fromm, E, "Psikoanaliza dhe feja", Tiranë 2002, Plejad, faq. 72-73

ZIDANJE SKADRA DHE KËNGA E ROZAFATIT, VËSHTRIM KRAHASUES

-Ma. Ermira Ymeraj

Argumenti. Ndriçimi i lidhjeve të ritit të flijimit në mendësinë e njeriut parabiblik dhe biblik, si dhe njohja me vetë ritualin e flijimit, krijon premisa që flijimin si simbolikë e paqtitimit me perëndinë ta vëzhgojmë dhe si *dukuri etnografike*¹ e psikologjike e kulturave ballkanike, përgjatë kohës së lindjes së baladave. Çdo kulturë e formuar brenda hapësirave kufitare të një kodi të përbashkët gjuhësor, të një hapësire të përbashkët nacioni gjeografik e historik, përcjell veçoritë psikologjike të botës së tij shpirtërore, brenda mënyrës së vet të jetesës, brenda kulturës së vet materiale si dhe brenda shijeve të veta estetike.

Vështrimi i shoqërisë ballkanike si *tërësi*² dhe ekzaminimi i secilit areal kulturor në raport me njëri-tjetrin, kërkon përpjekjen për të kuptuar shpjegimin e ngjashmërive dhe ndryshimeve përballë tekstit të flijimit. Ballkani është ura që lidh Europën me Azinë. Brenda arealit ballkanik, takimi me tjetrin ndodh në një sfond klishesh, stereotipesh dhe përfytyrimesh motivore dhe kjo përbën thelbin e qasjes krahasuese mes qytetërimeve dhe kulturave³. Takimi me tjetrin në fushën e studimeve ka nxjerrë në pah narcizmin nacional, ku tjetri paraqet vlerat e një motivi brenda hapësirës së tij gjeografike dhe lënien në hije të territoreve të huaja gjeografike, ku motivi është përhapur. Studiuesit pohojnë se është mjaft e dëmshme dhe pengesë shkencore mënyra se si një studiues pretendon përparësinë e varianteve greke në një baladë, një tjetër të atyre rumune, shqiptare apo sllave, studime të tilla të shpien deri në paragjykim dhe anashkalim metodash, faktesh dhe objektiviteti shkencor, që padyshim, jo vetëm projektton keq tjetrin, por dhe veten⁴. Ka dallime të rëndësishme dhe ngjashmëri në lidhje me transmetimin e simbolikës së flijimit ndërmjet baladave të vendeve të ndryshme, sidomos në baladat e murimit në kala. Legjenda e murimi, si legjenda e gruas së mururar në mur, përfshihet në baladat me sfond mitik. Klosi do shprehej: *"Ne nuk jemi duke folur për moshën aktuale të legjendës, e rëndësishme është prania ose mungesa e figurave mitike në legjenda"*⁵. Ndërsa Ratzel⁶ argumentoi se: *Kulturat zhvillohen kryesisht nëpërmjet migrimeve masive dhe pushtimit të popujve më të dobët prej atyre më të fortë dhe me kulturë më të përparuar, që njihet në kulturën difuzioniste si bartje e kulturës. Difuzioni*⁷ i motivit të

1. Barnard, Alan. "Historia dhe Teoria në Antropologji", përkth. Lumnjë Kadriu, IAP, Prishtinë 2011, f. 23.

2. Po aty, f. 97.

3. Chevrel, Yves. "Letërsi e krahasuar", Albin, Tiranë 2002, f. 10-11.

4. Për më gjerë shih: Sinani, Shaban. "Pengu i moskuptimit", Tiranë 1997, f. 72-84.

5. Klosi, Ardian. "Mitologjia në veprën letrare". Revista "Nëntori" 1991/1, f. 137.

6. Barnard, Alan. vep. e cit., f. 100.

7. Po aty, f. 96.

flijimit si element kulture ishte i prirur të shpërndahej nga qendra në periferi të cilitdo areal kulturor. Prandaj është konstatuar se trajtat e gjetura në periferi ishin më të vjetra, se ato të gjetura në qendër, që ishin shtuar me elemente më të reja. Në këtë vijë, mbledhësit e baladave e lehtësojnë studimin për etnopsikologjinë e motivit të *flijimit* brenda arealit tonë kulturor dhe shpërndarjes së tij nga *qendrat kulturore* në periferi, ku kufijtë lumorë dhe malorë, ndikojnë në llojin e baladës së përhapur në atë zonë, sipas rendit kohor.

Ndryshe nga motivi i vëllait të vdekur ose vëllait të vogël që ngrihet nga varri për të sjellë në shtëpi motrën, i përhapur në gjithë Europën, motivi i murimit, që rrjedh nga rituali i sakrificës në ndërtimin e kalasë, është i panjohur për një pjesë të arealit ballkanik dhe evropian. Ndërsa vetë motivi i sakrificës, si ritual i sakrificimit, është i njohur në të gjithë botën nga kohët e lashta dhe popujt e Egjiptit, te popullsia skandinave, rusët, te gjermanët, francezët, anglezët, te popujt aziatikë te kinezët, japonezët etj.

Mbledhësit e folklorit kanë vënë në dukje 150 variante të baladës së murimit, përhapur në vise të ndryshme të arealit tonë gjeografik. Nga murimi në kala, ku nusja me vetëdije pranon sakrificën sakrale, në murimin në urë në jug, ku nusja i trembet sakrificës, deri te murimi në kishë, ku nusja gënjehet, bëhet e vështirë të gjendet zona qendrore, nga ku ka ndodhur difuzioni për në qendra të tjera periferike. Ndër faktet e shumta të dhëna nga studiuesit vlen të veçohet pohimi i studiuesit se: *Në traditën popullore shqiptare këngët e flijimit, ndonëse gjejnë përhapje në gjithë hapësirën kombëtare, në pjesën më të madhe, siç u përmend, janë të lidhura me një rajon që mund të konsiderohet si vatër bazë. Nuk do nënçmuar fakti që kjo vatër përmban në kryeqendër kalanë më të vjetër në Shqipëri. Ajo është kalaja që dëshmon të dy periudhat më të mëdha të jetës së popullit, qysh prej burimit deri në ditët tona: periudhën ilire dhe atë shqiptare. Ajo ka qenë madje, nëse duam ta themi, edhe në fazën e kalimit prej ilirëve tek shqiptarët, do të thotë prej etërve tek bijtë, kalim që ndodhi (vetëm) një herë në histori (...).*⁹

Po në pellgun motivor të flijimit të përhapur në më shumë se 700 variante, në arealin ballkanik thuhet se rrathët qendrorë a burimorë nga ku nisi difuzionin e vet balada e murimit vijnë nga arketipi grek si variante të origjinës, variantet shqiptare, bullgare dhe arumune janë të varura dhe në lidhje paralele me njëra-tjetrën si areale të para ku ka shtegtuar motivi grek. *Eliade* do pohonte se në asnjë tjetër letërsi gojore (përveç asaj rumune) balada e sakrificës së murimit do të njihet si një kryevepër e vërtetë dhe se është më i bukuri artis-

tikisht që nisi udhën nga folklori rumun. *Vuk Karaxhiq* pohon se murimi në *kalanë e Shkodrës* është perla e folklorit sllav. Studiuesit grekë, pasi studiojnë 333 variante lokale të baladës së *Urës së Artës* dhe pasi i krahasojnë me baladat e të njëjtit motiv në zona të tjera të ballkanit, flijimin e sjellin me origjinë në arealin lindor grek, si pasqyrim i mitologjisë së lashtë helene. Ndërsa studiuesit shqiptarë pohojnë faktin se në qendër të baladës së murimit është motivi etnopsikologjik i besës, i njohur si virtyt etnozakonor i shqiptarëve, kjo sipas tyre e bën atë shqiptare. Më tepër *Sinani* do pohojë se: *Por mbi të gjitha, kënga për kalanë e Shkodrës, qytetit ku gjendet Rozafa antike, përmban mendësinë parahistorike të njeriut të hershëm për paqtimin e natyrës para lëndimit me themele, për një marrëveshje me të për një vepër të përbashkët, të cilën një palë do ta ngrejë dhe tjetra do ta mbajë. Le të shënojmë kalimthi se në emrin e Rozafës, me sa duket do parë përfundimisht emri i vendlindjes së dy shenjtorëve hebrej, Sergji e Baku, që ndërtuan bri Bunës një prej kishave më të hershme të Shqipërisë. Ata erdhën në botën shqiptare nga Rozafa izraelite.*⁹

E ndërsa debatet vazhdojnë nën dritën e teorive të reja, ne do vlerësojmë pohimet e tyre me themel krahasimin e motivit të murimit si tradita nacionale, dhe do ndalemi në krahasimin motivor ilustrues brenda legjendës së kështjellës së Shkodrës dhe Zidanje Skadra të sllavëve.

Koha e mbledhjeve të kujtesës orale nga françeskanët nxori në pah bashkëpërkimet dhe përthyerjet në aspektin psikologjik, antropologjik, historik dhe gjeografik të legjendës. *Vladan Djordević*¹⁰, për me provue që populli shqiptar ishte i vetmi vend në Europë, qi s'kishte ni epope komtare, shkruante në veprën e vet "Arnauti i Veliko Sile": "Kurse Shqyptarët s'kanë kurrnji kangë popullore te vetme mbij Shkodrën, lahutorët serbë kndojnë shum luftime heroike per at gjytet ma tepër kan dhe nji kang të gjatë mbi ndërtimin e Shkodrës". Në variantin tonë janë rujtun dy emra malesh *Maldunus* thirret kodra mbi të cilën u ngreh kalaja e Shkodrës dhe *Kazena* vend përtej *Buenës*, ndërmejt kishës së *Sh'Mris Magdalena* e *Zarufës*, gruja e flijume ne variantin serb kur merr vesh për flijimin u lutet dy kuneteve "qi as me sy s'po e shikojnë" / idhnohet e idhshëm bërtet si nji gjarpën i idhtë. *Marin Barleti*¹¹ do shkruante: "Na patën rënë në dorë disa shkrime (...). Ishin shkruar aty në gjuhën popullore se një farë *Roza* me motrën e vet të quajtur *Fa*, qenë themeluesit e parë të Shkodrës e prandaj fortesa e saj quhet *Rozafa*".

9. Po aty, f. 44..

10. *Hylli i Dritës*, 1930, f. 541 - 548.

11. *Barleti, Marin. "Rrethimi i Shkodrës"*, botim i dytë, Tiranë 1967, f. 35.

8. *Sinani, Shaban. "Një dosje për Kadarenë"*, (studime dhe dokumenta), OMSCA-1, Tiranë 2005, f. 45.

EPOKA E ZEKATIT, EPOKA E DASHURISË



Rabla Christine Brodbeck

Zoti i Madhëruar thotë: **“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni. Çfarëdo që të ndani, Allahu e di mirë atë.”**

I nderuari Mevlana, thotë: *“Në fenë e dashurisë, gjithçka duhet flijuar.”*

Nga Hulefai Rashidin, Imam Aliu e kanë pyetur: “O Imam! Çfarë dhe sa duhet të japësh për zekat? Cila është dispozita e zekatit në fenë islame?” Ai ktheu këtë përgjigje: “Për koprracët, zekati është një e dyzeta; kurse sipas nesh, duhet dhënë gjithçka.”

Ja pra, një prej thirrjeve më sublime që manifeston zenitin e dashurisë joreciproke për gjithë njerëzimin: *“Kush më kërkon, më gjen; kush më gjen, më njeh; kush më njeh, më do. Kush më do Mua, edhe Unë e dua; Unë ndodhem pranë atij që më do; gabimi i atij që dua, është gabimi Im; përgjegjësia e atij që dua, është përgjegjësia Ime.”*

Një njeri i urtë ka thënë kështu: “Për gjithçka që kemi, duhet të paguajmë një çmim. Ndaj dhe njeriu duhet të japë zekatin. Zekati i trupit është namazi dhe agjërimi. Zekati i pasurisë është të japësh një të dyzetën e

saj. Kurse zekati i dashurisë është gjithnjë të japësh, gjithnjë.”

Kur është pyetur Resulullahu (s.a.s.): “Cila është vepra më e dobishme e njeriut?”, ai është përgjigjur kështu: *“Përpjekja për të përmirësuar dhe forcuar marrëdhëniet mes njerëzve dhe sjellja me butësi ndaj krijesave të Allahut.”*

Përmes dashurisë që shprehim ndaj njerëzve matet gjithçka që është e lidhur me atë se kush jemi, çfarë bëjmë dhe se si sillemi. Nuk është e rëndësishme se çfarë bën, por si e bën. Nuk është e rëndësishme se sa ibadet bën, por se si bën ibadet. Nuk është e rëndësishme se sa shërben, por se si shërben. Zekati pa dashuri është i shëmtuar. Zekati që jepet pa dashuri, është dyfytërsi, është fyerje ndaj të varfrit, ndaj nevojtarit. Nëse Kuranin Famëlartë e lexojmë pa e dashuruar, pa zemër, dëbojmë të vërtetat që ndodhen në gjuhën tonë.

Zekati bën që ne të arrijmë në vetëdijen se gjithçka i përket Allahut të Madhëruar dhe të gjitha dijet vijnë nga Ai. Faktikisht, njeriu nuk ka asgjë në këtë botë, madje as fëmijët e as veten e tij. Zekat do të thotë të zgjedhësh nevojat e vëllait tënd, në vend të nevojave personale, edhe sikur të kemi nevojë imediate vetë. Hz. Ebu Bekri (r.a.), që gjendet në krye të sakrificës dhe bujarisë, ka thënë: “Bujari e vërtetë është ajo, kur ndihmon tjetrin, ndërkohë që vuan për vete.” Dhimbjet dhe fatëkeqësitë duhet t’i bashkojnë njerëzit. Problemet me të cilat përballet bota, duhet të na bëjnë të bashkohemi të gjithë. Qëndrimi indiferent ndaj padrejtësive që u bëhen vëllezërve tanë në një cep të botës; ftohtësia ndaj të sëmurëve dhe nevojtarëve, është tregues i papërgjegjshmërisë së njerëzve. Është e vdekur ajo zemër që qëndron indiferente ndaj vuajtjeve që përjetojnë në anën tjetër të botës, që nuk bëhet krah materialisht apo që nuk bëhet aktive me dua për vuajtjet që përjetojnë. Muhiddin Ibn Arabiu ka thënë: “Asnjë shpërblim që u

jepet njerëzve kundrejt veprave që bëjnë, nuk mund të zërë vendin e kënaqësisë që i jep dashuria që i shpreh njerëzimit.”

Dashuria dhe dhembshuria janë thelbi i njerëzimit. Qielli jep shi dhe dheu begatohet. Një zemër, që është e mbushur me dashuri dhe dhembshuri, zbutet gjithnjë; një zemër, që është e butë, qan gjithnjë për Allahun. Lotët që rrjedhin me dashuri për Allahun ushqejnë sipërfaqen e tokës dhe rritet pema e harmonisë plot me dashuri. Pikërisht ajo pemë i jep dobi gjithë njerëzimit; kurse frutat e saj ushqejnë shpirtat që dëshirojnë etje dhe ndihmë, risk, mbështetje, miqësi dhe dashuri.

Duhet të mendojmë se çfarë kuptimi ka t’u shërbesh njerëzve në nevojë. Zoti i Madhëruar thotë: “Unë jam me ata që kanë zemrën e thyer.” Zoti ynë, që është Rahman dhe Rahim, është bashkë me ata që janë shtypur, të pambrojtur, jetimë e bonjakë dhe me ata që i ka zënë ndonjë fatkeqësi; pra, Allahu është me ata që kanë nevojë për Të. Të ndihmosh ata që kanë nevojë, është të përmbushësh pritshmërinë që ka Allahu nga njeriu. Duke ndihmuar krijesat e Tij dhe duke u bërë i dobishëm për krijesat e Tij, bën që të realizohet qëllimi i krijimit.

Një urtësi e dispozitës së zekatit është që njeriu ta vërë në funksion vetëdijen si një njeri besimtar, që është i lidhur me të gjithë njerëzimin, planetin dhe gjithësinë. Dhurimi (infak), shton kujdesin tonë ndaj të gjitha krijesave dhe na bën të jemi më të ndërgjegjshëm ndaj detyrave tona si njerëz. Në këtë kontekst, burimi i diturisë më të vyer është shprehur në këtë ajet: **“Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!”** Zoti ynë do që ne të dimë se është një kusht hyjnor për të hyrë në xhenetin e Tij dhe në kuptimin që xheneti do të fitohet nga mesi i njerëzve, thotë: **“Bashkohu me robërit e Mi”**. Pra, njeriu mund

të arrijë në përsosmëri përmes ibadetit. Allahu do që të na tregojë se dashuria shfaqet atëherë kur jemi të dobishëm për të tjerët. Është e lehtë të jesh një hoxhë, një akademik besimtar i ditur apo një profesor i fesë; por nuk është e lehtë të jesh një rob i vërtetë i Zotit. Ngaqë nuk jemi pranë Allahut, kur mund të jemi pranë Allahut? Vetëm atëherë kur të jemi pranë njerëzve.

Thelbi i dashurisë është të ndihmosh të tjerët dhe të shpërfillësh nevojat e tua. Sadakaja e nefsit është të bësh dua për mbarësinë e të tjerëve. Duaja e vërtetë është në kuptimin shkrirjes së nefsit deri në pikën e *Mabudu Hakiki*. Jetojmë në *ahirzaman*. Nuk pranohen duatë që bëhen për veten tonë. Pranohen vetëm duatë që bëhen për vëllezërit. Ndaj dhe duhet të bëjmë dua për njëri – tjetrin. Kështu, duaja personale është një edukatë e mrekullueshme, që na bën të mendojmë për njerëzit e tjerë, të ndiejmë sikurse ndiejnë ata dhe të kërkojmë diçka për ta; mësojmë artin e të jetuarit për të tjerët dhe artin e të dhuruarit. Ja pra! Njerëzit e ditëve të sotme duhet të flijojnë veten për njerëzimin.

Feja islame ka tre kushte kryesore për të arritur në përsosmërinë e imanit: të duam për fqinjin atë që duam



Një urtësi e dispozitës së zekatit është që njeriu ta vërë në funksion vetëdijen si një njeri besimtar, që është i lidhur me të gjithë njerëzimin, planetin dhe gjithësinë. Dhurimi (infak), shton kujdesin tonë ndaj të gjitha krijesave dhe na bën të jemi më të ndërgjegjshëm ndaj detyrave tona si njerëz.

për vete; të duam Pejgamberin (s.a.s.), më shumë se këdo tjetër dhe më shumë se gjithçka; të duam njëri – tjetrin për hir të Allahut. Nëse nuk i përmbushim këto kushte, nuk mund të arrijmë as në stadin e *mu'min-it*. I gjithë umeti i Muhamedit (a.s.), me apo pa vullnet, jeton i nënshtruar ndaj këtyre kushteve. Nëse e shkrijmë nefsin tonë, që është për hir të Allahut, brenda vëllazërisë dhe, nëse arrijmë në vetëdijen e detyrës sonë si robër të Zotit, arrijmë të kuptojmë se dhurimi është më i domosdoshëm në ditët e sotme, se asnjëherë tjetër. *Ahizamani* është një kohë e mbarsur me rëndesën e brengës e të nevojës. Emigrantët, jetimët, të skamurit, endacakët, të papërkrahurit, të shtypurit, të frikësuarit, vejjushat, të sprovuarit me luftë, viktimat e tërmeteve, furtunave dhe cunamëve, ata që s'kanë asgjë nga kjo botë, ashtu të zbathur, presin ndihmë prej nesh; presin duatë tona; presin që t'u drejtohen për qafime, që t'u largohen sado pak shqetësimet dhe t'u tregohet pak ngrohtësi; presin shtëpi, rroba, ushqime, ujë, shkollë, edukim. Gjenden me qindra mijëra refugjatë, që janë dëbuar e braktisur, nga shtëpitë e tyre, nga kulturat e tyre, nga vendet e tyre, që janë shkëputur nga familjet e tyre.

Fatkeqësitë natyrore, potenciali shkatërrues i terrorizmit, zullumi politik i zullumqarëve në kurriz të të vërfërve dhe të të mjerëve, u kanë shkatërruar gjithçka kanë pasur, madje edhe familjet e tyre. Tragjeditë njerëzore që janë përjetuar, tregojnë se një pjesë e madhe e popullsisë së botës në një formë krejt të çuditshme, ka arritur në atë pikë, sa nuk mund të jetojë jetën e vet të qytetëruar dhe pret të ndihmohet! Këta janë jetimët e botës moderne. Presin të japin llogari, sikur po jetojnë provën e Ditës së Llogarisë. Kurani Famëlartë na mëson: **“Vetëm ata që janë të humbur nuk u frikësohen të papriturave të Allahut.”**(dhe ata që vërtet e duan) (A'araf, 99.). Edhe Resulullahu (s.a.s.), ishte një jetim i vetëm në shkretëtira. Edhe ata që janë braktisur në shkretëtirën e shoqërive moderne, përpiqen t'i ngajjnë atij, sepse njeriu që është pa njeri, i vetmuar, i skamur dhe pa rrugëdalje, i drejtohet Allahut. Akoma s'ka mbaruar bonjakëria! Bota i ka ngulitur sytë e varfërisë dhe nevojës mbi ne dhe po na vështron. Të kuptosh Profetin e begatë, është të kuptosh bonjakërinë, të qenit e tij një Pejgamber *ummi* dhe emigrimin (*hixhret*) e tij. Të jesh bashkë me të, do të thotë të ndash *fakr-in* (varfërinë) dhe nevojën e tij: *“Pozita ime është një fakr i përsosur; fakr-i im është krenaria ime.”*

Për besimtarët, mbështetja tek Allahu është shumë e rëndësishme. Rruzulli tokësor, sot po ekspozon fotografitë e lotëve të nevojës. Në ditët e sotme, kjo nevojë është e pandotur dhe e dëlirë, sepse nuk ka mbetur asgjë tjetër veç saj. Ndaj, të bësh atë që kërkon Krijuesi për krijesat. Kërkesa e Allahut që robërit e Tij të përmbushin këtë dëshirë të shenjtë, është që

ata të drejtohen për mbështetje tek Ai. Edhe sikur të jetonim në pasuri dhe bollëk, sikur të mos ishim emigrantë, edhe sikur të mos kishim humbur shtëpitë, familjet, plaçkat



Zekat do të thotë të zgjedhësh nevojat e vëllait tënd, në vend të nevojave personale, edhe sikur të kemi nevojë imediate vetë. Hz. Ebu Bekri (r.a.), që gjendet në krye të sakrificës dhe bujarisë, ka thënë: “Bujari e vërtetë është ajo, kur ndihmon tjetrin, ndër kohë që vuan për vete.”

tona, do i drejtohem Samedit Një (Allahut). Le të mendojmë sikur të ishim vërtet ashtu, jetimë, të papërkrahur, emigrantë! Le të kuptojmë nevojën që kemi për Të dhe t'i japim formë jetës sipas saj! Nëse do të bëjmë kështu, gjithçka do të zgjidhet dhe do të arrijmë prehjen shpirtërore që të jep ajeti: **“Ata janë të kënaqur me Të dhe Ai është i kënaqur me ta.”** Le t'i lutemi Zotit të na shtojë nevojën për Të dhe të jetojmë të lidhur me Të!

Shërbimi që i bëhet fesë islame, është shërbimi që i bëhet xhematit muhamedan, që është shoqëria më e nderuar në mesin e të gjitha shoqërive. Shërbimi që bëhet pa sakrifikuar ndonjë gjë, nuk tregon ndonjë vlerë të rëndësishme. Rruga për të fituar pëlqimin hyjnor kalon përmes dashurisë për hir të Allahut, veprës për hir të Allahut dhe jetës për hir të Allahut. Djesitja jonë, lotët tanë, dridhja jonë, përpjekja në rrugë të vërtetë janë tregues të dashurisë që kemi për krijesën më të nderuar, Zotërinë tonë (s.a.s.), familjen dhe shoqërinë e tij. Jeta jonë duhet kushtuar për të studiuar jetën e shokëve të tij dhe duhet jetuar si ata. Në një hadith kud-



si, Zoti i Madhëruar thotë: **“Nuk dua asnjë çmim prej jush. E vetmja gjë që dua është të doni ata që dua unë dhe jeni pranë Ehli Bejtit.”** Me nurin e udhëzimit të tyre mund të

Bujaria është krijim (she'n) i Zotit të Madhëruar. Në çdo çast të jetës sonë dëshmojmë mirësitë, dhuntitë dhe bujarinë absolute të Zotit, që bie mbi krijesat e Tij. Ndaj dhe bujaria është esenca e njerëzimit të vërtetë, stolia e qenies.

arrijmë në shpëtim. Ata janë marrësit e drejtpërdrejtë të fjalëve, lëvizjeve dhe sjelljeve të Pejgamberit (a.s.); janë trashëgimtarët e karakterit fisnik të tij, sepse ata e kanë ndjerë aromën e shenjtë të shpalljes hyjnore. Ne kemi një përgjegjësi morale kundrejt çdonjërit që është nga umeti i tij. Resulullahu (a.s.) është dërguar si mëshirë për mbarë botët. Atëherë, a nuk mund të tregojmë edhe ne ndaj vëllezërve myslimanë një të njëqindtën e dashurisë, respektit dhe kujdesit që kishte ai? Në rruzullin tokësor nuk ka njeri apo krijesë tjetër që të jetë mundur aq sa është mundur Pejgamberi ynë i dashur (a.s.). Asnjë pejgamber nuk është shqetësuar kaq shumë për umetin e vet, sa është shqetësuar ai. Ja një hadith që tregon dashurinë dhe kujdesin e pakufijshëm që kishte Pejgamberi ynë për ne, hadith që prek thellë në zemër: *“Unë shoh atë që nuk shihni ju; dëgjoj atë që nuk dëgjoni ju; sikur ta dinit se si rënkon qielli me një oshëtim të tillë që... Ashtu duhet të ishte, në fakt; pasi, në qiej nuk ka vend të zbrazët as sa katër gishta, që të mos jetë vend sexhdeje për engjëjt. Pasha*

Allahun, sikur të dinit atë që di unë, do të qeshnit pak e do të qanit shumë, madje do t'i shmangeshit dëfrimit me gratë tuaja dhe do t'i përgjëroheshit Allahut, duke ulëritur në male e shkretëtira!”

Shkurtimisht, çfarëdo që t'u bëni njerëzve, ia keni bërë Allahut. Mirësinë që e bëni për krijesat e Tij, e bëni për Të. Siç është e nevojshme pasqyra për të vënë re bukurinë, po aq e nevojshme është bota e të varfërve dhe nevojtarëve për të pasqyruar bukurinë shpirtërore të njeriut. Pra, për të dalë në pah një mirësi si bujaria, ka nevojë për njerëz të varfër dhe nevojtarë. Njerëzit e varfër dhe të skamur janë pasqyrë e bujarisë dhe mëshirës së Zotit. Bujaria është krijim (she'n) i Zotit të Madhëruar. Në çdo çast të jetës sonë dëshmojmë mirësitë, dhuntitë dhe bujarinë absolute të Zotit, që bie mbi krijesat e Tij. Ndaj dhe bujaria është esenca e njerëzimit të vërtetë, stolia e qenies. Kjo cilësi kaq e përsosur, është një nur që edhe një jobesimtar e bën të fillojë të besojë, nëse e vëren një gjë të tillë tek shoku i tij.

O Zoti ynë!

O Zoti ynë! Na bëj të mundur ta njohim kuptimin dhe vlerën e domethënies së dërgimit të tij si mëshirë. Na bëj të mundur të kemi pjesë nga mëshira dhe dashuria e tij e pashuar. Na e bëj atë melhem për të gjitha plagët tona shpirtërore, na bëj ngushëllim për zemrat tona të thyera, na bëj prehje për zemrat tona që janë të mbytura nga dëshpërimi. Na bëj një pjesë e duasë së tij: *“O Zot, mua më duhesh Ti dhe vetëm Ti!”*. Na bëj një pjesë e duasë së tij: *“O Zot! Bëje të mundur që të jetoj si i varfër, merrma shpirtin po si i varfër dhe më ringjall si të tillë.”* Na bëj të mundur ta ndiejmë natyrshmërinë (fitra) dhe thesarin e thjeshtësisë së tij. Na bëj pjesëtarë të dashurisë së tij dhe të admirimit të tij ndaj Teje. Na bëj pjesëtarë të sinqeritetit të tij ndaj Teje.

O Zoti ynë!

“O Zoti im! Ti je Rahman, Rahim, Vedud!” Gjithçka është në Duart e Tua plot mëshirë dhe dashuri. Ti je me ata që kanë zemrën e thyer! Ti je mbrojtësi i jetimëve, vejjshave, nevojtarëve, të papërkrahurve. Je mik i të vetmuarve, i të sëmurëve, i të braktisurve. Ti je me atë që strehohet tek Ti me një nevojë të pakufijshme, me këdo që ka nevojë për Ty. Ti do atë që të do. Thua: **“Dashuria e tyre ndaj Meje është dashuria ime, qenia ime.”** Kurani thotë: **“Ata e duan Atë edhe Ai i do ata.”** Dashuria më sublime është ajo dashuri që ndien ndaj krijesave. Ne duam të strehohemi në atë dashuri dhe mëshirë, që u ke manifestuar krijesave të Tua. Duam të jemi në mesin e atyre njerëzve zemërthyer, bashkë me të cilët Ti je. Duam të jemi pjesëtarë të mëshirës dhe dhembshurisë së pakufijshme që përhap mbi ta. Ndërkohë që u shërbejmë krijesave të Tua, na bëj prej robërve Tuaj që mbështeteten tek Ti!



Nderimi i Kuranit Fisnik

Ahmet Hamdi Jëlldërëm

“Me të vërtetë, ky është një Kuran i nderuar në Librin e ruajtur. Atë (Kuranin) mund ta prekin vetëm të pastrit.” (el-Vakia 56/77-79.)

Në krye të detyrave që kemi kundrejt Kuranit fisnik, është respekti e nderimi ndaj tij dhe zbatimi i ligjeve të tij, sepse burimi i Kuranit fisnik, është Allahu Teala. Për këtë arsye, respekti ndaj Kuranit fisnik, është shenja më e dallueshme e adhurimit ndaj Allahut të madhëruar.

Edhe njëra prej shfaqjeve më të rëndësishme të respektit që duhet të kemi ndaj fjalës së Allahut, është leximi i Kuranit fisnik duke qenë i pastër. Pra, ne nuk duhet ta prekim Kuranin fisnik kur jemi pa abdest dhe nuk duhet ta lexojmë kur jemi xhunub apo kur gratë janë në periudhën specifike të tyre.

Në lidhje me këtë çështje, i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

“Dikush që është xhunub apo me menstruacione, nuk mund të lexojë asgjë nga Kurani fisnik.”

Megjithëse ka prej atyre që e pranojnë si të dobët këtë hadith nga aspekti i letërsisë së hadithit, dijetarët e hadithit në kohët e fundit, si Shejh Ahmed Shakiri dhe Shejh Shuajb el-Arnauti, shprehen se hadithi është i saktë kur vlerësohet bashkë me transmetimet e tjera të tij (shevahid). Nga ana tjetër, dijetarët myslimanë kanë punuar me dispozitën e këtij hadithi dhe e kanë konsideruar haram leximin e Kuranit fisnik nga gruaja që është me menstruacione. Konsensusi (ixhma) në këtë çështje ka vazhduar përgjatë katërmbëdhjetë shekujve. Ky konsensus është prej argumenteve aslj.

Medhhebi Hanefi, Shafi, Hanbeli dhe disa dijetarë prej Malikive, duke e përmendur këtë hadith në përgjithësi, kanë thënë se nuk ka ndryshim ndërmjet gjendjes me menstruacione dhe gjendjes së xhunubllëkut. Në këtë mënyrë, janë shprehur se një mysliman/e në këto dy gjendje, e ka të ndaluar kategorikisht të lexojë Kuranin fisnik derisa të pastrohet.

Mbi të gjitha, kjo dispozitë nuk është dhënë duke u mbështetur vetëm në hadithin fisnik të mësipërm. Kur ta shtellojmë temën deri në thellësi të saj, do të shohim se ka argumente të ndryshme e të fuqishme në lidhje me këtë dispozitë. Çdo besimtar i përgjegjshëm, është i detyruar ta pranojë si mendim të drejtë e të vetëm mendimin e shumicës së dijetarëve myslimanë përballë këtyre argumenteve.

Njëri prej këtyre argumenteve është ky hadith fisnik:

I Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, ka thënë:

“Dikush që është xhunub apo me menstruacione, nuk mund të lexojë Kuran.”²

Ndërsa në një transmetim tjetër, njoftohet se i Dërguari i Allahut, sallallahu alejhi ve sellem, nuk e pranoi selamin që i dha dikush kur po merrte abdest, por e pranoi atë pasi e përfundoi abdesin dhe tha:

“Unë nuk ta pranova selamin, për shkak se nuk dëshiroja ta përmendja pa abdest emrin e Allahut, i cili është i Plotfuqishëm dhe i Lartësuar.”³

Si mund të lejohet leximi i Kuranit fisnik nga një burrë

xhunub apo grua me menstruacione, ndërkohë që është e papëlqyeshme të pranohet selami pa abdest?

Imam Maverdi thotë kështu, në një shkrim që i kundërshton ata të cilët e pranojnë si të lejuar leximin e Kuranit fisnik nga një grua me menstruacione:

"Ky mendim është i gabuar, sepse ka ajete dhe hadithe që e ndalojnë leximin e Kuranit fisnik nga një burrë xhunub dhe grua me menstruacione. Gjendja e menstruacioneve është më e rëndë se xhunubllëku... Edhe një argument tjetër është se ata që e pranojnë këtë mendim, e ndalojnë hyrjen e gruas me menstruacione në xhami. Ndërkohë, nderimi i Kuranit fisnik, është më i rëndësishëm se nderimi i xhamisë..."⁴

Një çështje tjetër është lidhja e fortë që Kurani fisnik ka me namazin. Allahu i madhëruar e emërton namazin si Kuran, ku thotë:

***"...Me të vërtetë, Kurani/namazi i mëngjesit është i dëshmuar."*⁵**

Namazi është emërtuar si Kuran, për shkak se leximi i Kuranit është shtylla më e rëndësishme e namazit. Të gjithë dijetarët kanë rënë në konsensus se nuk mund të ketë namaz pa leximin e Kuranit fisnik. Nisur nga kjo, njëri prej imamëve të njohur Maliki, Kurtubiu ka thënë:

"Sikur gruaja me menstruacione ta kishte të lejuar leximin e Kuranit fisnik, atëherë mund të falte edhe namaz."⁶

Edhe Imam Ibn Abdilberri, i cili ishte njëri prej imamëve më të mëdhenj të medhhebit Maliki, pasi përmend transmetimin që njofton se gruaja me menstruacione mund të kryejë çdo lloj ibadeti të haxhit përveç tavafit, thotë:

"Në këtë transmetim dhe të tjerë si ky, gjendet argumenti që gruaja me menstruacione nuk mund të lexojë Kuranin fisnik. Ndërsa sipas kijasit, nuk mund të lexojë asgjë nga Kurani fisnik, sepse, po të ishte i lejuar leximi, mund të falte edhe namaz. Sikur të ishte e lejuar falja e namazit, atëherë do të ishte e lejuar edhe hyrja në Qabe për tavaf. Shumica e dijetarëve janë në këtë mendim. Ky është edhe transmetimi i Imam Esh'hebit nga Imam Maliku. Kjo është e vërteta."⁷

Nga ana tjetër, sipas një pjese të Malikive që e pranojnë si të lejuar leximin e Kuranit fisnik nga një grua me menstruacione, kjo mund të bëhet kur është e domosdoshme, ndërsa në raste të tjera, nuk është i lejueshëm. Kështu, ata japin rastin kur gruaja kalon një kohë të gjatë me menstruacione apo me lethoni dhe mund të ketë frikë nga harrimi i Kuranit fisnik. Por frika e harresës nuk mund të jetë justifikim për të bërë një haram. Kjo çështje nuk ka ndonjë shembull në ndonjë

vend tjetër.

Krahas së gjithash, një grua me menstruacione mund ta përsërisë Kuranin fisnik duke lexuar pa zë përmendsh, duke e parë ose duke e dëgjuar nga dikush që lexon. Ndërsa në ditët tona, Allahu Teala ka dhënë shumë mirësi të ndryshme. Për këtë arsye, gratë që mësojnë për t'u bërë hafize apo ato që japin mësim Kurani, kanë shumë mundësi të preokupohen me Kuranin fisnik pa e lexuar atë. Pra, duke filluar që nga mjetet incizuese e deri te kompjuterat.

Këtu ka edhe një çështje tjetër, që është e rëndësishme. Kuptimi i fjalës lexim te Malikitë është i ndryshëm nga kuptimi i fjalës lexim te dijetarët e medhhebeve të tjera. Nëse e shtjellojmë nga aspekti i medhhebit Hanefi, lexim do të thotë që njeriu ta realizojë veprën e të lexuarit me një zë që, të paktën, ta dëgjojë vetë. Nisur nga ky përkufizim, lexim nuk quhet murmurima, ajo që thuhet duke mos e dëgjuar as vetë dhe ajo që mendohet.

Leximi në namaz duhet të bëhet me një zë që, së paku, ta dëgjojë vetë lexuesi, në mënyrë që namazi të jetë i saktë. Kufiri më i vogël në namazet që falen pa zë, është leximi me një zë që të paktën ta dëgjojë vetë lexuesi. Ndërsa në namazet me zë, leximi duhet të bëhet me një zë që e dëgjojnë edhe të tjerët. Shumica dërmuese e dijetarëve tanë e kanë vënë si kusht këtë për leximin e Kuranit fisnik.

Ndërsa, sipas shumicës së dijetarëve të medhhebit Maliki, dëgjimi i zërit nga ana e lexuesit nuk është kusht për leximin. Pra, leximi me mendje, murmurima dhe leximi duke lëvizur buzët, aq sa nuk mund ta dëgjojë edhe lexuesi, është i lejuar sipas shumicës së dijetarëve Maliki. Kështu që, namazi lejohet të falet me një lexim të tillë. Pra, me një lexim pa zë.

Kur çështja shtjellohet në këtë mënyrë, atëherë nuk ngel vend më për kundërshtim. Edhe sipas dijetarëve tanë, që nuk e konsiderojnë të lejueshëm leximin e Kuranit fisnik nga një grua me menstruacione, një grua në këtë gjendje e ka të lejuar ta lexojë Kuranin fisnik me mendje, apo duke murmuritur, aq sa nuk i dëgjohet zëri, apo duke e lexuar përmendsh. Në këtë mënyrë, arrihet uniteti në mendim, për shkak se Malikitë, këtë lloj leximi e pranojnë si lexim.

Shënimet: **1)** Tirmidhi, Taharet, 98; Ibni Maxhe, Taharet, 105. **2)** Darimi, Vudu, 103. **3)** Ebu Davud, Taharet, 8; Nesai, Taharet, 23; Ibni Maxhe, Taharet, 27. **4)** el-Havi'l-Kebir, vëll. 1, fq. 147. **5)** el-Isra, 78. **6)** Ibni Abdilberri, et-Temhid, vëll. 1, fq. 149. **7)** Istizkar, vëll. 11, fq. 190.

RANDSI E MARTESËS

Ku do qi kthejmë sytë rreth gjanavet të ndodhuna me një herë na çfaqet një e vertetë; randësi e martesës, shtjem sytë mbi shpiegët, një fuqië naturale e shohim qi këto i martohen dhe i shtohen për vazhdimin e farës tyne; shtazët, dhe këta prap t'udhëhequn nga kjo fuqië e dimë qi janë tue aplikuë me besnikë nënet e pa shkruëme të këtij Ligj naturelë.

Po bimërat, e Lulet; po fluturat e bukra qi fluturojnë mbi to! Si është e mundun pa një marrë-dhanëje shkëmbimtare të mprojnë racën e llojin e tyne! E dashuna Naturë! Si mbas Ligjit famshëm që të ka falun Krijuesi i vertetë sa mrekullisht je tue vazhduë në harmonin tande të kandëshme dhe të rregullshëm! Lulevet me dritën e vesen e mengjezit, me rrezet e Hanës u fale ambëlsinën e mjaltit; fluturat e bletët i shtyte të shijojmë atë huallë t'ushqimshëm për vehte por ndërmjetësuer për martesën e luleve njena me tjetrën. Ti marton afshin avullin dhe krijon renë, me ererat e ndryshme kur rrëzonë gjethet në Vjeshtë pejosë tokën me plehurina të gjallshime për krijimin e një bimës së re; Me ererat bumbenë retë n'ujë, atë e ngref n'ajër dhe lëshon shinë kù është nevoja!

Ç'do lëvizje e dukshime dhe e pa pikasun n'është qi pjellë para teje një ndryshim, ky po bāhet në vazhdimë të martesës së fuqina njena me tjetrën; edhe lëshnjt e hapësirës në lëvizjet e tyne madhështore janë tue u krijuë, rrëmuë, e u shuë vetëm me marrë-dhanjet shkëmbimtare të cilat pa dyshim në trajtën e martesës janë tue përplotësue qellimin kryesuer së fuqisë Krijuese.

Po njeriu vall! A është fije për fije si këto? Ky i udhëhequn nga ligji i eaturës a mjaftonë të meritohet si shtazët e si bimrat, si gjith fuqinat pa qenë i lidaun në ligjë jo vetëm materjale por edhe shpirtënore! Kjo problemë në shekujt e kaluëm si edhe sot midis shumë dijetarëve ka shkaktuë dyshimin i cili me të vërtetë si një sëmundje ngjitarake është tue përhapun peginjat damtuëse mbi bazat e qytetnimit.

Ç'është pra martesë? A vetëm një detyrë natyrale?

A po njerzënore edhe sociale? Mbas njeriu me ndër-gjegjen qi ka ndodhet i ngarkuëm me ca detyra q'u përkasin edhe të tjerve naturisht martesë është një detyrë njerzënore edhe sociale; dashunia e Prindëvet kundrejtë të pjellunve të t'ynë në mënyren mē të dhimshe me ka qenë e renjosur në shpirtin e njeriut qi ditën e krijimit kjo dashuni e dhimsunië ka krijuë bazën e bashkë-rrajtjes; e mprojtjen kundrejt egërsinave të Natyrës. Shtazët e tjerë mbasi nuk e kanë këtë dhimsuni e dashtuni kaqi sa njeriu nuk janë të shtrenguë me ligjë të vueme me mbajtun rregullimin e jetës së tyne.

Sosieteja, nuk mund të rronjë kurrë pa qenë jeta familjare, por kjo bazën e vetë e ka të ngrefun me kushtet e martesës. Ndodhën shumë të ditun të rinjë qi thonë: njerzit tue formue një trup socialë



mundet të rrojnë pa formue jetën familjare të cilët shembëll tregojnë ca sekte, kabile të pa qytetëueme tue mos barazue se këta t'egër deri dikuë mund të kenë marëdhanje me Historin dhe kohën e kalueme të njerëzimit.

Këto janë theorina të thata, allusionë e andralle jo vetëm të pa dobishme por edhe shumë të rrezikshme për qytetnimin. Po të mejtohem i rreth kushteve të Jetës së sotshme qi pështetetet sosietea njerzënore pa dyshim bindemi se qytetnimi pa jetën familjare pa martesë nuk mund të jetë e forcuëme dhe e vazhduëme.

Jeta familjare fillonë me fjalën e besën qi lidhin midis tyne – në bazë të ligjit- nji i ri me nji të re, themelohet në martesën e këtyne qi thuret e stoliset me fletët, Lulet e dashunisë së vertetë.

Jeta familjare është nji traktat social me kushte morale e materiale aqi të randa sa secilli prej kontraktuesavet për me sigurie fatbardhësin duhet me qenë respektuës e admiruës fije për fije në vazhdim të kohës dhe afatit të saj. Per me qenë të lirë të larguemit nga martesë është nji damë i madhë për nji atdhe edhe për jetën sociale; Profedi i Naltë Muhamedi ka pas thanë:

“Ndër muslimanë më të këqijët fatzezë janë ato qi nuk martohen.” “Kunorzohuni; shtohuni; se me shtuarjen tuej para popujve të tjerë kanë me u ndërue në

Kijamet.” Me të vertetë aji njeri qi nuk është bamun kryetari i nji familjes nuk mund të quhet i plottë; në kohrat e vjetra ato njerës qi nuk kishin fitue ketë nderë nuk i përdornin as në detyrë me randsi; martesë sa sa më tepër në kohën e rinisë është nji detyrë dhe nji fatbardhësi, nji dobijë morale për marëvajtjen e njerzimit, nji shtegtim i domosdoshëm për vazhdimin e qytetnimit.

Asht nji fatbardhësi thamë; po edhe jemi gati t'a vertetojmë se nji jetë e ambël qi realizohet në jetën e përbashkët familjare i kalonë të gjitha dashunitë e pa lidhme e gati të çthuruna me nji frymë ftofëtsije. Nuk mundë të ket qendrim kurr nji dashuni e zbërthuqun, nji amor i pa pështetun ne nji mbasim shpirtënuër; Prudhoni ka pas thanë: për me pasun burr e gruë qetësin e dishirueme, për me gjetun gëzimin, dhe për me formue nji familje të vërtetë me doemos kundrejt njeni tjetrit duhet t'ushqejnë nji mbesim martesuër. Se pa ketë nuk është e mundun lidhënia e sinqertë. Me fjalën mbesim martesuër kemi për qëllim mëndimin e pastër qi naltonë burrin e gruë sipër ndjenjavet shtazore dhe qi nderonë kundrejt njeni tjetrit. Me ketë; marëdhanëjet martesore më tepër se dashunia lidhen në nji perulje shpirtënore.

Paul de Meri thotë: “Nji dashunië e tillë nga detyrat qi të ngarkon, nga jeta e re qi pregatit për naltim pjellë nji amor të këthellët e t'ambël, sa njeriu ketë pa u druajtun; pa u shtërnguë e pohonë vetë. Nji burrë i rife nji gruë e rife veç kujtimeve t'orvet t'ambëlta qi kalojnë në jetën martesore nuk harrojnë kurrë fillimin plotë gëzime të rrugës përbashkët por kujtojnë kurdoherë edhe distancat qi do të matin në jetën e ardhëme.

Sa bukur ka pa thanë Victor Hugo-ja për të dashmen:

Lorsqu'en ajoutant votre âge a mon âge,
Nous ne comptons pas a deux quarante ans,
Et que, dans notre humble e petit menage,
Tout, même l'hiver, nous etait printemps?

“Kur tue mbledhun vjeçët e tua me të mijat shuma nuk kapte të dyzetat në kësollën t'onë ç'do gjâ edhe dimni na dukesh si prendvera.” Dhe me të vertet po të mejtohem i pakë me pa anësi nuk është e mundun qi mos t'a pohojmë se fatbardhësia e vertet dhe e qendrushme, nuk mund të gjindet kurrë për njerin për veç se në Jetët familjare e cilla i detyrohet krye-këput martesës.

F.V.

Marrë nga “Zâni i Nalte”, fq. 182.





Sulbe të zgjedhura

Naim Drija

Dëshmitarët OKULARË



Si rezultat i urtësisë së Tij, Allahu (xh.sh.), ka caktuar që nesër, në ditën e kiametit, kur të dalim përpara Tij për të dhënë llogari, të kemi edhe dëshmitarë, që do të dëshmojnë pro apo kundër nesh për çdo gjë që do të flasim. Dëshmitari i parë, të Cilit nuk do të mund t'i fshehësh asnjë gjë që ke bërë është **Allahu i Madhëruar**. Atij nuk do të mund t'i fshehim as ato mendime dhe ndjenja që kemi në zemrën tonë, gjëra të cilat melekët nuk kanë mundur t'i regjistrojnë. Allahu (xh.sh.), urdhëron: **"Allahu është dëshmitar për çdo gjë."** (Nisa, 33) Ebu Hurejre (r.a.), transmeton: "E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (s.a.v.s.), duke thënë: 'Ndër njerëzit e parë, ndaj të cilëve do të shpallet vendimi në Ditën e Gjykimit, do të jetë dëshmori (shehidi)! Ai do të paraqitet përpara Allahut (xh.sh.), i cili do t'ia kujtojë të mirat që ka bërë dhe për të cilat ka qenë i ndërgjegjshëm. Allahu (xh.sh.), do t'i thotë: 'Çfarë bërë për hir të këtyre të mirave që të dhurova?' Ai do t'i përgjigjet: 'Luftova për hirin Tënd, deri sa rashë dëshmor.' Allahu i madhëruar do t'i thotë: 'Gënjen! Luftove që të tjerët të thonë: 'Ky njeri është hero!'' Dhe vërtet, ashtu ishte. Pastaj do t'i urdhërojë melekët ta tërheqin zvarrë me fytyrën kthyer nga toka, derisa të hidhet në zjarr."

Njeriu tjetër do të jetë dijetari, i cili ka studiuar, ka mësuar dhe e ka lexuar Kuranin pa ndërprerë. Ai do të paraqitet përpara Allahut, i Cili do t'ia kujtojë të mirat që i ka bërë në këtë botë, të mira që edhe ai do t'i pohojë një për një. Allahu i Madhëruar do t'i thotë: "Si i përdore ato të mira?" Ai do të thotë: "Studiova shkencat dhe diturinë, si dhe e kaloja kohën duke lexuar Kuranin për hirin Tënd." Allahu (xh.sh.), do t'i thotë: "Gënjen! Studiove diturinë, vetëm që të tjerët të thonë: 'Ky është njeri i ditur. Lexove Kuranin, që të

thonë për ty: "Ky njeri e kalon kohën duke lexuar Kur'an." Dhe vërtet ashtu ishte. Pastaj do të urdhërohen melekët ta tërheqin zvarrë me fytyrën përtokë, derisa ta hedhin në zjarr.

Njeriu i tretë do të jetë pasaniku, të cilin Allahu (xh. sh.), e kishte bërë të pasur duke i dhënë nga të gjitha llojet e pasurisë. Ai do të paraqitet dhe Allahu do t'ia përkujtojë begatitë që i ka dhënë. Allahu i Madhëruar do t'i thotë: "Çfarë bërë me këto begati?" Ai do të përgjigjet: "Nuk lashë vend pa e shpenzuar pasurinë time për hirin Tënd." Allahu do t'i thotë: "Gënjen! E ke shpenzuar pasurinë vetëm që të thonë të tjerët për ty se je njeri bujar!" Dhe vërtet ashtu ishte. Pastaj do të urdhërohen melekët ta tërheqin zvarrë me fytyrë përtokë, derisa ta hedhin në zjarr." (Muslim, Tirmidhi, Nesai)

Pra këta njerëz, edhe pse kanë bërë vepra, që në regjistrat e melekëve kanë figuruar si të mira, tek Allahu (xh.sh.), nuk janë të tilla, sepse Ai e di më së miri qëllimin me të cilin janë kryer ato punë të mira.

Melekët Të nderuar besimtarë! Allahu (xh.sh.), u ka caktuar si detyrë disa melekëve që të shënojnë dhe të regjistrojnë veprat tona, të mira dhe të këqija që bëjmë në këtë jetë. Allahu (xh.sh.), thotë: "**Padysim që mbi ju ka vëzhgues, shënues të nderuar, që dinë gjithçka që bëni.**" (Infitar, 10-12)

Me vdekjen e njeriut, mbyllet dosjet e shënimeve, me të cilat do të ballafaqohesh ditën e gjykimit. Pas daljes nga varri, njeriut do t'i vijë dosja e shënimeve të regjistruara nga melekët në dynja. Allahu i Lartësuar do ta urdhërojë njeriun t'i lexojë shënimet që i takojnë atij.

"Çdo njeriu ia kemi varur në qafë llogarinë për punën e tij dhe Ne, do t'ia paraqesim Ditën e Kiametit librin, që do ta gjejë të hapur (e do t'i themi): Lexoje librin tënd! Vetëm ai të mjafton sot për të dhënë llogari ndaj vetes!" (Isra, 13-14)

Toka Kjo tokë, mbi të cilën ecim, me të mirat e së cilës ushqehemi, vëndpushimi ynë në këtë jetë, do të jetë dëshmitare para Allahut të Lartësuar për gjynahet tona. Po, kjo tokë një ditë do të ofrojë prova dhe do të dëshmojë për çdonjërin prej nesh; do të flasë për çdo gjynah që është bërë mbi të. Do të vijë një ditë kur ajo do të shpalosë, do të zbulojë, do të publikojë dhe do të

nxjerrë në shesh fshehtësitë dhe sekretet tona.

Kur ta zënë Tokën dridhjet e saja,

Dhe ajo tokë të nxjerrë peshën nga brendësia e saj,

Atëherë njeriu do të thotë: "Ç'po i ndodh asaj?"

Atë Ditë toka do të rrëfejë lajmet e saj. (Zelzele, 1-4) Fjalët e Allahut: "**Atë Ditë toka do të rrëfejë lajmet e saj**", na i ka sqaruar i Dërguari i Allahut (a.s.), me fjalët: "Padysim që lajmet e asaj dite janë dëshmitë ndaj çdo njeriu se çfarë ka vepruar ai mbi sipërfaqen e tokës, duke thënë: "E ke bërë këtë dhe këtë vepër, në këtë dhe në atë ditë. Këto pra janë rrëfimet e asaj dite." (Tirmidhiu).

Gjymtyrët Edhe gjymtyrët e trupit, si: duart, këmbët, gjuha, sytë, veshët po edhe e tërë lëkura. Të gjitha këto do të dëshmojnë kundër njeriut në Ditën e Gjykimit. Ato do t'i zbulojnë gjynahet, krimet dhe haramet e tij dhe do t'i bëjnë publike. Allahu (xh.sh.), thotë: "**Sot, Ne do t'ua vulosim atyre gojën dhe në vend të tyre, do t'u flasin duart dhe do t'u dëshmojnë këmbët për ato që kanë bërë.**" (Jasin, 65)

Por edhe më shqetësuese do të jetë kur të flasë lëkura, së cilës ata do t'i thonë:

"Po ti, pse dëshmon kundër nesh?"

Ajo do të përgjigjet: "**Allahu, i Cili i ka dhënë aftësinë e të folurit gjithçkaje, më ka bërë sot edhe mua të flas...**" (Fussilet, 21) Kështu do të përfundojë procedura e dëshmitave. Për ne apo kundër nesh do të publikohen prova, fakte dhe argumente.

Besimtarë, mendoni për Ditën e Llogarisë, ditën kur do të takoheni me veprat tuaja. Në ditën kur çdo gjë do të jetë shqetësuese, në ditën kur do të publikohen gjynahet. Beso me bindje dhe vepro, mbill të mira, se do t'i vjelësh frytet në botën tjetër. Bëhu rob i Allahut në shtëpi, në xhami, në rrugë, në punë dhe kudo që të jesh, sepse Allahu (xh.sh.), të sheh kudo dhe kurdo, duke qenë kështu dëshmitari më i madh për çdo gjë që ne veprojmë. E lusim Allahun (xh.sh.), të na bëjë prej atyre që kryejnë vepra të mira, të cilat do të jenë dëshmitarët tanë pro dhe jo kundër nesh.

Amin!

"Çdo njeriu ia kemi varur në qafë llogarinë për punën e tij dhe Ne, do t'ia paraqesim Ditën e Kiametit librin, që do ta gjejë të hapur (e do t'i themi): Lexoje librin tënd! Vetëm ai të mjafton sot për të dhënë llogari ndaj vetes!" (Isra, 13-14)

FLINI PARA PROVIMEVE, MOS MËSONI GJITHË NATËN

Shumë studentë rrinë zgjuar net me radhë për t'u përgatitur për provime, por hulumtuesit amerikanë thonë që gjumi i mirë i natës mund të jetë një ide më e mirë.

Dr. Philip Alapat, drejtor i Harris Health Sleep Disorders Center dhe asistent në Baylor College of Medicine, u rekomandon studentëve që të studiojnë gjatë gjithë semestrave, që të mësojnë gjatë orëve të mbrëmjes, sepse është koha më e përshtatshme e vigjilencës dhe përqendrimit dhe më pas ata duhet t' i bëjnë tetë orë gjumë natën para provimeve.

"Thirrja e kujtesës dhe aftësia për të mbajtur përqendrimin janë më shumë të përmirësuar kur një person është i çlodhur", tha Alapat. "Duke u përgatitur më herët dhe duke i kujtuar ato që keni mësuar, aftësia juaj për rezultatet të mira në provime do të rritet".

Ai tha se studentët e moshës së kolegjit, realisht duhet të flenë 8 deri 9 orë çdo natë, por në përgjithësi shumica e studentëve flenë më pak.

"Çdo privim i stërzgatur nga gjumi do të ndikojë keq në përgatitjen tuaj, në nivelin e energjisë, aftësinë për t'u fokusuar, koncentruar dhe mësuar, të cilat ndikojnë direkt në performancën tuaj akademike", ka thënë Alapat.

Qëndrimi tërë natën zgjuar në kombinim me konsumimin e pijeve me kafeinë do ta rrezikonin studentin nga pagjumësia apo insomnia, gjithashtu rritet edhe rreziku nga



abuzimi me alkool dhe aksidentet automobilistike, thuhet në studimin e Alapatit.

Adoleshentët duhet ta njohin humbjen kronike të gjumit, pasi ajo mund të kontribuojë në zhvillimin e sëmundjeve kronike, si diabeti, shtypja e lartë e gjakut dhe sëmundjet e zemrës, ka thënë Alapat.

SI TË QETËSOJMË DHIMBJET E KOKËS

Në shenjën e parë të dhimbjes së kokës pini një gotë të madhe me ujë. Nëse nuk ndihmon, provoni mjetet natyrale, si ushqimi i pasur me acidet yndyrore omega-3.

Dhimbjen e kokës mund ta ndalë çaji i rozmarinës. Derdhi një filxhan uji të vluar mbi një lugë bime të tharë, lëreni të absorbohet 10 minuta, kullojeni dhe pijeni.

Ilaç shumë efikas është çaji nga xhenxhefli, i cili mund të jetë efikas edhe kundër migrenës dhe të përziera-ve. Thjesht, derdheni filxhanin me ujë të nxehtë përmbi gjysmë luge xhenxhefli të imtësuar, lëreni të ftohet dhe pijeni. Ndonjëherë dhimbjen e kokës mund ta frenoni, në mënyrë që të pini një gotë të madhe uji të zakonshëm, sepse një pjesë e mirë e dhimbjes së kokës shkaktohet si pasojë e dehidrimit, respektivisht mungesës së lëngjeve.

Te dhimbjet e kokës nga tensioni vendosni një kompresë të nxehtë në ballë ose mbrapa kokës. Nxehtësia do të qetësojë muskujt e asaj pjesë. Mund të përdorim edhe kompresë të ftohtë. Mbështillni disa copa akulli në peshqir ose leckë. Ftohtësia tkurr enët e gjakut dhe ato nuk do të bëjnë presion në nervat e ndjeshme. Ose zhytni duart në ujë të ftohtë derisa të mund të përballoni. Derisa i keni duart e zhytura në ujë, vazhdimisht ngjishni dhe shtrini gishtat. Kjo vepron njësoj si vënia e akullit.



Parandaloheni dhimbjen e kokës

Hani në intervale të caktuara kohore, sepse rënia e sheqerit në gjak mund të shkaktojë dhimbjen e kokës. Hani edhe ushqim të pasur me acidet yndyrore omega-3 - peshk ose fara të lirit. Të paktën çdo dy ditë ushtrohuni lehtësisht gjysmë ore, ngisni biçikletën ose bëni një shëtitje.

Dushi i nxehtë për këmbët

Futja e këmbëve në ujë të nxehtë do ta lehtësojë dhimbjen e kokës. Me tërheqjen e gjakut në këmbë, dushi i nxehtë për këmbët do të zvogëlojë presionin në enët e gjakut të kokës.

Gishtat kundër dhimbjes së kokës

Provoni akupresurën. Me lëvizje të forta rrethore bëni masazh në pjesën e lëkurës në mes gishtit të madh dhe atij tregues. Bëni masazh për disa minuta, pastaj ndërroni duart dhe përsëriteni veprimin, derisa të kalojë dhimbja e kokës.

Krijoni atmosferë qetësuese

Shmangni freskuesit industrialë të ajrit, aromat e forta dhe parfumet. Të gjitha këto mund të nxisin dhimbje të kokës. Dhimbje të kokë mund të nxisin edhe alergjenët nga mjedisi, si pluhuri dhe polemi, prandaj mundësojani vetes një fshesë kualitative elektrike me filtrim HEPA. Të dobishëm janë edhe larguesit e lagështisë së ajrit, sepse dëmtuesit shumohen lehtë në mjedis të lagësht.

ROBOTI QË I NGJAN SHUMË NJERIUT

Shkencëtarët japonezë ndërtuan robotin, i cili ngjan më shumë me njeriun në skelet dhe muskuj. Roboti, i cili është ndërtuar me të gjitha kockat dhe muskujt e ngjashëm me njeriun, duket sikur ka dalë nga ndonjë film fantastiko-shkencor.

Roboti me emrin "Kenshiro", i cili është ndërtuar në Universitetin e Tokios në Japoni, cilësohet si një hap i rëndësishëm në prodhimin e robotëve të ngjashëm me njeriun. Kenshiro doli para publikut në konferencën "Humanoids 2012", që u mbajt në qytetin e Osakës.

Në fillim, realizimi i projektit "koncept" të këtij roboti, pati disa probleme, sepse vetëm ndërtimi i pjesës së sipërme arriti peshën 45 kg. Për këtë arsye, ekipi projektues iu rikthye përsëri skicave, duke projektuar nga fillimi kafazin e kraharrorit, legenin, kofshët, gjunjët dhe disa pjesë të tjera.

Ata u munduan që çdo pjesë e trupit të robotit të kishte edhe ngjashmërinë edhe peshën e njëjtë me atë të trupit



të njeriut. Më në fund, ata arritën të ndërtonin një skelet me muskuj të përafërt me një djalë 12-vjeçar japonez, me 158 cm lartësi dhe 50 kg peshë trupore.

Kenshiro ka 160 muskuj, që lëvizen prej një motori të vetëm. Çdo grup muskujsh janë lidhur me njëri-tjetrin me anë të një sistemi telash dhe çik-

rikësh. Roboti, i cili tani për tani lëviz me vështirësi, ka shumë pjesë që janë të pavarura nga njëra-tjetra.

Përgjegjësit e Universitetit të Tokios theksuan se duhet ende shumë punë që roboti të lëvizë si një njeri i vërtetë dhe se projekti Kenshiro do të vazhdojë derisa të arrihet qëllimi i synuar.

SI TË SHPËTONI CELULARIN E LAGUR

Edhe pse telefoni juaj celular bie në ujë, mund të mos jetë fundi për të! Ja se çfarë duhet të bëni për ta shpëtuar celularin tuaj

Nëse celulari juaj bie aksidentalisht në ujë ose në vendin tuaj e shijon ai filxhanin e kafesë apo të çajit, ka mundësi që ju ta shpëtoni atë. Por me kusht që të zbatoni menjëherë disa veprime të domosdoshme.

Merreni shpejt dhe nxirri baterinë. Pikësëpari, duhet të pranonini të mos e përdorni telefonin tuaj për disa ditë. Në përgjithësi, dëmi nuk vjen nga uji apo lëngjet e tjera, por nga qarku i shkurtër që mund të provokohet. Prandaj, nëse keni një aparat që i del bateria, shpejtoni ta nxirri atë. Nëse nuk mundeni të nxirri baterinë, fiken aparatin. Por, nëse është i fikur, mos u mundoni ta ndizni e ta kontrolloni, sepse ky veprim mund ta prishë atë përfundimisht.



Nëse keni mundësi, shpërbëjeni telefonin duke hequr kartën SIM, kartën SD të memories dhe kapakët. Pastaj mundohuni të përthithni ujin me anë të ndonjë fshese me korrent. Më vonë, provoni ta thani atë duke e lënë për disa ditë në një kuti të mbushur me oriz, me qëllim që orizi të thithë të gjithë lagështinë e mbetur. Por kini kujdes! Mos provoni ta thani telefonin me tharëse flokësh apo me ndonjë aparat tjetër ngrohës, si furra me mikrovalë etj. Tharësen e flokëve mund ta përdorni vetëm nëse mund ta fikni ngrohësin e saj. Prandaj, fshesa me korrent është zgjedhja më e mirë dhe më e sigurt për ne. Gjithashtu, celularin e lagur mos e tundni

duke u përpjekur të nxirri ujin, sepse kështu do të shkaktoni depërtimin e ujit edhe në pjesët ku ai ende nuk ka arritur.

PROCESI I ANËTARËSIMIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR NË BE, MOS VALLË NË KRIZË?

Çmimi Nobel i Paqes këtë vit iu dha BE-së, që aktualisht po përjeton krizën më të madhe të ekzistencës së tij gati 60-vjeçare.

Nga arsyetimi i Komitetit të Nobelit kuptojmë se Unioni është vlerësuar i denjë për këtë çmim si rezultat i pajtimit të Gjermanisë me Francën, vendosjes së stabilitetit të demokracive në Evropën Jugore, anëtarësimit të Evropës Lindore në Union dhe perspektivës së zgjerimit drejt vendeve të Ballkanit Perëndimor e Turqisë. Falë këtyre politikave, thuhet se Bashkimi Evropian ka garantuar kontribute të rëndësishme për paqen, pra në fushën e pajtimit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Por a duhet të ngjallë shpresë tek vendet e Ballkanit Perëndimor kontributi i politikës së zgjerimit në Çmimin Nobel, që iu dha BE-së?

Bashkimi Evropian ka luajtur role të rëndësishme në transformimet e realizuara në Ballkan. Brukseli fillimisht u mor me menaxhimin e krizave, ndërsa më pas i përfshiu të gjitha vendet ballkanike në procesin e zgjerimit të Unionit. BE-ja e ka theksuar në raste të ndryshme se porta e saj mbetet hapur për hyrjen e Ballkanit Perëndimor.

Megjithatë, vendet e rajonit janë të vetëdijshme se aderimi i tyre në BE nuk varet vetëm nga ecuria e procesit të reformave, por edhe nga zhvillimet brenda vetë Unionit. Kohëve të fundit mund të dëgjohen ankime se Bashkimi Evropian nuk po u kushton vëmendje të mjaftueshme vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo gjë ka ngjallur dyshime nëse do të vazhdojnë, apo jo, procesi i zgjerimit të BE-së, si rrjedhojë edhe reformat në rajon. Gjithashtu, ka nga ata që besojnë se mund të vonohet madje edhe anëtarësimi, në dukje i sigurt për nga mesi i 2013-s, i Kroacisë.

Pavarësisht pesimizmit të akumuluar lidhur me anëtarësimin e Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian, duket qartë se në një farë mënyre vazhdon procesi i zgjerimit të Unionit drejt këtij rajoni. Mbi të gjitha Kroacia e ka të garantuar anëtarësimin në BE. Ndërkaq, nga gjysma e 2012-s morën start edhe negociatat e anëtarësimit të Malit të Zi. Kurse në mars të këtij viti, që jemi duke lënë prapa, statusi i vendit kandidat për anëtarësim në BE iu dha edhe Serbisë. Komisioni Evropian për të katërtin vit radhazi propozoi fillimin e negociatave të anëtarësimit me Maqedoninë, por për shkak të problemit të emrit me Greqinë në këtë çështje nuk po mund të shënohet progres. Shumë pranë statusit të vendit kandidat duket edhe Shqipëria, e cila në dy vitet e fundit ka regjistruar disa përpertime të konsiderueshme në reformat e kërkuara nga Brukseli. Nga ana tjetër, edhe pse e kanë njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës, pesë vende anëtare të BE-së po kërkojnë rrugën ligjore për të bërë të mundur nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (MSA) me Kosovën. Po t'i marrim parasysh të gjitha këto, të pretendosh se procesi i zgjerimit të BE-së është në krizë, do të ishte një opinion aspak realist.

Por në vend të kësaj mund të themi me plot gojë se kriza ekonomiko-financiare, që këto vitet e fundit ka marrë nën ndikim Bashkimin Evropian, ka prekur gjithashtu procesin e zgjerimit dhe ky do të ishte një opinion më i drejtë.

Në bazë të statistikave më të fundit të Eurostatit, papunësia brenda Eurozonës ka arritur në nivelin rekord 11,7 për qind. Në Greqi dhe Spanjë, dy vende këto në krizë të thellë borxhesh prej tashmë tri vitesh, rreth 60 për qind e të rinjve nën 25 vjeç rezultojnë të papunë. Kjo situatë bën që Evropa të mos jetë më një simbol i shpresës. Ankthi dhe problemet, që kanë kapluar e po lëkundin fuqishëm ekonominë e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian në përgjithësi dhe Eurozonës në veçanti, jo vetëm që e kanë shtytur procesin e zgjerimit jashtë përparësive të Unionit, por kanë filluar madje të shpërftyrojnë edhe imazhin e BE-së në Ballkanin Perëndimor. "Njerëzit me gjak të ëmbël, por edhe të nxehtë", pra ballkanasit, kanë nisur të mendojnë se Bashkimi Evropian nuk jep më garanci ekonomike si dikur. Për më tepër, askush nuk është i sigurt mbi shëmbëlltyrën, që mund të ketë BE-ja pas disa vjetësh.

Faktikisht, për vendet e Ballkanit Perëndimor do të ishte më mirë sikur, në vend që të vinin në dyshim procesin e zgjerimit të Unionit, të fokusoheshin në masat dhe rritjen ekonomike. Sepse ekonominë e Ballkanit Perëndimor, që gjenden përballë borxheve të larta publike, deficiteve buxhetore dhe problemit kronik të papunësisë, gjatë tri viteve të fundit thuajse nuk kanë shënuar aspak rritje. Prandaj, problemet ekonomike të vendeve ballkanike renditen mes çështjeve, që u nxjerrin më tepër vështirësi qeverive të rajonit. Qytetarët ballkanas, të cilët prej vitesh kanë qenë të dënuar të jetojnë -le të themi- në kushte minimale mirëqenieje dhe me retorika nacionaliste të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me problemet politike,

duken të gatshëm ta ndërpresin mbështetjen e tyre për çdo qeveri, që dështon në fushën e ekonomisë. Dhe saktësisht në këtë pikë efekti i krizës së BE-së në Ballkan mund të arrijë përmasa shumë më serioze. Krahas të drejtës për të përdorur fondet e Bashkimit Evropian, në një farë mase mund të vështirësohen edhe marrëdhëniet tregtare e financiare të vendeve të rajonit me Unionin. Veç kësaj, përgjatë disa viteve në vijim ka mjaft gjasa që vendet e Ballkanit të mos shikojnë edhe aq shumë investitorë nga BE-ja. Si përfundim, procesi i zgjerimit të Unionit do të vazhdojë padyshim edhe në të ardhmen, por vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të heqin dorë nga besimi se anëtarësimi në Bashkimin Evropian do t'u japë një zgjidhje të magjishme problemeve të tyre ekonomike dhe të përqendrohen pa humbur më kohë e me seriozitet maksimal tek problemet e tyre të zhvillimit.

Dr. Erhan TYRBEDAR, specialist për Ballkanin pranë Fondacionit Turk për Kërkime mbi Politikën Ekonomike (TEPAV).

